



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 08/L-228**

**PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**

**KAPITULLI I**  
**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi i ligjit**

Ky ligj përcakton rregullat e organizimit të sistemit zgjedhor, duke përfshirë rregullat për përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikëqyrjen dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

## **Neni 2**

### **Fushëveprimi**

1. Ky ligj zbatohet për procesin zgjedhor për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe për atë që është i aplikueshëm, rregullat dhe parimet e tij vlejnë edhe për procesin zgjedhor të nivelit lokal, siç përcaktohet në ligjin në fuqi për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës.
2. Ky ligj, përveç tjerash, rregullon:
  - 2.1. mbrojtjen e të drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur si dhe kriteret për pranueshmërinë e votës;
  - 2.2. përgjegjësitë, organizimin dhe funksionet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe organeve të tjera zgjedhore;
  - 2.3. përgjegjësitë e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa;
  - 2.4. afatet, procedurat dhe kompetencat për regjistrimin dhe certifikimin e subjekteve politike;
  - 2.5. afatet, procedurat dhe kompetencat për përgatitjen e listës së votuesve dhe mirëmbajtjen e saj;
  - 2.6. zhvillimin e fushatës zgjedhore, rregullat e mirësjelljes së subjekteve politike, kandidatëve të tyre dhe mbështetësve, si dhe kufizimet e shpenzimeve në fushatë;
  - 2.7. mbulimin e fushatave zgjedhore nga mediat;
  - 2.8. akreditimin e vëzhguesve të zgjedhjeve, si dhe të drejtat e përgjegjësitë e tyre;
  - 2.9. procedurën e votimit, numërimit dhe shpalljes së rezultateve;
  - 2.10. shqyrtimin e mjeteve juridike dhe vendosjen e sanksioneve administrative;
  - 2.11. çështje të tjera në lidhje me zgjedhjet.

## **Neni 3**

### **Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë kuptimet e përcaktuara në këtë nen:
  - 1.1. **Aktiviteti i fushatës politike** - do të thotë çfarëdo tubimi ose fjalimi politik, mbledhje, prezantim publik, ose ndonjë aktivitet i përgatitur për të propaganduar mesazh politik në lidhje me zgjedhjet;
  - 1.2. **Borxhi** - do të thotë të gjitha shumat monetare të cilat subjekti politik është i detyruar t'ua paguajë personave të tjerë;

- 1.3. **Burime** - përfshijnë artikujt e prekshëm dhe të paprekshëm siç janë përcaktuar në rregullat e një institucioni, sikurse janë automjetet, materialet shpenzuese, fotokopja, telefoni, telefoni celular, pajisjet e zyrës, objektet;
- 1.4. **Formulari i përputhjes së rezultateve (FPR)** - do të thotë formulari i miratuar nga KQZ-ja para çdo zgjedhjeve, për qëllim të përputhjes së votave në një vendvotim;
- 1.5. **Kandidati** - do të thotë kandidati për deputet të Kuvendit të Kosovës, i cili garon në emër të një partie politike apo nisme qytetare;
- 1.6. **Kandidati i pavarur** - do të thotë kandidati për deputet të Kuvendit të Kosovës, i cili nuk i takon asnjë partie politike ose nisme qytetare dhe nuk garon në emër të asnjë subjekti tjetër politik;
- 1.7. **Kapitali** - do të thotë ndryshimi ndërmjet pasurive dhe borxheve;
- 1.8. **Koalicioni** - do të thotë koalicioni i dy ose më shumë partive politike;
- 1.9. **Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ)** - është organ përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve zgjedhore brenda territorit të komunës;
- 1.10. **Komuniteti** - do të thotë banorët që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar, etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Kosovës;
- 1.11. **Kontribut** - siç përcaktohet në Ligjin për financimin e subjekteve politike;
- 1.12. **KQZ** - do të thotë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, institucion i pavarur kushtetues, përgjegjës për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve, siç përcaktohet në nenin 139 të Kushtetutës;
- 1.13. **KPM** - do të thotë Komisioni i Pavarur për Media;
- 1.14. **Kushtetuta** - do të thotë Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- 1.15. **Kuti Postare në Kosovë** - Kuti (Fah) postare e hapur nga KQZ-ja në Postën e Kosovës, që shërben për të dërguar fletëvotimet shtetasit që regjistrohen sukseseshëm për votim jashtë Kosovës;
- 1.16. **Kuti postare jashtë Kosovës** - Kuti (Fah) postare e hapur nga KQZ-ja, me ndihmën e përfaqësive diplomatike në postat e shteteve ku ka shtetas të Republikës së Kosovës në numër të konsiderueshëm, që shërbejnë për të dërguar fletëvotimet shtetasit që regjistrohen suksesshëm për votim jashtë Kosovës;
- 1.17. **Kuvendi** - do të thotë Kuvendi i Republikës së Kosovës;
- 1.18. **Lista përfundimtare e votuesve (LPV)** - do të thotë lista e votuesve ashtu siç përcaktohet në nenin 9 paragrafi 5 të këtij ligji;

1.19. **Lista përfundimtare e votuesve të vendvotimit (LPVV)** - do të thotë lista e votuesve të cilët janë caktuar të votojnë në një VV të rregullt, e cila mban nënshkrimin e atyre anëtarëve të cilët kanë hedhur votat e rregullta në atë VV;

1.20. **Lista e votuesve me kusht (LVK)** - do të thotë lista e zbrazët e votuesve që do të përdorët në QV-të ku hidhen fletëvotimet me kusht;

1.21. **Lista e votuesve (LV)** - do të thotë lista e të gjithë votuesve me të drejtë vote për zgjedhje siç përcaktohet në nenin 8 paragrafi 1 të këtij ligji;

1.22. **Media** - do të thotë të gjitha televizionet dhe radiostacionet që transmetojnë në territorin e Kosovës dhe të cilët janë të licencuara nga Komisioni i Pavarur për Mediave, duke përfshirë edhe mediat e shkruara;

1.23. **Ngjarje** - do të thotë tubim politik në mjedis të mbyllur ose të hapur, mbledhje, marsh ose vargan, fjalim ose ndonjë aktivitet tjetër i ngjashëm i caktuar për të shpërndarë mesazh politik në mënyrë që të fitohet mbështetje nga votuesit;

1.24. **Nisma qytetare** - do të thotë grupi i personave të cilët bashkohen vullnetarisht mbi bazën e një ideje, interesi ose pikëpamje të përbashkët, me qëllim zgjedhjen e kandidatëve të tyre, por që nuk dëshirojnë të formojnë parti politike;

1.25. **Organizata jo-qeveritare (OJQ)** - do të thotë çdo organizatë joqeveritare e regjistruar në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi;

1.26. **Pagesa** - do të thotë transferimi i pagesës me vlerë, përfshirë dhe pagesën në formë të mallrave dhe shërbimeve. Pagesa bëhet në kohën kur merret përfitimi nga pagesa;

1.27. **Parti politike** - do të thotë një organizim i individëve të cilët janë bashkuar vullnetarisht mbi bazën e ideve, interesit dhe pikëpamjeve të përbashkëta, me qëllim të ushtrimit të ndikimit dhe pasjes së përfaqësuesve të tyre të zgjedhur në zyrë publike, ose siç e përcaktuar ndryshe me legjislacionin në fuqi;

1.28. **Periudha e kundërshtimit dhe e konfirmimit** - do të thotë periudha kohore pas shpalljes së ditës së zgjedhjeve nga Presidenti i Kosovës, gjatë së cilës votuesit me të drejtë vote mund të kundërshtojnë pasaktësitë ose lëshimet në Listën e votuesve në vendet e caktuara nga KQZ-ja dhe në përputhje me rregullat dhe procedurat e themeluara nga KQZ-ja;

1.29. **Periudha e fushatës** - do të thotë periudha prej tridhjetë (30) ditëve për fushatën zgjedhore të subjekteve politike, e cila përfundon me hapjen e qendrave të votimit në ditën e zgjedhjeve;

1.30. **Personi kontaktues** - do të thotë personi i cili është i autorizuar të komunikojë në emër të subjektit politik me zyrën për çështje jo-financiare;

1.31. **Përfaqësi diplomatike** - ambasadë, konsullatë, mision diplomatik dhe mision konsullor, që përfaqëson Republikën e Kosovës në një shtet tjetër dhe në ditën e votimit mund të shfrytëzohet si qendër e votimit, sipas vlerësimeve të KQZ-së;

1.32. **Përfaqësuesi financiar** - do të thotë personi që është personalisht përgjegjës për mbajtjen e shënimeve financiare të subjektit politik, duke siguruar pajtueshmërinë e subjektit me këtë ligj dhe duke komunikuar me Sekretariatën e KQZ-së lidhur me raportet për deklarimin e financave të fushatës së subjektit;

1.33. **Pikë publicitare politike** - do të thotë një reklamë e vetme e natyrës politike që përfaqëson pikëpamjet e subjektit politik të certifikuar që transmetohet nga transmetuesi medial;

1.34. **PZAP** - do të thotë Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, një organ i pavarur përgjegjës për vendosjen për parashtresat dhe ankesat në lidhje me procesin zgjedhor;

1.35. **Nëpunësi publik** - përfshin nëpunësit civilë dhe nëpunësit e shërbimit publik, siç përcaktohet në ligjin në fuqi për zyrtarët publikë, si dhe nëpunësit tjerë publikë që janë në marrëdhënie pune me institucionet shtetërore dhe publike të Republikës së Kosovës;

1.36. **Qasja e drejtë** - do të thotë qasje e drejtë dhe e përpjesshme në media të shkruara dhe elektronike në kuptim të periudhave kohore të mbulimit nga mediat, vendosjes së numrit të rreshtave në mediat e shkruara, pa diskriminim për ose kundër cilitdo subjekt të veçantë të certifikuar;

1.37. **Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR)** - do të thotë lokacioni ku numërohen fletëvotimet me kusht (FK-të), fletëvotimet jashtë Kosovës, dhe çdo fletëvotim i rregullt siç kërkohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) apo Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa. FPR-të nga secili VV auditohen dhe tabelohen, dhe rezultati përfundimtar përpilohet;

1.38. **Qendra Komunale e Numërimit (QKN)** - do të thotë lokacioni në secilën komunë ku numërohen fletëvotimet dhe votat e kandidatëve të subjekteve politike, në mënyrë transparente në prani të vëzhguesve dhe personave të tjerë të akredituar;

1.39. **Qendra e Votimit (QV)** - do të thotë ndërtesa ku ndodhet një apo më shumë vendvotime dhe hapësira brenda të cilës gjendet prona e ndërtesës;

1.40. **Regjistri Qendror Civil** - dokumenti shtetëror unik, i mbajtur në formën elektronike dhe fizike, ku pasqyrohen përbërësit e gjendjes civile të çdo shtetasi të Kosovës, në bazë të legjislacionit në fuqi për gjendjen civile;

1.41. **SKQZ** - do të thotë Sekretariati i KQZ-së;

1.42. **Subjekti politik** - do të thotë parti politike, koalicion, nismë qytetare ose kandidat i pavarur;

1.43. **Subjekti(et) i certifikuar politik** - do të thotë subjekti politik, që është partia politike, koalicioni i partive politike, nisma qytetare ose kandidati i pavarur, i cili është i certifikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përputhje me këtë ligj dhe me rregullat e KQZ-së;

1.44. **Shpenzimi** - do të thotë pagesa e bërë për mallra ose për blerje të mallrave, materialeve, punës, ose shërbimeve, qofshin ato të prekshme ose të paprekshme. Shpenzimi bëhet në datën kur bëhet pagesa ose blerja ose në datën kur sigurohen mallrat, materialet, puna ose shërbimet, cilado që bëhet më parë;

1.45. **Shpenzimi për fushatë** - do të thotë çdo pagesë e bërë për mallra ose blerje të mallrave, materialeve, punës, shërbimeve, qofshin ato të prekshme ose të paprekshme, me qëllim të ndikimit të drejtpërdrejtë në zgjedhje, pavarësisht nëse bëhen për mbështetje të kandidatit të posaçëm, partisë politike, koalicionit ose nismës qytetare, siç janë shpenzimet për reklamim në mediat e shtypura; prodhimin e spoteve transmetuese; materialet e fushatës, përfshirë pamfletet, posterët, butonat; ekspozim të reklamave, përfshirë standat e afishimit dhe prodhimin e tyre; kontributet bamirëse. Këto nuk përfshijnë shpenzimet e bëra në mbështetje të veprimtarive të rregullta të subjektit politik. Mallrat ose shërbimet për të cilat pagesat janë bërë para ose pas periudhës së fushatës, për përdorim gjatë periudhës së fushatës, po ashtu konsiderohen si shpenzime për fushatë;

1.46. **Shtetas** - personi i cili e ka shtetësinë e Republikës së Kosovës;

1.47. **Të ardhura** - do të thotë çdo shumë monetare e pranuar si kuotë anëtarësie ose tarifë; qiraja; kontributet nga jashtë nga individët, bizneset ose organizatat e çfarëdo lloji; donacionet; vlera e kontributeve në formë të mallrave dhe shërbimeve (bamirëse) kontributet dhe çfarëdo pagese për subjektin politik;

1.48. **Transmetuesi në shërbim publik** - do të thotë organizata e transmetuesit publik jofitimprurës të Kosovës, siç përcaktohet me Ligjin për Radiotelevizionin e Kosovës;

1.49. **Transmetuesi privat** - do të thotë transmetuesi i cili nuk është në pronësi publike;

1.50. **Vendvotimi (VV)** - do të thotë një dhomë, sallë ose hapësirë e ngjashme për qëllim të votimit në ditën e zgjedhjeve brenda qendrës së votimit;

1.51. **Vëzhguesi i akredituar** - do të thotë përfaqësuesi i një subjekti të certifikuar politik, organizate joqeveritare, qeveritare ose ndërqeveritare, organizate ndërkombëtare të specializuar dhe të përfshirë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, vendi të huaj, ose media, që ka dorëzuar kërkesën për vëzhgim të zgjedhjeve dhe ka marrë miratimin nga KQZ-ja në pajtim me këtë ligj dhe me rregullat e KQZ-së;

1.52. **Votimi i personave me nevoja të veçanta (VPNV)** - do të thotë marrëveshjet e bëra dhe procedurat e ndjekura për ata votues me të drejtë vote në Kosovë të cilët nuk mund të votojnë personalisht në VV-në në të cilën janë caktuar për ditën e zgjedhjeve;

1.53. **Votuesi jashtë Kosovës** - do të thotë aplikuesi i suksesshëm nga jashtë Kosovës që përdor një nga mënyrat e votimit jashtë territorit të Kosovës, siç është e saktësuar në rregullat e KQZ-së;

1.54. **Votimi me postë fizike** - nënkupton dorëzimin e dërgesës postare (zarfin me fletëvotimin) në postën e vendit ku jeton dhe dërgesa postare vulozet nga posta përkatëse me rastin e dorëzimit;

1.55. **Zgjedhje** - do të thotë zgjedhje për Kuvendin e Kosovës;

1.56. **Zyra** - do të thotë Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike që vepron ashtu siç është e përcaktuar me legjislacionin në fuqi.

## **Neni 4** **Parimet themelore**

1. Mbajtja dhe administrimi i zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës dhe legjislacioni përkatës zgjedhor udhëhiqen nga parimet në vijim:

1.1. zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës mbahen në bazë të votës së lirë, të përgjithshme, të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë në përputhje me këtë ligj dhe rregullat e KQZ-së;

1.2. çdo shtetas i Republikës së Kosovës është i barabartë në ushtrimin e të drejtës për të votuar dhe për t'u zgjedhur pa diskriminim në bazë të racës, etnisë, ngjyrës, gjuhës, gjinisë, besimit fetar apo bindjes politike, arsimit, përkatësisë sociale apo ndonjë kriteri tjetër të ngjashëm në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

1.3. liria dhe fshehtësia e votës është e garantuar. Askush nuk ka të drejtë të pengojë ndonjë qytetar për të votuar, të detyrojë atë të votojë në një mënyrë të caktuar, të mbajë atë përgjegjës për votën, ose të kërkojë kundër dëshirës së tij/saj që të zbulojë votën e tij/saj ose arsyet për mos votim;

1.4. zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës reflektojnë përfaqësimin gjeografik të të gjitha rajoneve të Kosovës;

1.5. të gjitha subjektet politike janë të lira të bëjnë fushatë dhe të bëjnë propagandë zgjedhore në media, përmes organizimit të ngjarjeve politike dhe botimit e shpërndarjes së materialeve për fushatë në çfarëdo mënyre ligjore në përputhje me rregullat dhe legjislacionin në fuqi;

1.6. subjektet politike kanë mundësi të barabartë për emisione në radio dhe televizion, fonde publike dhe forma të tjera të mbështetjes;

1.7. përdorimi i zyrave publike, burimeve ose personelit të cilitdo institucion në nivel qendror ose lokal me qëllim të mbështetjes së një subjekti politik në zgjedhje është rreptësishtë i ndaluar;

1.8. subjektet politike nuk mund të shfrytëzojnë nëpunësit civilë që përdorin pozitën, burimet, ose personelin për fushatë gjatë zgjedhjeve;

1.9. të gjitha subjektet politike dhe organet zgjedhore janë të obliguara t'i respektojnë kërkesat për kuotën e gjinisë siç përcaktohet me këtë ligj;

1.10. të gjitha subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe të gjitha institucionet tjera janë të obliguara të respektojnë parimet themelore të përcaktuara në këtë nen dhe të ndërmarrin të gjitha masat për të siguruar mbajtjen e zgjedhjeve të lira, të drejta dhe të mirë-informuara në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

## **KAPITULLI II**

### **SHPLLJA E ZGJEDHJEVE, E DREJTA PËR TË VOTUAR, LISTA E VOTUESVE, PERIUDHA E KUNDËRSHTIMIT DHE KONFIRMIMIT PËR LISTËN E VOTUESVE**

#### **Neni 5**

#### **Shpallja e zgjedhjeve**

1. Pas konsultimit me partitë politike, Presidenti i Kosovës cakton dhe shpall datën e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës.
2. Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës mbahen në ditën e diel çdo katër (4) vjet. Zgjedhjet nuk mbahen më herët se gjashtëdhjetë (60) ditë dhe mbahen në jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para përfundimit të mandatit.
3. Sipas kompetencave të Presidentit të përcaktuara me Kushtetutë, vendimi i Presidentit për të caktuar datën e zgjedhjeve bëhet jo më herët se gjashtë (6) muaj dhe jo më vonë katër (4) muaj para datës së zgjedhjeve. Vendimi përmban datën e zgjedhjeve.
4. Kuvendi i Kosovës zgjidhet për një mandat katër (4) vjeçar, i cili fillon që nga dita e seancës konstitutive e cila mbahet brenda tridhjetë (30) ditësh nga shpallja zyrtare e rezultateve të zgjedhjeve.
5. Pas shpërndarjes së Kuvendit të Kosovës zgjedhjet e parakohshme caktohen nga Presidenti jo më vonë se dhjetë (10) ditë pas shpërndarjes. Zgjedhjet e parakohshme nuk mund të mbahen më herët se tridhjetë (30) ditë dhe më vonë se dyzetë e pesë (45) ditë pas shpërndarjes.
6. Zgjedhjet e parakohshme rregullohen nga ligjet dhe rregullat e njëjta të KQZ-së sikurse edhe zgjedhjet tjera, përveçse KQZ-ja mund të ndryshojë afatet kohore sipas nevojës në pajtim me rrethanat.
7. Pas shpalljes së datës për mbajtjen e zgjedhjeve, KQZ miraton afatet dhe planin e aktiviteteve të zgjedhjeve.
8. Vendimi për shpalljen e zgjedhjeve bëhet publik në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.



## **Neni 6**

### **E drejta për të votuar**

1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet.
2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.
3. E drejta e votës mund të kufizohet me vendim gjyqësor.

## **Neni 7**

### **Votimi brenda dhe jashtë Kosovës**

1. Çdo shtetas me të drejtë vote ka të drejtë të votojë në Kosovë në ditën e zgjedhjeve dhe në komunën ku ai apo ajo është i regjistruar, me kusht që emri i tij apo saj paraqitet në Regjistrin Qendror Civil.
2. Shtetasi i Republikës së Kosovës, që jeton jashtë vendit, ka të drejtë të votojë në zgjedhje pas regjistrimit të suksesshëm sipas procedurave dhe afateve kohore të përcaktuara në këtë ligj.
3. KQZ, për qëllime të aplikimit dhe regjistrimit të shtetasve të Republikës së Kosovës nga paragrafi 2 i këtij neni, zbaton afat të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm, por jo më të shkurtër se pesëmbëdhjetë (15) ditë.
4. KQZ, për qëllime të aplikimit dhe regjistrimit të shtetasve të Republikës së Kosovës nga paragrafi 2 i këtij neni, merr masa të nevojshme për informimin dhe edukimin e votuesve, duke përfshirë dhe pa u kufizuar në mënyrën e aplikimit dhe regjistrimit, platformat elektronike të zbatueshme dhe promovimin e standardeve më të larta demokratike për sigurimin e materialeve të votimit, fshehtësinë e votës, personalizimin dhe paprekshmërinë e saj.

## **Neni 8**

### **Lista e votuesve**

1. KQZ-ja mban Listën e votuesve dhe siguron që e njëjta bazohet në të dhënat e sakta, të përditësuara dhe më të fundit të Regjistrit Qendror Civil dhe e cila në mënyrë sistematike largon nga lista personat e vdekur dhe personat që kanë hequr dorë nga shtetësia. Kjo listë përmban:
  - 1.1. ekstraktin më të vonë në dispozicion nga Regjistri Qendror Civil i të gjithë votuesve me të drejtë vote të cilët janë regjistruar si shtetas të Kosovës sipas Ligjit për shtetësinë;
  - 1.2. të gjithë shtetasit me të drejtë vote jashtë Kosovës, të cilët në mënyrë të suksesshme kanë aplikuar dhe janë regjistruar për votim në përfaqësi diplomatike apo përmes postës, si votues jashtë Kosovës.

2. Lista e votuesve nga paragrafi 1 i këtij neni, përmban informatat personale të ofruara për secilin votues siç janë: emri, mbiemri, data e lindjes, adresa dhe Qendra e Votimit ku ai/ajo është caktuar për të votuar.
3. Me qëllim të saktësimit të listës së votuesve dhe konfirmimit të të drejtës për votim, KQZ-së i garantohet qasja në bazën e të dhënave dhe regjistrat e institucioneve kompetente, duke përfshirë por pa u kufizuar në regjistrat e: Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Agjencisë Kadastrale, Agjencisë për Regjistrim Civil dhe Administratës Pensionale.
4. Lista e votuesve është në dispozicion për të pasur qasje në të ashtu siç parashihet me rregullat e KQZ-së.
5. Lista e votuesve do të jetë publike edhe në vitet jozgjedhore, ku votuesit do të kenë mundësi që të njoftohen lidhur me qendrat e votimit dhe të kërkojnë ndërrimin e qendrave të votimit. Agjencia e Regjistrimit Civil është e obliguar që së paku dy (2) herë në vit t'ia ofrojë KQZ-së ekstraktin e Regjistrit Qendror Civil.
6. Të gjitha aktivitetet dhe dokumentet e organeve shtetërore, të gjitha paraqitjet dhe të dhënat lidhur me qytetarët e regjistruar në Listën e votuesve lirohen nga pagesa e tarifave dhe taksave.
7. Të dhënat personale të qytetarëve në Listën e votuesve shënohen në gjuhët dhe alfabetet në të cilat mbahen shënimet origjinale në pajtim me Ligjin për përdorimin e gjuhëve në Kosovë.
8. Gjykata kompetente duhet të dorëzojë të dhënat në KQZ për personat të cilëve u është marrë zotësia e veprimit me vendim gjyqësor të formës së prerë. Këto të dhëna dorëzohen ashtu siç kërkohet nga KQZ-ja.
9. Regjistri Qendror Civil pajis KQZ-në me të gjitha informatat përkatëse që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kërkon për të mirëmbajtur Listën e votuesve në pajtim me afatet kohore të caktuara nga KQZ-ja.
10. KQZ u ofron komisioneve komunale të zgjedhjeve (KKZ), një kopje elektronike dhe/apo kopje të shtypur të listës preliminare të votuesve për komunën e tyre.
11. Shfrytëzimi dhe përdorimi i të dhënave personale të shtetasve të Republikës së Kosovës nga ana e KQZ-së apo organeve kompetente të saj, bëhet vetëm për qëllime të procesit zgjedhor dhe në pajtim me udhëzimet e agjencisë përgjegjëse për Informim dhe Privatësi, si dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

## **Neni 9**

### **Shqyrtimi i Listës së votuesve dhe periudha e kundërshtimit**

1. Votuesit me të drejtë vote mund të kundërshtojnë, siç është e përcaktuar në nenin 10 të këtij ligji, pasaktësitë apo lëshimet në Listën e votuesve gjatë periudhës së vendosur për atë qëllim nga KQZ-ja.

2. Para fillimit të periudhës së kundërshtimit dhe konfirmimit, pas shpalljes së datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Kosovës, KQZ e bën listën preliminare të votuesve të disponueshme në zyrat e KKZ-së, në secilën komunë, në pajtim me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Lista preliminare e votuesve do të përfshihet në makinën kërkuese elektronike, e cila do të publikohet në ueb faqen e KQZ-së.
3. Para fillimit të periudhës së kundërshtimit, KQZ-ja i ofron qasje në listën preliminare të votuesve personit kontaktues të secilit subjekt politik të certifikuar në zgjedhje. Çdo përdorim i listës preliminare të votuesve që është në kundërshtim me këtë ligj ose me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, paraqet shkelje ligjore.
4. Gjatë periudhës së zgjedhjeve KQZ-ja u ofron qasje në listën preliminare të votuesve organizatave vëzhguese të akredituara të zgjedhjeve, sipas kërkesave të tyre individuale. Vëzhguesit e akredituar të zgjedhjeve mund të vëzhgojnë periudhën e kundërshtimit dhe konfirmimit në të gjitha lokacionet ku lista preliminare e votuesve është në dispozicion për t'u shikuar.
5. Pasi që publiku të ketë pasur mundësinë të sfidojë pasaktësitë dhe mangësitë në Listën e votuesve, mirëpo para ditës së zgjedhjeve, KQZ-ja vërteton se Lista e votuesve është në përputhje me këtë ligj.
6. Vendimet për ndryshimet në Listën e votuesve merren nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës.

## **Neni 10**

### **Procedura e kundërshtimit**

1. Çdo person me të drejtë vote, siç përcaktohet me nenin 6 të këtij ligji, që nuk figuron në Listën e votuesve, mund të kërkojë nga KQZ rishikimin e listës së votuesve, duke u paraqitur në KKZ apo përmes sistemit elektronik, me njërin nga dokumentet si në vijim:
  - 1.1. letërnjoftim të vlefshëm;
  - 1.2. pasaportë të vlefshme;
  - 1.3. lejen e vozitjes të vlefshme.
2. Personi që dëshiron të kundërshtojë një emër që mendon se nuk duhet të jetë në LV duhet të dorëzojë ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës, brenda afatit prej dyzet (48) orëve, nga momenti kur është vënë në dijeni për ekzistimin e emrit të atij personi në LV, deri në certifikimin e LV nga KQZ-ja, duke theksuar qartë faktet që mbështesin kundërshtimin, duke përfshirë provat tjera relevante.
3. Personi sipas paragrafit 1 të këtij neni, që edhe pas rishikimit, nuk është përfshirë në Listën e votuesve mund të dorëzojë ankesë në PZAP, brenda afatit prej dyzet e tetë (48) orësh, nga momenti kur është njoftuar për mospërfshirjen e emrit të tij në LV, deri në certifikimin e LV nga KQZ-ja, duke theksuar qartë faktet që mbështesin kundërshtimin, si dhe duke bashkëngjitur/paraqitur provat tjera relevante.

4. Personi që ka aplikuar për t'u regjistruar si votues jashtë Kosovës, mund të parashtojë ankesë në PZAP, përmes postës ose sistemit elektronik, për mospërfshirjen e tij në Listën e votuesve, brenda afatit prej dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i njoftimit nga KQZ-ja.

5. Ankesa e personit jashtë Kosovës që dorëzohet në PZAP në mënyrë elektronike, duhet të jetë e nënshkruar, e skanuar dhe duhet t'i këtë të bashkangjitura dokumentet valide të lëshuara nga organet kompetente të Republikës së Kosovës, të cilat identifikojnë ankuesin. Ankesa e tillë, dërgohet vetëm nga email - adresa personale e ankuesit.

6. PZAP-i nuk do t'i shqyrtojë ankesat që dorëzohen nga adresa elektronike apo emali i personave tjerë, edhe nëse ata janë anëtarë të të njëjtës familje.

## **Neni 11**

### **Procesi i vendosjes**

1. Të gjitha vendimet e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, përfshirë edhe vendimet që kanë të bëjnë me përfshirjen apo përjashtimin e emrit nga LV-ja, janë përfundimtare dhe të detyrueshme për t'u zbatuar nga KQZ-ja, përveç nëse ankesa e lejuar sipas këtij ligji parashtrohet brenda afatit të paraparë dhe Gjykata Supreme e Kosovës vendos ndryshe.

2. Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, e njofton KQZ-në dhe çdo palë tjetër ndaj së cilës është ngritur ankesa dhe u ofron këtyre palëve mundësinë për t'u përgjigjur. Çdo përgjigje në ankesë duhet të pranohet brenda dy (2) ditëve të punës prej njoftimit nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa që ankesa është pranuar.

3. Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa u ofron kopjet e vendimeve me shkrim palëve të përfshira si në paragrafin 2 të këtij neni, brenda afatit prej shtatëdhjetë e dy (72) orëve, nga momenti i pranimit të ankesës.

4. Ankesa lidhur me përjashtim të padrejtë nga Lista e votuesve, e rregullt apo përmes postës, duhet të pranohet nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa jo më vonë se dyzet (40) ditë para ditës së zgjedhjeve.

5. Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa nuk do të veprojë ndaj ankesave të cilat nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara në rregullat e procedurës. Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa mund në përgjithësi të refuzojë një ankesë apo grup ankesash nëse ato nuk paraqesin raste *prima facie* ose ku ankesa apo grupi i ankesave është dukshëm i pabazë.

6. Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa ka autoritetin për të urdhëruar KQZ-në për të marrë masa riparuese për çështje në lidhje me kërkesat që kanë të bëjnë me LV-të.

## KAPITULLI III

### REGJISTRIMI I PARTIVE POLITIKE, CERTIFIKIMI I SUBJEKTEVE POLITIKE, NDALIMI I REGJISTRIMIT DHE ÇREGJISTRIMI I PARTIVE POLITIKE

#### Neni 12

#### Dispozitat e përgjithshme

1. KQZ-ja themelon Zyrën për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike. Zyra është përgjegjëse për mirëmbajtjen e regjistrit të subjekteve politike, certifikimin e të gjitha subjekteve politike që do të përfshihen në fletëvotim dhe kufizimin e shpenzimeve të fushatave dhe dispozitave për deklarim financiar të këtij ligji si dhe monitorimin dhe kontrollimin e financave të subjekteve politike. Zyra e ka përgjegjësinë për hetimin e shkeljeve të ligjit, që t'i raportojnë ato pranë autoriteteve kompetente, kur kërkohet, dhe të shqiptojë gjoba.

1.1. Zyra, në ushtrimin e funksioneve të parapara me këtë ligj gëzon pavarësi funksionale. Kryesuesi i KQZ-së do të sigurojë që Zyrës t'i ofrohen shërbimet administrative, logjistike dhe financiare nga Sekretariati i KQZ-së, me qëllim të realizimit të detyrave dhe përgjegjësisë të saj, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

1.2. Zyra ka dhe menaxhon buxhetin e vet. Zyrës i ndahet buxhet i mjaftueshëm për operacione dhe shpenzime të rregullta të lidhura me kompensimin e personelit.

1.3. Pavarësisht nga sa më lart, Zyrës i ndahet çdo vit buxhet shtesë për auditimin e financimit të subjekteve politike, në vlerë prej jo më pak se pesë për qind (5%) nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike, ndërsa gjatë ciklit zgjedhor, për auditimin e raportit financiar të fushatës zgjedhore i ndahet jo më pak se tre për qind (3%) e fondeve të caktuara për fushatën zgjedhore dhe operacionet zgjedhore.

1.4. KQZ-ja ose kryesuesi i saj nuk mund t'i kufizojë ose t'i drejtojë shpenzimet e Zyrës dhe nuk mund ta rindajë buxhetin e Zyrës ose të përdorë buxhetin e ndarë për Zyrën për ndonjë qëllim tjetër, pa aprovimin paraprak të drejtorit të Zyrës.

1.5. Struktura organizative e Zyrës përcaktohet nga Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës nga KQZ-ja, duke siguruar që Zyra të pajiset me burimet e nevojshme njerëzore për kryerjen e kompetencave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Personeli i Zyrës përbëhet nga të paktën dhjetë (10) punonjës profesionalë, të cilët nuk kanë qenë anëtarë të një subjekti politik, nuk i kanë dhuruar një subjekti politik dhe nuk kanë qenë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në ndonjë marrëdhënie kontraktuale me një subjekt politik tre (3) vjet para paraqitjes së aplikimit të tyre. Vetëm Zyra ka kompetencë për punësimin e personelit, duke përfshirë shpalljen e vendeve të lira, ngritjen e paneleve të rekrutimit, administrimin e procesit të rekrutimit dhe lidhjen e kontratave të punësimit.

1.6. Zyra mund të kryejë mbikëqyrje në çdo rast, nëse konsiderohet se një subjekt politik ka shkelur dispozitat ligjore, si dhe mund të kërkojë nga personat e paraparë sipas nenit 14 të këtij ligji,

parashtrimin e përgjigjeve me shkrim me qëllim të sigurimit të dëshmimeve dhe dokumenteve të tjera për të realizuar mbikëqyrjen.

1.7. Zyra kërkon, nga subjekti politik që konstatohet se është në kundërshtim me dispozitat ligjore, eliminimin ose korrigjimin vullnetar të gjetjeve dhe mangësive, nëse ato mund të eliminohen ose korrigjohen, përpara se të vendosen sanksione nga Zyra. Ky adresim vullnetar i gjetjeve duhet të kryhet brenda afatit të caktuar nga vendimi i Zyrës.

1.8. Zyra mund të iniciojë një verifikim të pajtueshmërisë për shkeljet e dëshmimeve nën betim të auditorëve për mungesën e konfliktit të interesit ose lidhjeve me një subjekt politik, në bazë të ankesave anonime ose ankesave të tjera të parashtruara, informacionit të dhënë nga një institucion publik ose me vendim të drejtorit të Zyrës. Zyra mund të kërkojë informata nga institucionet publike dhe private dhe të ftojë dëshmitarë. Lëndët për shkeljet e dëshmisë nën betim përfundohen brenda gjashtë (6) muajsh, me mundësi për dy (2) muaj shtesë bazuar në arsyetimin e dhënë me vendim të nxjerrë nga drejtori. Drejtori i Zyrës nxjerr dhe publikon në ueb faqen e KQZ- së një vendim nëse një auditor ka shkelur dëshminë e vet nën betim brenda pesë (5) ditësh nga përfundimi i lëndës. Në rastet kur është nxjerrë një vendim se një auditor ka shkelur kushtet e dëshmisë së vet nën betim, auditori do të hiqet dhe të gjitha gjetjet e auditorit do të anulohen. Për të kryer një auditim të ri apo auditime që zëvendësojnë raportet e anuluarat të auditimit, do të zgjidhet një auditor i ri.

1.9. Zyra mund të bëjë verifikim të pajtueshmërisë për çdo parregullsi në financat e fushatës dhe raportet e financimit në bazë të ankesave të parashtruara, informacionit të dhënë nga një institucion publik ose me vendim të drejtorit të Zyrës. Nëse një proces i verifikimit të pajtueshmërisë është iniciuar kundër një auditori, publikimi i raportit të kryer nga ai /ajo do të shtyhet deri pas përfundimit të procesit të verifikimit të pajtueshmërisë.

1.10. Pas shqyrtimit preliminar të ankesës dhe/ose pretendimeve, drejtori i Zyrës mund:

1.10.1. ta hedhë poshtë kërkesën ose të mos ndërmarrë asnjë veprim të mëtijshëm nëse pretendimet e parashtruara nuk janë serioze, nuk kanë vlerë ose nuk kanë asnjë lloj lidhjeje me kornizën rregullatore të financimit të subjekteve politike; ose

1.10.2. të nxjerrë një vendim për fillimin e verifikimit të përshtatshmërisë nëse konstatohet se ka dëshmi të konsiderueshme të ndonjë parregullsie.

1.11. Pas nxjerrjes së vendimit për fillimin e verifikimit të pajtueshmërisë, drejtori ia cakton lëndën sipas shortit personelit të tij, i cili do të vërtetojë faktet dhe do të mbledhë dëshmi lidhur me parregullsinë e pretenduar. Zyra mund të kërkojë çdo informacion të nevojshëm nga institucionet private ose publike. Përveç kësaj, subjekti politik do të ketë mundësinë të ofrojë, me shkrim dhe personalisht, çdo informacion për mbrojtjen e tyre. Lëndët përfundohen brenda gjashtë (6) muajsh, me mundësi për dy (2) muaj shtesë bazuar në arsyetimin e dhënë me vendim të nxjerrë nga Drejtori.

1.12. Pas përfundimit të procesit të verifikimit të pajtueshmërisë, drejtorit i dorëzohet një raport përfundimtar për të gjitha faktet dhe dëshmitë e grumbulluara, me një rekomandim përfundimtar, bazuar në të cilin drejtori mund ta nxjerrë vendimin nëse subjekti politik e ka shkelur ligjin, si dhe

t'ia shqiptojë gjobën subjektit politik dhe zyrtarit të saj financiar dhe/ose drejtuesit të subjektit politik. Vendimi duhet të përfshijë një përshkrim të shkeljes, datën e veprës dhe gjobën e vendosur.

1.13. Vendimi do të nxirret dhe publikohet në faqen e internetit të KQZ-së. Vendimi mbetet publik në ueb faqen e KQZ-së për një (1) vit pas nxjerrjes së tij. Përveç kësaj, të gjitha palët e përfshira do të informohen zyrtarisht për rezultatin e lëndës.

1.14. Subjekti politik dhe zyrtarët e saj të prekur mund të parashtrajnë padi për konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente.

1.15. Nëse gjatë këtij procesi të verifikimit të pajtueshmërisë, ose edhe pas nxjerrjes së vendimit, dyshohet se është kryer një vepër penale, është kryer një shkelje tatimore, ka pasur shkelje të konfliktit të interesit, Zyra menjëherë njofton autoritetin kompetent në Zyrën e Prokurorit, Polici, Administratë Tatimore, Njësinë e Inteligjencës Financiare, respektivisht, Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

2. Drejtori i Zyrës emërohet nga kryesuesi i KQZ-së, pas konkursit publik për vend të lirë. Emërimi dhe shkarkimi i drejtorit të Zyrës bëhet sipas legjislacionit të aplikueshëm për emërimë në pozita të larta drejtuese. Drejtori i Zyrës i raporton drejtpërdrejt kryesuesit të KQZ-së.

2.1. Paneli i rekrutimit përbëhet nga pesë (5) anëtarë, ku kryesuesi i KQZ-së shërben si kryesues i panelit. Katër (4) anëtarë janë udhëheqës të institucioneve/agjencive të pavarura.

2.2. Anëtarët e panelit, përveç kryesuesit të KQZ-së, emërohen nga këto agjenci/institucione:

2.2.1. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit;

2.2.2. Institucioni i Avokatit të Popullit;

2.2.3. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave;

2.2.4. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.

2.3. Paneli i rekrutimit vendos për emërim të drejtorit të Zyrës me shumicë të votave. Procedura për përzgjedhjen e drejtorit të Zyrës përcaktohet në detaje me anë të aktit nënligjor të miratuar nga KQZ-ja, duke i pasqyruar kështu parimet e shërbimit civil.

2.4. Drejtori i Zyrës duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

2.4.1. të jetë qytetar i Republikës së Kosovës;

2.4.2. të ketë diplomë të vlefshme universitare;

2.4.3. të ketë së paku tetë (8) vjet përvojë profesionale, nga të cilat pesë (5) vjet në pozita udhëheqëse;

2.4.4. të ketë një reputacion profesional dhe integritet moral;

2.4.5. të mos jetë dënuar për veprë penale me vendim të formës së prerë nga gjykata;

2.4.6. nuk ka qenë anëtar i një subjekti politik, nuk i ka dhuruar një subjekti politik dhe nuk ka qenë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në ndonjë marrëdhënie kontraktuale me një subjekt politik pesë (5) vjet para paraqitjes së aplikimit të tij/saj.

2.5. Drejtori i Zyrës ushtron detyrat e zyrtarit kryesor administrativ sipas Ligjit për menaxhimin e financave Publike dhe përgjegjësitë. Paga e drejtorit të Zyrës do të jetë ekuivalente me pagën e kryeshefit ekzekutiv të Sekretariatit të KQZ-së. Kryesuesi i KQZ-së mund të nxjerrë një vendim për alokimin e shtesës për rrezikshmëri për drejtorin e Zyrës.

2.6. Mandati i drejtorit është katër (4) vjet me mundësi të riemërimit edhe një (1) herë. Mandati i drejtorit mund të përfundojë me:

2.6.1. skadimin e mandatit;

2.6.2. dënimin për veprë penale e cila dënohet me burgim prej mbi gjashtë (6) muaj burgim;

2.6.3. shkarkimin, si pasojë e performancës së dobët;

2.6.4. dorëheqje;

2.6.5. vdekje.

2.7. Nëse drejtori i Zyrës dështon, të përmbushë një ose më shumë obligime ose kërkesa të vendosura nga ky ligj ose një akt nënligjor, kryesuesi i KQZ-së mund t'i propozojë panelit shkarkimin e drejtorit të Zyrës siç përcaktohet në nën-nënparagrafin 2.6.3. të këtij neni. Për qëllime të këtij paragrafi, dështimi në kryerjen e detyrave nënkupton:

2.7.1. dështimi në përmbushjen e kërkesave ligjore;

2.7.2. zbulimi i informacioneve konfidenciale ose të ndjeshme personave të paautorizuar;

2.7.3. përfshirja në aktivitete politike ose aktivitete të paligjshme;

2.7.4. përdorimi i pozitës për përfitimet personale;

2.7.5. shkelja e politikave të Zyrës dhe KQZ-së, dhe

2.7.6. shkelja e rëndë e kodit të etikës.

2.8. Shkarkimi i drejtorit sipas nën-nënparagrafit 2.6.3. të këtij neni bëhet vetëm si masë e fundit.



2.9. Partia politike konsiderohet automatikisht e certifikuar në kohën e zgjedhjeve dhe pasi që të plotësojë kërkesën e nenit 16 paragrafi 3 të këtij ligji, përveç nëse e informon Zyrën ndryshe në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2.10. Partia politike e regjistruar ose cilido aplikues tjetër për certifikim në përputhje me këtë ligj konsiderohet si subjekt politik. Zyra mban korrespondencë zyrtare në të shkruar me subjektet politike përmes personit kontaktues.

2.11. Zyra është e obliguar:

2.11.1. të botojë dhe mbajë të botuar në ueb faqen e saj zyrtare dhe çdo tre (3) mujor raportin tremujor financiar dhe raportin financiar të fushatës së subjekteve politike;

2.11.2. të botojë dhe mbajë të botuar në ueb faqen e saj zyrtare raportin përfundimtar të auditimit të subjekteve politike, jo më vonë se 30 qershori i vitit vijues;

2.11.3. t'ia dorëzojë subjektit politik raportin përfundimtar të auditimit, në përputhje me nenin 1 të këtij ligji, deri me 30 qershor të vitit vijues.

2.12. Format i versionit të shkurtër për botim, sipas nën-nënparagrafit 2.11. të këtij neni, përcaktohet me rregull të veçantë të propozuar nga Zyra dhe të aprovuar nga KQZ-ja.

2.13. Pasqyrat financiare të subjekteve politike të regjistruara auditohen çdo vit, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

### **Neni 13** **Regjistrimi i partive politike**

1. KQZ mban regjistrin e partive politike.

2. Aplikimet për regjistrimin e partive politike mund të dorëzohen në Zyrë në çdo kohë gjatë orëve të rregullta të punës.

3. Aplikimet e dorëzuara për regjistrim në Zyrë ndërmjet ditës së deklarimit të datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Kosovës dhe datës së vendosur për tërheqjen e fletëvotimit do të shqyrtohen vetëm nëse aplikimet për certifikim si subjekt politik janë bërë në përputhje me këtë ligj.

4. Aplikimet për regjistrimin e partive politike dorëzohen në formën e vendosur nga rregullat e KQZ-së siç kërkohet nga Zyra, dhe duhet të përfshijnë si vijon:

4.1. emrin, mbiemrin, adresën dhe numrin e telefonit të kryetarit të partisë;

4.2. emrin, mbiemrin, adresën dhe numrin e telefonit të përfaqësuesit të autorizuar financiar të partisë;

4.3. emrin, mbiemrin, adresën dhe numrin e telefonit të personit të autorizuar për të komunikuar në emër të partisë me KQZ-në;

4.4. numrin e telefonit dhe adresën postare të zyrës qendrore të partisë;

4.5. deklaratën e nënshkruar nga kryetari i partisë për të respektuar dhe për t'iu përmbajtur Kodit të Mirësjelljes së Partive Politike;

4.6. statutin e partisë;

4.7. çfarëdo shkurtese apo shenje të partisë;

4.8. deklaratën e fundit financiare të partisë;

4.9. datën e konventës më të fundit të partisë;

4.10. emrin, mbiemrin, numrin personal dhe adresën e së paku pesëqind (500) përkrahësve të regjistrimit të iniciativës politike e cila aplikon për regjistrim, e të cilët duhet të jenë banorë të Kosovës dhe të cilët gjenden në Listën votuese të Kosovës.

5. Zyra i shqyrton aplikimet brenda dhjetë (10) ditëve nga pranimi i tyre dhe brenda pesë (5) ditëve nga përfundimi i rishikimit të çfarëdo çështjeje që kërkon sqarim apo ndryshim në formën e aplikimit.

6. Brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i aplikimit, Zyra e njofton KQZ-në për statusin e aplikimit, duke rekomanduar regjistrimin, duke rekomanduar mos regjistrimin, ose duke saktësuar fusha të tjera që mund të kërkojnë sqarime shtesë.

7. Secila parti politike e regjistruar e dorëzon formularin siç përshkruhet nga rregullat e KQZ-së për të vazhduar regjistrimin e saj jo më vonë se 31 marsi i vitit kalendarik.

8. Dështimi për t'u reregjistruar në përputhje me këtë ligj do të thotë se partia largohet nga regjistri i partive politike.

9. Për çfarëdo ndryshimesh sa i përket kryetarit apo zyrtarit për financa të partisë politike, Zyra njoftohet brenda pesë (5) ditëve të punës pas bërjes së ndryshimeve.

10. Partia e regjistruar politike mban kuvendin zgjedhor brenda gjashtë (6) muajve nga data e regjistrimit të partisë dhe pastaj së paku çdo dyzet e tetë (48) muaj.

## **Neni 14**

### **Ndalimi i regjistrimit të partisë politike**

1. Ndalohet regjistrimi i një partie në rastet kur:

- 1.1. është e domosdoshme për të siguruar rendin publik, shëndetin publik, sigurinë kombëtare, parandalimin e çrregullimeve, dhunës dhe krimit, ose mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve;
- 1.2. në dokumentet e themelimit të saj shprehet qëllimi për përdorimin e dhunës për marrjen e pushtetit si dhe shprehet nxitja dhe përkrahja e urrejtjes racore fetare, etnike etj;
- 1.3. partia është krijuar jashtë territorit të Republikës së Kosovës;
- 1.4. me të njëjtin emërtim është regjistruar një parti tjetër.

## **Neni 15**

### **Sanksionimi penal i subjekteve politike dhe gjobat ndaj tyre**

1. Rregullat dhe kushtet për shqiptimin e sanksioneve penale kundër subjektit politik të regjistruar mbështeten në legjislacionin në fuqi për përgjegjësinë penale të personave juridik, si dhe dispozitat në fuqi të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.
2. Gjobat ndaj subjekteve politike shqiptohen për shkeljen e dispozitave të këtij ligji, ndërsa gjobat e tjera të ndërlidhura me financimin e subjekteve politike, shqiptohen në bazë të legjislacionit në fuqi për financimin e subjekteve politike.
3. Personat përgjegjës të partisë apo personat e autorizuar nga personat përgjegjës të partisë, në kuptim të legjislacionit në fuqi për financimin e subjekteve politike, janë ligjërisht përgjegjës për saktësinë e të gjitha informatave të dorëzuara në Zyrë, ashtu siç kërkohet me këtë ligj.

## **Neni 16**

### **Certifikimi i subjekteve politike**

1. Me qëllim të pjesëmarrjes në zgjedhje, subjekti politik duhet të certifikohet për atë qëllim nga KQZ-ja.
2. Aplikimet për certifikim mund të dorëzohen në çdo kohë gjatë orëve të rregullta të punës, deri gjashtëdhjetë (60) ditë para zgjedhjeve.
3. Partia politike e regjistruar është automatikisht e certifikuar, por duhet të njoftojë Zyrën brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga deklarimi i datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Kosovës për çfarëdo ndryshimi për kryetar të partisë, përfaqësues të autorizuar të partisë, ose përfaqësues financiar të partisë dhe çfarëdo informata të nevojshme lidhur më këso lloj ndryshimesh.
4. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga shpallja e datës së zgjedhjeve nga Presidenti i Kosovës, partia politike e regjistruar e cila nuk dëshiron të certifikohet për zgjedhje duhet të njoftojë Zyrën që nuk garon në zgjedhje, apo që partia politike do të kërkojë certifikim përmes koalicionit në përputhje me këtë ligj.

5. KQZ-ja e certifikon subjektin politik me të drejtë pjesëmarrjeje nëse i njëjti e dorëzon aplikimin e plotësuar, në formën e përshkruar dhe në datën e vendosur nga rregullat e KQZ-së. Këto aplikime shoqërohen me të gjithë dokumentacionin e mbështetur të kërkuar nga ky nen si në vijim:

5.1. certifikata e regjistrimit (numri personal në rastin e kandidatëve individual);

5.2. emri, mbiemri, adresa dhe numri i telefonit të kryetarit të subjektit ku kjo është e zbatueshme, dhe përfaqësuesit të autorizuar dhe numri i telefonit të zyrës qendrore të subjektit politik;

5.3. kopja e shenjës së partisë, apo në rast koalicionesh, kopja e shenjës e të gjitha partive politike që janë në koalicion dhe çfarëdo shenje të vetë koalicionit;

5.4. emri, mbiemri, adresa dhe numri i telefonit i zyrtarit financiar të subjektit;

5.5. emri, mbiemri, adresa dhe numri i telefonit i personit të ngarkuar me procesin zgjedhor në emër të subjektit;

5.6. deklarata e nënshkruar nga kryetari i partisë, apo bartësi i listës për subjekte të tjera që zotohen për të respektuar dhe vepruar në përputhje me Kodin e Mirësjelljes siç është përcaktuar më tutje në këtë ligj;

5.7. deklarata politike, e cila nuk tejkalon njëqind e pesëdhjetë (150) fjalë, dhe në gjuhën apo gjuhët e zgjedhjes së saj, për qëllim të shpërndarjes së votuesve me qëllim të pjesëmarrjes në zgjedhje si votues jashtë Kosovës. Deklarata politike është në përputhje me Kodin e Mirësjelljes të përcaktuar në këtë ligj dhe të nënshkruar nga kryetari apo nënshkruesi i autorizuar për subjektin politik;

5.8. në rast të koalicionit, një deklaratë e nënshkruar nga kryetari i secilës parti politike të regjistruar e cila merr pjesë në koalicion përmes së cilës jepet pëlqimi për të marrë pjesë, duke bërë me dije mënyrën përmes së cilës kandidatët do të radhiten në fletëvotim në mesin e anëtarëve të koalicionit dhe që zotohen për të respektuar dhe vepruar në pajtim me Kodin e Mirësjelljes të këtij ligji;

5.9. në rastin e nismës qytetare, numrin e letërnjoftimit të udhëheqësit të nismës, përfaqësuesin e autorizuar dhe përfaqësuesin financiar të autorizuar. Në rast të kandidatit të pavarur apo nismës qytetare, kandidati apo udhëheqësi i nismës po ashtu mund të shërbejë si përfaqësues i autorizuar dhe përfaqësues financiar;

5.10. emri, mbiemri, adresa dhe numri i telefonit të udhëheqësit të listës së koalicionit, përfaqësuesit dhe përfaqësuesit financiar;

5.11. në rast të koalicionit, një kopje e çfarëdo shenje të koalicionit;

5.12. Zyra njoftohet për çfarëdo ndryshimi të kryetarit të partisë politike apo zyrtarit për financa brenda pesë (5) ditëve pas bërjes së ndryshimeve.

6. Subjekti politik dorëzon me aplikimin e tij certifikatën e pagesës siç përcaktohet me këtë ligj.
7. Përveç përjashtimeve të përcaktuara në paragrafin 8 të këtij neni, secili aplikim për certifikim përfshinë numrin e nevojshëm të nënshkrimeve siç parashihet me rregullën e KQZ-së.
8. Partia politike që ka marrë së paku një (1) ulëse në Kuvendin e Kosovës, nuk kërkohet të dorëzojë nënshkrimet në mbështetje të aplikimit të saj për certifikim në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe zgjedhjet lokale.
9. Subjekti politik që ka së paku një anëtar në kuvendin komunal, nuk kërkohet të dorëzojë nënshkrimet në mbështetje të aplikimit të tij për certifikim në zgjedhjet për atë kuvend komunal.
10. Personi mund të japë nënshkrimin e tij/saj në mbështetje të vetëm një subjekti politik për zgjedhje.
11. Çdo subjekt politik është i obliguar që në aplikimin e tij për certifikim, të zotohet me shkrim dhe të nënshkruajë për të respektuar Kodin e Mirësjelljes për Subjekte Politike siç përcaktohet në Kapitullin VI të këtij ligji.
12. Çdo subjekt politik në kërkesën e tij tregon nëse dëshiron të hyjë në garë për të fituar ndonjërin prej vendeve të garantuara për përfaqësim të serbëve dhe komuniteteve tjera jo-shumicë të Kosovës, sipas nenit 64 të Kushtetutës.
13. Çdo dështim në përmbushjen e kërkesave të këtij neni i jep të drejtë KQZ-së të pezullojë procesin e aplikimit. Përveç kërkesave të certifikimit të këtij kapitulli, më lartë, KQZ-ja, me pranimin e aplikimit për certifikim nga subjekti politik, përfshirë edhe partinë politike të regjistruar, kërkon nga PZAP-ja dhe Zyra të japë konfirmim me shkrim se subjekti politik që aplikon ka paguar plotësisht gjokat në lidhje me cilat do zgjedhje të mëparshme dhe të konfirmojë se nuk ka borxhe tjera të papaguara.
14. Të gjitha kërkesat për të tërhequr një subjekt të certifikuar politik nga zgjedhjet i dorëzohen KQZ-së.

## **Neni 17**

### **Shqyrtimi i aplikimeve për certifikim**

1. Zyra shqyrton të gjitha aplikimet për certifikim dhe nëse përcakton se subjekti politik nuk ka plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në nenin 16 të këtij ligji, atëherë Zyra brenda dhjetë (10) ditëve pas pranimit të aplikimit për certifikim dërgon një njoftim me të cilin e informon subjektin politik për arsyen ose arsyet pse aplikimi i tij nuk është i mjaftueshëm.
2. Aplikuesi i cili pranon njoftimin sipas paragrafit 5 të nenit 13 të këtij ligji, ka afat pesë (5) ditë pune për të dorëzuar aplikimin e korrigjuar apo një shpjegim që adreson brengat e identifikuara në njoftim.
3. Zyra i bën rekomandim me shkrim KQZ-së për apo kundër miratimit të secilit aplikim që pranon brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i dokumentacionit të plotë. Rekomandimet përmbajnë shpjegim të shkruar për secilin kriter. Asnjë parti nuk certifikohet nëse nuk i plotëson kriteret e përcaktuara më tutje.

4. Pas pranimit të rekomandimit nga Zyra, KQZ-ja e miraton ose refuzon aplikimin për certifikim brenda shtatë (7) ditëve.

5. Pas vendimit të KQZ-së, Zyra e njofton menjëherë aplikuesin me shkrim rreth statusit të aplikimit dhe në rast të refuzimit, ofron arsyetimin për refuzim dhe e këshillon aplikuesin për të drejtën e tij për t'u ankuar në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve. PZAP vendos për ankesën brenda dyze e tetë (48) orëve nga pranimi i saj.

## **Neni 18**

### **Çregjistrimi i partive politike**

1. Me vendimin e KQZ-së, Zyra e fshin nga regjistri i saj partinë politike, nëse:

1.1. pas regjistrimit, ndryshon aktet e brendshme të organizimit të saj dhe këto ndryshme bien ndesh me nenin 14 të këtij ligji;

1.2. partia politike e regjistruar nuk e dorëzon në Zyrë formularin për ta vazhduar regjistrimin e saj jo më vonë se 31 marsi i vitit kalendarik. Në rast të dështimit për t'u reregjistruar në përputhje me këtë nen, do të konsiderohet se partia do të largohet nga regjistri i partive politike;

1.3. vullnetarisht është shpërndarë në pajtim me statutin e saj;

1.4. ka qenë e pezulluar dhe nuk ka vepruar sipas afatit të shtuar paraprakisht të përcaktuar me vendimin e KQZ-së për pezullim.

## **Neni 19**

### **Koalicionet**

1. Koalicioni mund të certifikohet për të garuar në zgjedhje nën një emër, me kusht që përbëhet vetëm nga partitë politike që kanë të drejtë për t'u certifikuar sipas paragrafëve 4 dhe 5 të nenit 16 të këtij ligji.

2. KQZ-ja e trajton koalicionin si një subjekt politik të vetëm nga dita kur koalicioni është certifikuar nga ajo e deri në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve. Partia politike nuk mund të tërhiqet nga koalicioni pasi që të jetë certifikuar, derisa rezultatet e zgjedhjeve të certifikohen.

3. Pas shpërbërjes së koalicionit, secila nga partitë politike të regjistruara të cilat kanë qenë anëtare të koalicionit janë përgjegjëse për një ndarje të të gjitha borxheve të shkaktuara nga koalicioni në përpjesëtim me marrëveshjen për koalicionin, përfshirë gjokat e papaguara të ngarkuara nga KQZ-ja, Zyra apo PZAP-i.

4. Partia politike që është anëtare e koalicionit nuk mund të marrë pjesë si anëtare në një koalicion tjetër apo si parti politike e veçantë në të njëjtat zgjedhje.

5. Partia politike që është anëtare e koalicionit, pas përfundimit të mandatit për të cilin ka garuar, ruan dhe trashëgon të drejtat e fituara para themelimit të koalicionit.

## **Neni 20** **Nisma qytetare**

1. KQZ-ja e trajton nismën qytetare si subjekt politik nga dita e certifikimit të saj derisa nisma qytetare të dorëzojë raportin përfundimtar të publikimit financiar të fushatës sipas paragrafit 2 të nenit 41 të këtij ligji.
2. Secili kandidat i certifikuar i listës së nismës qytetare është personalisht përgjegjës për ndarje të barabartë të gjobave të ngarkuara mbi nismën qytetare nga KQZ-ja apo PZAP-i.
3. Nisma qytetare për të realizuar të drejtat nga ligji në fuqi për financimin e subjekteve politike, duhet të regjistrohet si parti politike. KQZ më akt të veçantë përcakton kushtet dhe mënyrën e njohjes së të drejtave të nismës qytetare, siç përcaktohet në këtë paragraf.

## **Neni 21** **Kandidatët e pavarur**

1. Kandidati i pavarur mund të certifikohet për pjesëmarrje në zgjedhje, me kusht që ai ose ajo ka të drejtë të jetë kandidat sipas nenit 30 të këtij ligji dhe është i/e regjistruar për të votuar.
2. Kandidati pavarur nuk mund, që në të njëjtat zgjedhje, të kërkojë certifikim si kandidat për një parti politike, koalicion apo nismë qytetare.
3. Një kandidat i pavarur nuk mund të tërheqë kandidaturën e tij apo saj para certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

## **Neni 22** **Emrat identik apo të ngjashëm**

1. KQZ-ja nuk e certifikon subjektin politik me emër apo akronim që është i njëjtë si, apo sipas gjykimit të KQZ-së, është i ngatërrueshëm, mashtrues ose i ngjashëm me, emrin apo akronimin me të cilin një subjekt tjetër politik është certifikuar më herët.
2. Nëse dy apo më shumë subjekte politike aplikojnë për certifikim me emra apo akronime që janë të njëjta, apo aq të ngjashme sa që me siguri se do të shkaktojnë ngatërrim apo çorientojnë votuesit, KQZ-ja vendos se cili subjekt ka të drejtën për t'u certifikuar me emrin dhe akronimin. Në vendimin se cili subjekt politik ka të drejtën për t'u certifikuar nën cilin emër dhe akronim, KQZ-ja ka parasysh datën kur secili subjekt ka dorëzuar aplikimin e tij në KQZ dhe përdorimin paraprak të emrave dhe akronimeve.

3. Asgjë në këtë nen nuk e pamundëson certifikimin e kandidatëve të pavarur me emrin ligjor të tij apo saj. Në rast se emrat janë të njëjtë, KQZ-ja mund të përfshijë informata për të bërë dallimin e tyre dhe për t'i ikur ngatërrimit në fletëvotim.

### **Neni 23** **Nënshkrimet**

1. Si pjesë e shqyrtimit sipas nenit 17 paragrafi 1 të këtij ligji, Zyra e rishikon secilën broshurë me nënshkrime të dorëzuar në mbështetje të aplikimit për certifikim për të siguruar se nënshkrimet janë të vlefshme.

2. Në vërtetimin e nënshkrimeve të mbështetjes, Zyra e rishikon secilën broshurë të nënshkrimeve të dorëzuar nga aplikuesit siç përcaktohet me rregullat e KQZ-së.

3. Llojet e nënshkrimeve në vijim konsiderohen si të pavlefshme dhe nuk llogariten ndaj kërkesës së nënshkrimeve:

3.1. nënshkrimet e personave të cilët nuk janë votues të regjistruar;

3.2. nënshkrimet e mbështetjes për të cilat çfarëdo informate e kërkuar mungon apo është e pa lexueshme;

3.3. nënshkrimet të cilat janë me të njëjtin dorëshkrim si nënshkrimet tjera, përfshirë nënshkrimet nga udhëheqësi i familjes për anëtarët e tjerë të familjes; dhe

3.4. nënshkrimet të cilat përfshijnë informata të cilat nuk përputhen me informatat e regjistruara në variantin më të fundit të listës së votuesve.

### **Neni 24** **Pagesa për certifikim**

Pagesat për certifikim vendosen ashtu siç përcaktohet me rregullat e KQZ-së.

### **Neni 25** **Renditja në fletëvotim**

1. Shorti i fletëvotimit mbahet në një datë të caktuar nga KQZ-ja.

2. Kryesuesi i KQZ-së vendos për procedurat që duhen respektuar gjatë tërheqjes së shortit, duke siguruar se tërheqja është e drejtë dhe transparente. Kryesuesi i KQZ-së e kryeson tërheqjen e shortit.

3. Zyra i njofton subjektet politike për vendndodhjen, datën, dhe kohën në të cilën shorti i fletëvotimit do të mbahet. Secili subjekt politik dërgon një përfaqësues për të tërhequr shortin dhe vëzhguar mbajtjen e



shortit të fletëvotimit. Kryesuesi i KQZ-së e kryeson lotarinë e fletëvotimit dhe nëse subjekti politik nuk e dërgon përfaqësuesin në shortin e fletëvotimit, një anëtar i Sekretariatit të KQZ-së e tërheq shortin për atë subjekt.

4. KQZ siguron që fletëvotimi të jetë i qartë dhe i kuptueshëm dhe merr masa paraprake për informimin me kohë të votuesve lidhur me përmbajtjen e tij dhe mënyrën e votimit/shënimit në të.

## **KAPITULLI IV CERTIFIKIMI I KANDIDATËVE**

### **Neni 26 Dispozitat e përgjithshme**

1. Një subjekt politik, koalicion i subjekteve politike, ose nismë qytetare që ka aplikuar për certifikim për pjesëmarrje në zgjedhje i dorëzon Zyrës me kohë dhe në mënyrën e përcaktuar sipas rregullave të KQZ-së listën e kandidatëve.
2. KQZ-ja e tërheq vendimin për certifikimin e subjektit politik, nismës qytetare ose koalicionit të certifikuar në rast të dështimit të dorëzimit të listës së kandidatëve në Zyrë në periudhën kohore të përcaktuar nga KQZ-ja.

### **Neni 27 Shqyrtimi i listës së kandidatëve**

1. Zyra i bën një rekomandim të shkruar KQZ-së për ose kundër certifikimit të secilës listë të kandidatëve të pranuar jo më vonë se pesë (5) ditë pune pas afatit për dorëzim të listave.
2. Zyra i shqyrton të gjitha listat e kandidatëve dhe në rast të përfundimit se subjekti politik i është përgjigjur kërkesave të Kapitullit III dhe IV të këtij ligji, atëherë i rekomandon KQZ-së certifikimin e listës brenda dhjetë (10) ditëve pas pranimi të listës.
3. Nëse Zyra vendos që lista e kandidatëve nuk përmbush dispozitën e mësipërme, në atë rast e njofton subjektin politik në fjalë që të korrigjojë listën e kandidatëve në periudhën brenda pesë (5) ditëve të punës, duke dhënë arsyetimin/et/ se përse lista e tyre duhet korrigjuar.
4. Subjekti politik i cili e pranon njoftimin e përcaktuar sipas paragrafit 3 të këtij neni i ka tre (3) ditë pune pas pranimi të njoftimit për të dorëzuar aplikimin e korrigjuar ose një arsyetim që adreson shqetësimet në çështjet e identifikuar në njoftim, ose të dyja bashkë.
5. Zyra i paraqet rekomandimin me shkrim KQZ-së për ose kundër certifikimit të listës së kandidatëve brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas dorëzimit të njoftimit sipas paragrafit 3 të këtij neni.

6. Ankesa e cilitdo subjekt politik ndaj vendimit të KQZ-së për refuzimin e certifikimit të listës së kandidatëve, parashtrohet në PZAP brenda afatit prej njëzet e katër (24) orë pune pas pranimit të vendimit. PZAP vendos për ankesën brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i saj.

### **Neni 28** **Kuotat gjinore**

1. Në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku tridhjetë (30 %) për qind janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30 %) për qind janë femra; me nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku njëherë në secilin grup prej tre kandidatëve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë.
2. Kjo dispozitë nuk aplikohet te listat e përbëra nga një apo dy kandidatë.
3. KQZ ndanë fonde publike shtesë, në vlerën një për qind (1%) të shumës së përgjithshme të alokuar për subjektin politik, për secilin mandat të fituar nga gratë mbi kuotën tridhjetë për qind (30 %) në momentin e certifikimit. KQZ-ja planifikon pas çdo palë zgjedhje buxhet shtesë për këtë qëllim.

### **Neni 29** **Tërheqja apo zëvendësimi i kandidatëve dhe subjekteve politike**

1. Subjekti politik i certifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar KQZ-së një njoftim me shkrim me të cilin shpreh qartazi qëllimin për tërheqje jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit për zgjedhje, të përcaktuar sipas nenit 25 paragrafi 1 të këtij ligji.
2. Në rast se PZAP-i largon një kandidat nga lista e kandidatëve pas përcaktimit se kandidati nuk ka dhënë pëlqimin e tij apo saj për t'u emëruar si kandidat, subjekti politik nuk mund të zëvendësojë atë kandidat në listën e kandidatëve, por siguron që lista të jetë në përputhje me nenin 28 të këtij ligji.
3. Duke mos paragjykuar dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni, një subjekt politik, nismë qytetare apo koalicion mundet brenda katër (4) ditëve pas largimit të kandidatit, ta zëvendësojë atë nëse ai kandidat në të njëjtën kohë paraqitet në listën e kandidatëve të një tjetër subjekti politik, nismë qytetare ose koalicioni dhe shfaq synim të qartë me shkrim se do të mbetet në listën e subjektit tjetër politik.
4. Në rast të vdekjes së kandidatit para mbajtjes së zgjedhjeve, një subjekt politik, nismë qytetare apo koalicion mund të zëvendësojë kandidatin e vdekur brenda një date të caktuar nga KQZ-ja.
5. Të gjitha kërkesat për të tërhequr një kandidat të certifikuar nga zgjedhjet i dorëzohen KQZ-së.

### **Neni 30** **Përshtatshmëria/aftësia e kandidatit**

1. Cilido person emri i të cilit paraqitet në Listën e votuesve është i aftë për certifikim si kandidat përveç nëse ai/ajo, në Republikën e Kosovës ose jashtë saj, është:

- 1.1. funksionar publik me status të veçantë, në bazë të ligjit në fuqi për zyrtarët publikë;
- 1.2. anëtar i shërbimit të jashtëm dhe përfaqësues diplomatik;
- 1.3. kryesues apo anëtar i KQZ-së dhe Komisionit Komunal të Zgjedhjeve;
- 1.4. zyrtar i PZAP-së;
- 1.5. me anë të vendimit të gjykatës, përfshirë edhe vendimin e PZAP-it, i është hequr e drejta për të qenë kandidat.

2. Përveç ndalesave nga paragrafi 1 i këtij neni, personi emri i të cilit paraqitet në Listën e votuesve nuk ka të drejtë kandidimi në zgjedhje, nëse:

- 2.1. është dënuar në tri (3) vitet e fundit me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale, me një ose më shumë vjet burgim efektiv;
- 2.2. ka dështuar të paguajë gjobën e vënë nga PZAP-i, apo KQZ-ja; ose
- 2.3. ka dështuar t'i përmbahet ndonjë urdhri të PZAP-it.

3. Numri i emrave të dorëzuar të kandidatëve nuk mund të jetë më shumë se dhjetë për qind (10 %) e maksimumit të numrit të ulëseve të caktuara.

4. Në rast të paraqitjes së më shumë kandidatëve sesa maksimumi i caktuar, KQZ-ja e redukton listën e kandidatëve deri në numrin që është në pajtim me dispozitat e këtij neni.

5. Nëse kandidati i cili është certifikuar nga KQZ-ja është apo ka arritur statusin sipas të cilit ai apo ajo humb aftësinë për të qenë kandidat sipas dispozitave të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, ai person decertifikohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe largohet nga lista e kandidatëve të subjektit politik në fjalë.

6. Asnjë person i zgjedhur anëtar i një organi tjetër legjislativ, nuk mund të ketë ulëse në Kuvendin e Kosovës. Anëtari i Kuvendit i cili pas marrjes së ulëses së tij apo saj në Kuvend është apo bëhet anëtar i një trupi tjetër të zgjedhur legjislativ, humb mandatin e tij apo saj në Kuvend.

7. Zyrtari publik ka të drejtë të kandidojë dhe të zgjidhet për Kuvendin e Republikës së Kosovës në pajtim me kushtet e përcaktuara në ligjin në fuqi për zyrtarët publikë.

8. KQZ-ja i publikon listat e certifikuara të kandidatëve në afat brenda pesë (5) ditëve pas certifikimit dhe secilin ndryshim në të brenda pesë (5) ditëve tjera shtesë.

9. Kandidati nuk mund të garojë për pozitë në më shumë se një listë kandidatësh të një subjekti politik, koalicioni, nisme qytetare, apo të garojë si kandidat i pavarur në të njëjtën kohë.

10. Paraqitja e qëllimshme e të dhënave të pavërteta që lidhen me zbatimin e të këtij neni konsiderohen shkelje të dënueshme në pajtim me rregullat e PZAP-it.

11. Institucionet kompetente me kërkesë të KQZ-së, bëjnë verifikimet e nevojshme sipas këtij neni.

### **Neni 31**

#### **Ruajtja dhe verifikimi i të dhënave të kandidatëve**

1. Sekretariati i KQZ-së, në përputhje me këtë ligj dhe rregullat e KQZ-së, do të mbajë në konfidencë të gjitha informacionet rreth kandidatëve të dorëzuara te KQZ-ja, deri pas certifikimit të kandidatit nga ana e KQZ-së, përveç rasteve kur Sekretariati i KQZ-së do t'u ofrojë të gjitha agjencive për zbatimin e ligjit secilin informacion të nevojshëm për këto organizata me qëllim të sigurisë gjatë procesit të zgjedhjeve.

2. Pasi kandidati të jetë certifikuar, KQZ-ja mund të publikojë të dhënat personale të atij personi vetëm siç lejohet me ligjin përkatës.

3. Në rast se KQZ-ja nuk certifikon një kandidat, Sekretariati i KQZ-së nuk i zbulon të dhënat personale të atij kandidati.

## **KAPITULLI V**

### **KODI I MIRËSJELLJES PËR SUBJEKTET POLITIKE, MBËSHTETËSIT E TYRE DHE KANDIDATËT**

#### **Neni 32**

#### **Qëllimi i Kodit të Sjelljes**

Kodi i Sjelljes për subjektet politike dhe mbështetësit e tyre dhe kandidatët ka për qëllim krijimin e kushteve në të cilat populli i Kosovës mund të zgjedhë përfaqësuesit e tij përmes zgjedhjeve të lira, të drejta dhe të mirë-informuara në një atmosferë të tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

#### **Neni 33**

#### **Përgjegjësitë e Subjekteve Politike, Mbështetësve të tyre dhe Kandidatëve**

1. Këtij Kodi i detyrohen të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre.

2. PZAP-i ka autoritet ligjor të marrë vendim në pretendimet se janë shkelur dispozitat e këtij Kodi si dhe të shpallë sanksione dhe kompensime në përputhje me procedurat e saj.

3. Subjektet politike informojnë në mënyrë të duhur anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre rreth dispozitave të këtij Kodi.
4. Subjektet politike ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për të parandaluar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre nga shkelja e këtij Kodi.
5. Subjektet politike mbahen përgjegjëse për shkeljet e këtij Kodi të kryera nga anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre.
6. Subjekti politik mund të paraqesë prova pranë PZAP-it që tregojnë se ka bërë përpjekje serioze për të parandaluar dhe/ose dekurajuar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tij nga shkelja e këtij Kodi. Këto dëshmi mund të përdoren në përcaktimin e duhur të masave të mëtejshme dhe mund të përfshijë dëshmi se:
  - 6.1. subjekti politik ka informuar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tij për dispozitat e këtij Kodi dhe nevojat për të zbatuar dispozitat e tij;
  - 6.2. subjekti politik dhe kandidatët e tij publikisht janë shprehur për dënimin e dhunës, kërcënimeve me dhunë, apo frikësim gjatë procesit zgjedhor;
  - 6.3. subjekti politik në mënyrë publike dhe aktive ka bërë qortimin e anëtarëve, mbështetësve dhe kandidatëve të tij për çdo shkelje të ligjeve të aplikueshme që kanë të bëjnë me zgjedhjet;
  - 6.4. subjekti politik nuk ka nxitur, shtytur apo përkrahur anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tij në shkeljen e Rregullave të Zgjedhjeve në ndonjë rast të veçantë apo në raste tjera; dhe
  - 6.5. çdo provë tjetër në lidhje me përpjekjet e subjektit politik për të parandaluar anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tij nga shkelja e Rregullave të Zgjedhjeve.
7. Secili kandidat nënshkruan një deklaratë me të cilën konfirmohet se ai ose ajo do i bindet të gjitha ligjeve të aplikueshme dhe mbështet zbatimin e plotë të rezultateve zgjedhore të certifikuara.

### **Neni 34**

#### **Veprimet e Ndalura të Subjekteve Politike**

1. Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim:
  - 1.1. heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posterit ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;
  - 1.2. vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave

ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve;

1.3. mbajtja ose ekspozimi i armëve të secilit lloj gjatë tubimeve politike ose gjatë çfarëdo lloj ngjarjeje që ka lidhje me aktivitetet e subjekteve politike. Mbajtja e armëve nga personat e tjerë gjatë tubimeve politike/manifestimeve lejohet vetëm në rast se personat që mbajnë armë të tilla janë të autorizuar për një gjë të tillë nga autoritetet përkatëse dhe që Policia e Kosovës është njoftuar paraprakisht se të tilla armë do të mbahen në tubimet e caktuara;

1.4. çrregullimi i tubimeve të subjekteve tjera politike ose nxitja e të tjerëve për një veprim të tillë;

1.5. pengimi ose tentimi për pengimin e gazetarëve për të përmbushur detyrat e tyre profesionale;

1.6. premtimi i ndonjë shpërblimi financiar me qëllim të përfitimit të mbështetjes së votuesve;

1.7. kërcënimi ose tentimi për të kërcënuar subjektet tjera politike, përkrahësit ose kandidatët e tyre;

1.8. nxitja e cilitdo person për të votuar në zgjedhje, i cili nuk ka të drejtë vote;

1.9. nxitja e personit për të votuar më shumë se një herë në të njëjtat zgjedhje ose të votojë në emër të një personi tjetër;

1.10. abuzimi me të drejtën e ankesës, ose duke bërë ankesa ose paraqitje të rrejshme, të pavlera dhe irrituese në PZAP;

1.11. përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë.

### **Neni 35**

#### **Frikësimi dhe Dhuna Gjatë Procesit Zgjedhor**

1. Përdorimi ose kërcënimi me përdorim të dhunës së çfarëdo lloji nga subjekti politik, anëtarët, mbështetësit ose kandidatët e tyre, ndalohet rreptësisht.

2. Asnjë subjekt politik ose kandidatët nuk inkurajojnë, mbështesin ose miratojnë dhunën, kërcënimet me dhunë ose kanosje, gjatë procesit zgjedhor. Secili subjekt politik i informon anëtarët dhe mbështetësit e tij për nevojën për të shmangur një sjellje të tillë.

3. Fushata zgjedhore organizohet në atë mënyrë që një atmosferë e pëlqyeshme dhe paqësore të mbizotërojë gjatë fushatës zgjedhore.

4. KQZ miraton udhëzues për subjektet politike, kandidatët dhe qytetarët që të parashtrojnë ankesat e tyre në organet kompetente kundër kërcënimeve, pengimit dhe/apo cenimit të ushtrimit të ligjshëm të të drejtave zgjedhore, duke përfshirë edhe rregullat për kufizimin e lirisë së shprehjes me qëllim të parandalimit të gjuhës së urrejtjes, parandalimit të trazirave apo veprimeve të tjera të paligjshme.

### **Neni 36** **Veprimet e ndaluara nga nëpunësi publik**

1. Personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike, qoftë të nivelit qendror ose lokal, ose edhe ndonjë ndërmarrjeje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale, nuk mund të shfrytëzohen ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje.

2. Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore asnjë subjekt politik nuk inkurajon ose përfiton nga nëpunësi publik duke përdorur pozitën publike të tij ose saj për të zhvilluar fushatë për subjektin politik.

3. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të subjekteve politike në zgjedhje, burime ose resurse të institucioneve apo organeve publike në nivel qendror ose lokal, apo çdo lloj institucioni tjetër publik.

### **Neni 37** **Veprimet e Ndaluar Para Procesit të Votimit**

1. Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë:

1.1. shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, dhe oborri i së njëjtës, e çfarëdo lloj materialit me qëllim ndikimi të votuesit;

1.2. bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.

### **Neni 38** **Pranimi i Rezultateve të Zgjedhjeve**

Të gjitha subjektet politike, mbështetësit dhe kandidatët e tyre, obligohen t'u përmbahen rezultateve të zgjedhjeve si dhe të mbështesin zbatimin e plotë të rezultateve zgjedhore të certifikuara.

**Neni 39**  
**Sanksionimi për shkeljet e parimeve të këtij Kodi**

1. Shkeljet e Kodit të Sjelljes të përcaktuara në këtë ligj, në rastet kur nuk kanë ndikuar në rezultatet e zgjedhjeve, konsiderohen shkelje administrative dhe të dënueshme me gjobë, sikurse është përcaktuar nga PZAP-i.
2. Shkeljet e Kodit të Sjelljes të përcaktuara në këtë ligj, në rastet kur kanë ndikuar në rezultatet e zgjedhjeve, përveç sanksioneve përkatëse, PZAP i procedon në prokurorinë kompetente.
3. Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Sjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatet gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, mund të paraqesë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe PZAP-i do të vendosë për ankesën brenda shtatëdhjet e dy (72) orëve nga koha e pranimit të saj.

**KAPITULLI VI**  
**KUFIZIMI I SHPENZIMEVE TË FUSHATËS DHE DEKLARIMI FINANCIAR**

**Neni 40**  
**Kufizimi i Shpenzimeve të Fushatës dhe Kontributet**

1. Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të bëjë tejkalime në shpenzime të fushatës mbi shumën që do të caktohet nga rregulla e KQZ-së jo më vonë se pesë (5) ditë pas ditës së shpalljes së zgjedhjeve.
2. KQZ-ja përcakton maksimumin e shpenzimeve të fushatës mbështetur në numrin e përgjithshëm të votuesve të regjistruar në listën e votuesve në kohën e freskimit të fundit të listës së votuesve në dispozicion të KQZ-së.
3. Shpenzimet maksimale për fushatë zbatohen për çdo mall dhe shërbim të shpenzuar për qëllime të fushatës pa marrë parasysh kohën e blerjes apo të pajisjes me shërbime.
4. Subjekti politik nuk pranon çfarëdo kontributi, përveç në mënyrën e rregulluar me legjislacionin në fuqi.

**Neni 41**  
**Kërkesat për Deklarim Financiar**

1. Çdo subjekt politik i certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje, dorëzon Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës së Subjektit, duke i përfshirë të gjitha degët dhe pjesët përbërëse të tij, për periudhën që fillon nëntëdhjetë (90) ditë para zgjedhjeve dhe me mbarim në ditën e zgjedhjeve. Raporti i Publikimit Financiar për Fushatën dorëzohet jo më vonë se tridhjetë (30) ditë kalendarike pas ditës certifikimit të zgjedhjeve.



2. Secili Raport i Publikimit Financiar të Fushatës, i secilit subjekt politik, duke i përfshirë të gjitha degët e tyre dhe pjesët përbërëse, përfshinë publikimin komplet dhe të saktë të:

2.1. të ardhurave të subjektit politik për periudhën raportuese, përfshirë burimin dhe datën e të gjitha kontributeve me para të gatshme;

2.2. të gjitha shpenzimet, përfshirë shpenzimet e fushatës, të bëra nga subjekti gjatë periudhës raportuese; dhe

2.3. një fletë bilanci që i paraqet pasuritë, detyrimet dhe barazimin e subjektit prej ditës së parë deri te dita e fundit e periudhës së raportimit.

3. Subjektet politike i sigurojnë Zyrës kopjet e dëftesave për secilën pagesë administrative të paguar.

4. Zyra do i raporton KQZ-së për secilën pagesë administrative të mbledhur dhe të transferuar në Buxhetin e Kosovës.

5. Nëse një subjekt politik nuk e dorëzon Raportin e Publikimit Financiar të Fushatës deri në afatin përfundimtar ose, nëse e dorëzon raport jo të plotë ose të pasaktë, Zyra mund t'ia paraqesë ankesën PZAP-it në pajtim me procedurat e atij organi.

6. Secili subjekt politik i certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje i mban dhe ruan në arkivat e tyre, për një periudhë shtatë (7) vjeçare, shënimet e sakta dhe të detajuara të gjendjes financiare të subjektit dhe të gjitha degëve për periudhën e mbuluar me Raportet e Publikimit Financiar të Fushatës, përfshirë:

6.1. librat e mbajtjes së llogarive me shënime, në pajtueshmëri me parimet llogaritëse të pranuar në përgjithësi:

6.1.1. të gjitha të ardhurat sipas burimit, shumës, duke e identifikuar mënyrën se si është kryer pagesa (d.m.th., para të gatshme, çek, draft bankier, etj.); dhe

6.1.2. të gjitha pagesat të cilat i ka kryer subjekti ndaj personit tjetër, qëllimi i pagesës dhe mënyra se si është kryer pagesa.

6.2. dëftesat për të gjitha shpenzimet që tejkalojnë shumën prej njëqind euro (100 €);

6.3. shënimet bankiere për të gjitha llogaritë të cilat i mban subjekti politik ose që janë në emër të tij;

6.4. dokumentet të cilat e ndërtojnë bazën ligjore për pronësi ose posedim të tërë pasurisë së patundshme të subjektit politik;

6.5. kontratat, partner i të cilave është subjekti, përfshirë kontratat lidhur me qiranë ose blerjen e pasurisë së tundshme apo të patundshme;

6.6. një regjistrim i të gjitha kontributeve të subjektit, pa marrë parasysh se kur janë bërë, përfshirë:

6.6.1. vlerën e secilit kontribut;

6.6.2. datën kur secili kontribut është dhënë;

6.6.3. emrin e plotë, adresën dhe Regjistrimin Civil, numrin e pasaportës ose të lejes së vozitjes të secilit kontribues; dhe

6.6.4. emrin e plotë të personit i cili e ka pranuar kontributin në emër të subjektit.

7. Të gjithë zyrtarët për financa ndjekin një trajnim për llogaritjen dhe auditimin, të organizuar nga Zyra menjëherë pas emërimit të tyre, nëse ata nuk i ofrojnë Zyrës një shkallë të pranueshme të ekspertizës dhe përvojës që tregon se një trajnim i tillë nuk është i domosdoshëm.

## **Neni 42 Sanksionet**

1. Zyra do të shqiptojë gjoba në pajtim me rregullat, kundër subjekteve politike që paraqesin Raportet e Publikimit Financiar të Fushatës pas afatit të zbatueshëm. Zyra do të derdhë çdo gjobë që mbledh sipas këtij ligji në Buxhetin e Kosovës.
2. Vendorsja e një gjobe ose sanksioni tjetër nga KQZ-ja ose Zyra nuk paragjykon ndonjë sanksion penal që mund të zbatohet.
3. Subjekti politik mund të ankimoj vendimin e KQZ-së ose të Zyrës për vendosjen e gjobës pranë gjykatës kompetente të shkallës së parë brenda pesë (5) ditëve të punës pas njoftimit të vendimit.
4. Gjykata e shkallës së parë nuk vendos sanksione në lidhje me një çështje që i nënshtrohet një gjobe të lëshuar sipas paragrafit 1 të këtij neni.
5. Subjektet politike duhet t'i paraqesin Zyrës një kopje të fletëpagesës së gjobës së paguar.

## **Neni 43 Publikimi i Raportit të Fushatës**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, publikon raportin e fushatës në pajtim me ligjin në fuqi për Financimin e Subjekteve Politike.

## **KAPITULLI VII**

### **FUSHATA E ZGJEDHJEVE DHE NJOFTIMI PËR NGJARJET POLITIKE**

#### **Neni 44**

##### **Dispozitat e Përgjithshme**

1. Sipas kushteve të saktësuara në Kodin e Sjelljes, gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, subjektet politike kanë të drejtë:

1.1. të organizojnë dhe mbajnë tubime/ngjarje politike, tryeza të rumbullakëta, konferenca për shtyp, fjalime, ose ndonjë aktivitet tjetër të ngjashëm, përmes të cilave ata mund t'i shprehin lirisht mendimet e tyre me qëllim të fitimit të përkrahjes nga votuesit e tyre;

1.2. të publikojnë dhe të shpërndajnë afishe, reklama dhe material tjetër lidhur me një fushatë zgjedhore; dhe

1.3. të bëjnë fushatë përmes cilitdo operator televiziv, të radios apo kabllor, gjithashtu edhe përmes revistave, shtypit, rrjetit telefonik, sistemit postar ose çdo lloj mjeti tjetër reklamues, në pajtim me rregullat e KQZ-së dhe ligjet tjera në fuqi.

2. Mosmarrëveshjet në lidhje me mbajtjen e ndonjë ngjarje politike në vendet publike mund të shqyrtohen dhe zgjidhen nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa. Raportet e policisë në lidhje me trazirat në ndonjë ngjarje politike i vihen në dispozicion Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa dhe KQZ-së.

3. KQZ miraton dhe publikon rregullat specifike të fushatës, që lidhen me njoftimin dhe organizimin e ngjarjeve politike, rregullat për postimet zgjedhore dhe rregullat për përfshirjen e zyrtarëve të zgjedhur në fushatën zgjedhore etj.

#### **Neni 45**

##### **Pjesëtarët e Armatosur të Njesisë për Mbrojtje nga Afërsia në Tubimet Politike**

Anëtarët e njesisë për mbrojtje nga afërsia, të autorizuar nga autoriteti i ligjit në fuqi për bartjen e armëve, të cilët janë në detyrë, identifikohen paraprakisht në çdo tubim dhe pas kërkesës së zyrtarit të pranishëm të Policisë së Kosovës. Të gjitha armët që mbahen duhet të mbahen të fshehura.

#### **Neni 46**

##### **Sanksionet**

Përveç përgjegjësisë individuale për cenimin e cilësdo dispozitë të këtij Kapitulli, që është e ndëshkueshme me Kodin Penal të Kosovës, cenimet gjithashtu mund t'i referohen Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa. Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa mund t'i shqiptojë sanksione subjektit politik që ka shkelur këtë dispozitë të këtij Kapitulli.

## **KAPITULLI VIII MEDIAT GJATË FUSHATËS SË ZGJEDHJEVE**

### **Neni 47 Dispozitat e Përgjithshme**

1. Kodi i Sjelljes për Mediat Transmetuese dhe Kodi i Sjelljes (KS) për Mediat e Shkruara, siç janë nxjerrë nga Komisioni i Pavarur për Media, zbatohet ndaj të gjitha aspekteve të prezantimit të fushatës dhe transmetimit të reklamave. Ky Kod i Sjelljes zbatohet për të gjithë gazetarët, redaktorët, udhëheqësit e transmetimit dhe botuesit.
2. Të gjitha mediat transmetuese publike emetojnë pa pagesë material për edukimin e votuesve, ashtu siç kërkohet dhe u sigurohet nga KQZ-ja.
3. Gazetarët, redaktorët, udhëheqësit e transmetimeve, botuesit dhe pronarët e mediave që kandidohen në zgjedhje për një post publik, nuk kontribuojnë ose përndryshe ndikojnë në përmbajtjen e mediave të tyre përkatëse.
4. Të gjitha mediat pranojnë reklamimin me pagesë në gjuhën(t) në të cilën ato normalisht transmetojnë ose publikojnë.
5. Publikimi ose përfshirja në transmetim të hulumtimeve të opinionit dhe të anketave gjatë periudhës së fushatës dhe që kanë të bëjnë me zgjedhjet përcillet me numrin e gjithëmbarshëm të respondentëve, emrin e kompanisë realizuese, emrin e partisë përgjegjëse për atë hulumtim, dhe margjinën e gabimit.
6. Komisioni i Pavarur për Media në mënyrë periodike rishikon aktet nënligjore për të cilat ka përgjegjësi ligjore, e të cilat pos tjerash përfshijnë edhe rregullimin e aspekteve të komunikimit digjital (fushata online) në fushatën zgjedhore dhe në procesin zgjedhor në përgjithësi, por edhe vendosjen e detyrimit për krijimin e arkivave të reklamave në internet, duke përcaktuar kërkesa të hollësishme të raportimit për ata që paguajnë për materiale të sponsorizuara dhe për subjektet që kanë pranuar pagesa.

### **Neni 48 Qasja e Drejtë dhe e Paanshme nga Mediat gjatë Fushatës së Zgjedhjeve**

1. Të gjitha mediat sigurojnë se të gjitha subjektet politike të certifikuara përfaqësohen në mënyrë të drejtë dhe të paanshme në emisionet gjatë fushatës së zgjedhjeve, dhe të gjitha mediat transmetuese u sigurojnë të gjitha subjekteve politike të certifikuara qasje të drejtë dhe të paanshme në programet me diskutime politike dhe debate.
2. Komisioni i Pavarur për Media (KPM) në pajtim me dispozitat e Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave, miraton udhëzim për rregullimin e blerjes së kohës së emetimit nga subjektet politike në mediat transmetuese.

3. Udhëzimi i KPM-së nga paragrafi 2 i këtij neni, siguron kushte të barabarta dhe mosdiskriminuese për qasje në kohën e tillë, shpalosje publike të listave të çmimeve, si dhe vendosje të kufirit në sasinë e kohës së emetimit që transmetuesi mund t'ia shesë secilit subjekt politik gjatë fushatës zgjedhore.

#### **Neni 49**

### **Rregullat e Përgjithshme për Reklamim Politik në Radio dhe Televizion**

1. Pikat reklamuese politike nuk janë më të gjata se dy (2) minuta (120 sekonda).
2. Nga transmetuesit të cilët vendosin të emetojnë reklamim politik me pagesë kërkohet që gjatë periudhës së fushatës t'i ofrojnë një sasi minimale minutash të kohës për emetim pa pagesë secilit subjekt politik të certifikuar:
  - 2.1. njëzet (20) minuta për transmetues televiziv privat që transmetojnë në tërë Kosovën;
  - 2.2. dyzet (40) minuta për Transmetuesin Televiziv të Shërbimit Publik;
  - 2.3. pesëmbëdhjetë (15) minuta për secilin radio stacion privat që transmeton në tërë Kosovën;
  - 2.4. tridhjetë (30) minuta për secilin nga kanalet e dy radiove publike;
  - 2.5. pesëmbëdhjetë (15) minuta për të gjitha stacionet tjera televizive;
  - 2.6. dhjetë (10) minuta për të gjitha radio stacionet tjera.
3. Kjo kohë e emetimit pa pagesë mund të sigurohet sipas vlerësimit të transmetuesve individual, në formë të pjesëmarrjes në debate, programe diskutimi, intervista jashtë programeve të rregullta informative të parapara, ose si pika reklamuese politike pa pagesë.
4. Përfshirja në programet e rregullta informative të parapara nuk llogaritet si kohë emetimi pa pagesë.
5. Në kuadër të programeve informative nuk emetohet asnjë pikë reklamuese politik. Për qëllim të këtij neni, programet informative përkufizohen si programe që përfshijnë komponentët e sportit dhe të motit në transmetimet e lajmeve.
6. Transmetuesit përkujdesen që çdo pikë reklamuese politike të identifikohet qartë si e tillë dhe të tregojë qartë organizatën ose individin përgjegjës për të.
7. Nga transmetuesit kërkohet të mbajnë ditarë të veçantë ditorë, të siguruar nga KPM-ja, për qasjet e siguruar pa pagesë dhe kohët për reklamim që i janë shitur çdo subjekti politik të certifikuar. Këta ditarë përgatiten dhe i dorëzohen KPM-së për çdo javë në përputhje me udhëzimet e dhëna. Pasi të merren, ditarët janë të hapur për t'u shikuar nga publiku.

8. Transmetuesit të cilët zgjedhin të transmetojnë reklama të paguara politike ofrojnë, një javë para fillimit të periudhës së fushatës, një orar me shkrim të kohëve të paanshme dhe të drejta të emetimit pa pagesë për pikat reklamuese politike për të gjitha subjektet politike të certifikuara.
9. Transmetuesit nuk ndëshkohen nëse një subjekt politik i certifikuar nuk e shfrytëzon kohën e ofruar në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.
10. Koha e gjithëmbarshme e pikave reklamuese politike të emetuara pa pagesë në një transmetues është më së shumti njëzet (20) minuta për një subjekt politik të certifikuar.
11. Transmetuesit që vendosin të transmetojnë reklamimet politike me pagesë, por që gjatë rrjedhës së periudhës së fushatës nuk ofrojnë minimumin e kohëve të kërkuara për emetim pa pagesë për subjektet politike të certifikuara konsiderohet se e kanë shkelur këtë ligj.
12. Nga transmetuesit privat të cilët vendosin të mos transmetojnë reklamim politik me pagesë për asnjë subjekt politik të certifikuar, nuk kërkohet të ofrojnë minimumin e kohës së emetimit pa pagesë, siç specifikohet në paragrafin 2 të këtij neni.
13. Transmetuesit privat të cilët vendosin të mos emetojnë reklamime politike me pagesë, por që ofrojnë kohë për emetim pa pagesë për cilindo subjekt politik të certifikuar, duhet që kohë të ngjashme për emetim pa pagesë t'u sigurojnë të gjitha subjekteve politike të certifikuara.
14. Çmimi për një sekondë me të cilin ngarkohen për pika reklamuese politike me pagesë nuk është më i lartë sesa shkalla më e ulët e ngarkuar për atë kohë dhe ditë të javës gjatë gjashtë (6) muajve të fundit.

## **Neni 50**

### **Reklamimi Politik me Pagesë në Mediat e Shkruara dhe Mediat elektronike**

1. Mediat e shkruara dhe elektronike u sigurojnë qasje të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjekteve politike të certifikuara që kërkojnë hapësirë reklamuese.
2. Një medium i shkruar apo elektronik aplikon çmime të njëjta pa diskriminim ndaj të gjitha subjekteve politike të certifikuara.
3. Çdo reklamim politik me pagesë e tregon organizatën ose individin përgjegjës për të.
4. Hapësira për reklamim pa pagesë, e siguruar për subjektin politik të certifikuar, identifikohet qartë si e tillë. Hapësira e ngjashme pa pagesë u sigurohet menjëherë të gjitha subjekteve politike të tjera të certifikuara që e kërkojnë këtë.
5. Mediat e shkruara dhe elektronike i ngarkojnë subjektet politike të certifikuara me norma të reklamimit që nuk janë më të larta se normat më të ulëta të reklamimit të publikuara zyrtarisht dhe të ofruara për të gjithë reklamuesit e tjerë për hapësirë dhe numër të ngjashëm të rreshtave në faqe, e që janë në përdorim tridhjetë (30) ditë para periudhës së fushatës.

## **Neni 51**

### **Rregullimi i procedurave të ankesave**

1. Të gjitha ankesat përkitazi me shkeljen e këtij Kapitulli nga subjektet politike parashtrohen në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), ndërsa shkeljet nga mediat parashtrohen në Komisionin e Pavarur për Media (KPM) në pajtim me dispozitat e Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave.
2. Të gjitha ankesat të cilat pretendojnë shkeljen e këtij Kapitulli përcillen nga PZAP-i për shqyrtim dhe vendosje nga KPM-ja.
3. Cenimi i detyrave dhe përgjegjësive të mediave, siç është shpallur në këtë Kapitull, mund të përfundojë me sanksione nga KPM-ja.
4. PZAP është autoritet kompetent për shqiptimin e sanksioneve subjekteve politike të certifikuara lidhur me shkeljen e këtij Kapitulli në pajtim me dispozitat e Kapitullit XX të këtij ligji. Shkeljet tjera të këtij neni i referohen PZAP-it. Para shqiptimit të gjobës, PZAP-i kërkon nga subjektet politike evitimin e menjëhershëm të shkeljes brenda afatit të caktuar. Kjo vlenë për shkeljet që mund të mënjanohen dhe nuk kanë pasoja të mëdha dhe të pariparueshme.
5. Komisioni i Pavarur për Media zbaton afate të shkurta të shqyrtimit dhe vendosjes së ankesave që lidhen me procesin zgjedhor. Vendimet e KPM u dërgohen palëve dhe bëhen publike jo më larg se njëzet e katër (24) orë nga marrja e tyre.

## **Neni 52**

### **Ndalimi i Përfshirjes në Media**

1. Asnjë person ose medium nuk transmeton ose publikon çfarëdo materiali që i takon aktivitetit të fushatës, gjatë periudhës që fillon me hapjen e vendotimeve deri në mbylljen zyrtare të tyre.
2. Në Kosovë nuk bëhet asnjë publikim ose transmetim i rezultateve të hulumtimit të opinionit publik që ka të bëjë me fushatën e zgjedhjeve, duke përfshirë daljen në votime, gjatë periudhës që fillon njëzet e katër (24) orë para mbylljes zyrtare të vendotimeve dhe deri në përmbylljen e procesit zgjedhor.

## **Neni 53**

### **Mirëmbajta e Ditarit të Mbulimit të Mediave**

1. Komisioni i Pavarur për Media siguron se mediat mirëmbajnë një ditar për të regjistruar kohën e emetimit, dhe ekspozimeve tjera të mediave, për reklamim me pagesë dhe pa pagesë, të aktiviteteve të fushatës për secilën parti. Ditari i vlerëson të gjithë treguesit relevant të ekspozimeve, ndaras për secilin subjekt politik, sipas mënyrës së përcaktuar me rregullat e KPM-së.
2. KPM harton dhe publikon raport përfundimtar mbi procesin e parashtrimit dhe shqyrtimit të ankesave, duke përfshirë edhe vendimet dhe gjobat e shqiptuara për shkeljet e mediave të shkruara dhe elektronike.

## **KAPITULLI IX VËZHguesIT E ZGJEDHJEVE**

### **Neni 54 Dispozitat e Përgjithshme**

1. Subjektet politike të certifikuara, OJQ-të dhe organizatat qeveritare e ndërqeveritare, sikurse edhe organizatat ndërkombëtare të specializuara të cilat merren me zgjedhjet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfaqësuesit e vendeve të huaja, kanë të drejtë të kërkojnë akreditim të vëzhguesve për zgjedhje.
2. Një person nuk mund të jetë vëzhgues vendor nëse ai/ajo nuk i përmbushë kriteret e së drejtës për të votuar në zgjedhje.
3. Kërkesën për akreditim të vëzhguesve, çdo subjekt politik mund ta parashtrorë pranë KQZ-së në çdo kohë, deri në ditën e njëzet e pesë (25) para ditës së zgjedhjeve.
4. Kërkesën për akreditim të vëzhguesve, çdo organizatë jo qeveritare, qeveritare, ndërqeveritare, organizata ndërkombëtare, përfaqësuesit e vendeve të huaja mund ta parashtrorë pranë KQZ-së në çdo kohë, deri në ditën e pesëmbëdhjetë (15) para ditës së zgjedhjeve.
5. Kërkesën për akreditim të vëzhguesve, çdo medium mund ta parashtrorë pranë KQZ-së në çdo kohë, deri në ditën e pestë (5) para ditës së zgjedhjeve.
6. Akreditimi i individëve për vëzhgim të zgjedhjeve në emër të ndonjë organizate duhet të parashtrorë në KQZ jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë para ditës së zgjedhjeve.
7. KQZ-ja miraton ose refuzon kërkesat: e subjekteve politike jo më vonë se dhjetë (10) ditë, organizatave dhe individëve jo më vonë se pesë (5) ditë dhe, mediave jo më vonë se dy (2) ditë pas parashtrimi të saj.
8. Çdo subjekt politik, organizatë, medium apo individ që ka aplikuar për akreditim për vëzhgues të procesit zgjedhor e që i është refuzuar akreditimi nga KQZ-ja, mund të parashtrorë ankesë në PZAP brenda afatit prej dyzet e tetë (48) orëve, pas vendimit për mos akreditim. PZAP-i do të vendosë për ankesën brenda shtatdhjetë e dy (72) orëve nga koha e pranimit të saj.
9. KQZ-ja mund të anulorë në çdo kohë akreditimin e një vëzhguesi të procesit zgjedhor që ka cenuar ligjislacionin në fuqi të procesit zgjedhor.

### **Neni 55 Kualifikimi i Vëzhguesve**

1. Të gjithë vëzhguesit e akredituar, përveç atyre të emëruar nga ndonjë organizatë ndërqeveritare, qeveri e huaj ose OJQ-të jo të regjistruar në Kosovë, janë persona të regjistruar për votim në zgjedhje.
2. Asnjë person nuk mund të shërbejë si vëzhgues zgjedhor nëse është:



- 2.1. kandidat për post zgjedhor në Kosovë; ose
  - 2.2. pjesëtar i policisë, ushtarak ose i njësitit të inteligjencës së Kosovës ose i një shteti tjetër.
3. Organizata e akredituar për vëzhgim e shënon emrin e plotë, adresën dhe numrin e telefonit për kontaktim për secilin vëzhgues të saj dhe informatat e tilla i vë në dispozicion menjëherë pas kërkesës së KQZ-së ose të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës.
4. Përgjegjësia për të raportuar çdo papajtueshmëri të përshkruar më lart, bie mbi secilin vëzhgues të emëruar dhe mbi organizatën që e parashtron kërkesën për akreditim të vëzhgimit të procesit zgjedhor. Nëse zbulohet se vëzhguesi mban ndonjërin nga pozitat e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni, KQZ-ja e tërheq akreditimin e vëzhguesit.

### **Neni 56** **Të Drejtat dhe Detyrat e Vëzhguesve**

#### 1. Vëzhguesi ka të drejtë të:

- 1.1. vëzhgojë, pa u penguar, përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve, përfshirë takimet pas ditës së zgjedhjeve, dëgjimet dhe aktivitetet lidhur me zgjedhjet, ankesat dhe parashtrësat lidhur me rezultatet e zgjedhjeve dhe përcaktimin e kandidatëve fitues;
- 1.2. parashtrëjë komente me shkrim komisioneve zgjedhore dhe këshillave të vendvotimeve;
- 1.3. vëzhgojë paketimin, transferimin, dorëzimin, trajtimin, numërimin, ruajtjen e sigurt dhe shkatërrimin e fletëvotimeve;
- 1.4. pajset me kopjet e vendimeve, protokollat, tabelat, procesverbalet dhe dokumentacionin tjetër gjatë gjithë procesit zgjedhor, përfshirë proceset para dhe pas ditës së zgjedhjeve.

2. Gjatë procesit zgjedhor, përfshirë edhe procesin e regjistrimit të votuesve, vëzhguesi i akredituar mund të parashtrëjë ankesë për çfarëdo shkelje të Rregulloreve në fuqi, Urdhëresave Administrative, Rregullave Zgjedhore ose Procedurave Administrative pranë KQZ-së në pajtim me procedurat e saj.

#### 3. Vëzhguesi ka për detyrë të:

- 3.1. respektojë kërkesat e këtij ligji dhe rregullat e KQZ-së;
- 3.2. mbajë distinktivin e identitetit të vëzhguesit në mënyrë të dukshme kur është i angazhuar në aktivitete të vëzhgimit;
- 3.3. përmbahet nga bartja e shenjave dalluese të cilat shërbejnë si mjete propaganduese ose që mund të ndikojnë në dëshirën e votuesit ose e identifikon atë me një parti të caktuar politike ose kandidat; dhe

3.4. përmbahet nga shkelja e të drejtës së votuesit për fshehtësi të fletëvotimit dhe nga pengimi i procesit të të votuarit dhe administrimit të zgjedhjeve.

4. Një organizatë e akredituar vëzhguese mund të dërgojë një vëzhgues në takimet e KQZ-së dhe KKZ-së.

### **Neni 57** **Paanshmëria dhe Neutraliteti**

1. Vëzhguesit zgjedhorë janë të paanshëm dhe politikisht neutral gjatë vëzhgimit të procesit zgjedhor.
2. Vëzhguesit zgjedhorë në asnjë mënyrë nuk ndërhyjnë në mbajtjen e zgjedhjeve dhe e respektojnë fshehtësinë e votimit.
3. Numri i vëzhguesve nga po e njëjta organizatë që mund të jenë të pranishëm në të njëjtën kohë në vendvotim, në qendër të numërimit, në qendër për informim të votuesve, nuk mund të kalojë mbi dy (2).
4. Gjatë vëzhgimit të procesit zgjedhor, vëzhguesit e akredituar i tregojnë simbolet e akreditimit në mënyrë të dukshme dhe i mbajnë dokumentet e nevojshme sipas Rregullave Zgjedhore që i kërkon KQZ-ja.
5. Përfundimisht nga paragrafi 3 i këtij neni, numri i vëzhguesve nga po e njëjta organizatë vëzhguese që mund të jenë të pranishëm në të njëjtën kohë në vendvotimet që hapen në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës, nuk mund të kalojë mbi 1 (një). Po ashtu, gjatë marrjes së fletvotimeve në Kutinë Postare në Kosovë dhe Jashtë Kosovës njoftohen vëzhguesit për mundësinë e pjesëmarrjes së tyre për vëzhgim gjatë marrjes së dërgesave postare. Gjatë pranimit të dërgesave, nuk mund të marrë pjesë më shumë se një (1) vëzhgues nga e njëjta organizatë vëzhguese e interesuar.

### **Neni 58** **Akreditimi i Organizatave Vëzhguese**

KQZ-ja harton dhe miraton rregulla për organizatat vëzhguese dhe vëzhguesit.

## **KAPITULLI X**

### **KQZ**

#### **Neni 59**

#### **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**

1. KQZ është institucion i pavarur kushtetues dhe shërben në mënyrë të përhershme për përgatitjen, mbikëqyrjen dhe drejtimin e procesit zgjedhor dhe referendumit, siç përcaktohet në nenit 139 të Kushtetutës.
2. KQZ harton buxhetin vjetor në pajtim me Ligjin përkatës për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe vendosë në mënyrë të pavarur për përdorimin e buxhetit, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.
3. KQZ-ja siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve në pajtim me parimet dhe kërkesat e këtij ligji.
4. Gjatë zbatimit të mandatit të vet KQZ-ja, inter alia:
  - 4.1. ndërmerr aktivitete për edukimin e votuesve të përgatitura për ngritjen e vetëdijesimit të votuesit për, dhe pjesëmarrjen në zgjedhje;
  - 4.2. ndërmerr projekte ose kërkime lidhur me sistemin zgjedhor dhe çështjet lidhur me të;
  - 4.3. krijon procedura të përshtatshme dhe ndërmerr aktivitete për të garantuar se të gjithë personat me aftësi të kufizuara mund ta ushtrojnë të drejtën e tyre të votimit dhe të marrin pjesë tërësisht në procesin zgjedhor në Kosovë; dhe
  - 4.4. kryen çdo funksion tjetër ndihmës për mbajtjen e zgjedhjeve në Kosovë që i përcaktohet me Rregulloret relevante dhe instrumentet ndihmëse, përfshirë veprimet e domosdoshme për mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor në rast shfaqjeje të një force madhore.
5. Selia e KQZ-së ndodhet në kryeqytetin e Kosovës, Prishtinë.
6. Komisioni mund të lidhë marrëveshje teknike dhe mirëkuptimi të cilat mund të kërkohen për funksionimin dhe përgjegjësinë e tij.
7. KQZ krijon dhe mban një llogari të ndarë bankare në emër të KQZ-së, që përdorët vetëm për grumbullimin dhe kthimin e depozitave siç kërkohet me ligj.
8. KQZ i konsideron konfidenciale të gjitha të dhënat personale të mbledhura për kandidatët dhe votuesit, përveç asaj që kërkohet me këtë ligj, dhe i ndërmerr të gjitha masat për ruajtjen e këtyre të dhënave, përveç kur kërkohen nergut nga agjencitë e zbatimit të ligjit.

## **Neni 60**

### **Përbërja e Komisionit**

KQZ-ja përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë në pajtim me nenin 139 të Kushtetutës.

## **Neni 61**

### **Mandati dhe Emërimi i Anëtarëve të KQZ-së**

1. Kryesuesi i KQZ-së emërohet në pajtim me nenin 139 paragrafi 3 të Kushtetutës.
2. Mandati i Kryesuesit të KQZ-së është shtatë (7) vjet, duke filluar nga data e caktuar për njoftim të emërimit nga Presidenti i Kosovës.
3. Kryesuesi i KQZ-së nuk shërben më shumë se dy (2) mandate.
4. Anëtarët e KQZ-së nuk mund të shërbejnë më shumë se tri (3) mandate të njëpasnjëshme dhe në pajtim me nenin 139 paragrafi 4 të Kushtetutës dhe emërohen si në vijim:
  - 4.1. gjashtë (6) anëtarë emërohen nga pjesëtarët e gjashtë (6) grupeve më të mëdha parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, të cilët nuk kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e vendeve të rezervuara. Nëse në Kuvend janë të përfaqësuara më pak grupe, grupi a grupet më të mëdha mund të emërojnë anëtarë shtesë;
  - 4.2. një (1) anëtar emërohet nga deputetët e Kuvendit të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetin Serb të Kosovës;
  - 4.3. tre (3) anëtarë emërohen nga deputetët e Kuvendit, të cilët mbajnë vende të rezervuara a të garantuara për komunitetet e tjera që nuk janë shumicë në Kosovë.
5. Mandati i anëtarëve të KQZ-së është i lidhur me mandatin e ciklit zgjedhor dhe në parim fillon jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve për Kuvend. Fillimi i mandatit sipas këtij paragrafi, nënkupton përfundimin e mandatit paraprak.
6. Presidenti i Republikës së Kosovës, bazuar në rezultatet që kanë dalur nga zgjedhjet e përgjithshme, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas certifikimit të zgjedhjeve për Kuvend, u kërkon grupeve parlamentare/subjekteve politike që të propozojnë me shkrim kandidatët për anëtar të KQZ. Grupet parlamentare/subjektet politike brenda afatit prej shtatë (7) ditësh i dërgojnë propozimet e tyre dhe emërimi nga Presidenti bëhet brenda pesë (5) ditësh nga dërgimi i propozimeve.
7. Mandati i kryesuesit të KQZ-së apo cilitdo anëtar të KQZ-së mund të ndërpritet përmes dorëheqjes ose nga Presidenti i Kosovës, me efekt të menjëhershëm, në rrethanat e mëposhtme:
  - 7.1. kryesuesi apo anëtari dështon në plotësimin e kushteve dhe kritereve që dalin nga ky ligj;

7.2. kryesuesi apo anëtari nuk merr pjesë, pa ndonjë arsytim, në tri (3) mbledhje të njëpasnjëshme të KQZ-së dhe ndërprerja e mandatit propozohet nga dy të tretat (2/3) e votave të shumicës së KQZ-së;

7.3. kryesuesi apo anëtari është i dënuar për veprë penale;

7.4. kryesuesi apo anëtari sillet ose vepron në atë mënyrë që e dëmton seriozisht statusin dhe integritetin e KQZ-së, si në rrethanat e mëposhtme;

7.4.1. emërohet ose zgjedhet në pozitë tjetër të funksionarit publik në Kosovë apo në shtete tjera;

7.4.2. emërohet në pozitë vendimmarrëse në organet e larta të partisë politike;

7.4.3. pengon punën dhe funksionet ligjore të KQZ-së;

7.4.4. zbulon informacionet konfidenciale;

7.4.5. shfrytëzon pozitën për përfitime personale ose për persona tjerë;

7.4.6. nuk ka të drejtë vote në Kosovë;

7.4.7. i merret zotësia e veprimit me vendim gjyqësor të formës së prerë.

7.5. kryesuesi apo anëtari nuk është në gjendje t'i kryejë detyrat e veta për më shumë se gjashtë (6) muaj me radhë.

8. Mandati i Kryesuesit apo cilitdo anëtar të KQZ-së, për rrethanat e përcaktuara në nënparagrafin 7.4. të këtij neni, mund të ndërpritet pas propozimit me shkrim, të miratuar nga shumica prej dy të tretave (2/3) të anëtarëve të KQZ-së.

9. Nëse mandati ndërpritet nga Presidenti i Kosovës, emërimi i ri bëhet brenda tridhjetë (30) ditësh, në pajtim me këtë nen. Emërimi i ri për zëvendësim bëhet në pajtim me procedurat e këtij neni dhe anëtari i ri shërben vetëm për kohëzgjatjen e mandatit të mbetur të anëtarit të zëvendësuar, por mund të jetë subjekt i riemërimit në pajtim me këtë nen.

10. Anëtari i KQZ-së duhet të ketë arsimim universitar dhe jo më pak se pesë (5) vite përvojë pune;

11. Personi nuk ka të drejtë të jetë anëtar i KQZ-së, nëse është:

11.1. deputet i Kuvendit të Kosovës apo në ndonjë shtet tjetër;

11.2. këshilltar i ndonjë kuvendi komunal në Kosovë;

11.3. kandidat për ndonjë post të zgjedhur publik në Kosovë;

- 11.4. zyrtar i lartë publik në parti politike, sipas regjistrimit të KQZ-së;
- 11.5. person pa të drejtë vote në Kosovë;
- 11.6. anëtar i komisionit publik zgjedhor, brenda ose jashtë Kosovës;
- 11.7. anëtar i organizatës jo-qeveritare, që i monitoron zgjedhjet;
- 11.8. i larguar nga puna nga administrata publike, për shkelje të ligjit;
- 11.9. i dënuar në tri (3) vitet e fundit me vendim gjyqësor të formës së prerë për veprë penale, me një ose më shumë vjet burgim efektiv;
- 11.10. Funksonar publik me status të veçantë, në bazë të ligjit në fuqi për zyrtarët publikë, brenda ose jashtë Kosovës në pesë (5) vitet e fundit.

## **Neni 62** **Betimi dhe Emërimi**

1. Presidenti i lëshon një shkresë emërimi secilit anëtar të KQZ-së, të cilët paraqiten personalisht para Presidentit ose përfaqësuesit të tij të caktuar në datën e shpallur nga Presidenti për ta dhënë deklaratën vijuese në gjuhën të cilën ai ose ajo e zgjedh vetë: *“Deklaroj solemnisht se do t’i kryejë detyrat e mia si anëtar i KQZ-së në mënyrë të ndershme, besnike, të paanshme, profesionale dhe të ndërgjegjshme.”*
2. Nëse personi i emëruar si anëtar i KQZ-së pa arsye nuk e jep betimin në pajtim me këtë nen, Presidenti kërkon nga grupi parlamentar/subjekti politik që e ka propozuar atë person që ta propozoj një person tjetër. Nëse grupi parlamentar/subjekti politik nuk e cakton një person të pranueshëm për të qenë anëtar i KQZ-së brenda katërmëdhjetë (14) ditëve prej kohës kur bëhet një kërkesë e tillë, Presidenti ka liri veprimi ta zgjedhë dhe emërojë një person të pranueshëm për ta plotësuar postin e lirë.

## **Neni 63** **Marrja e Vendimeve**

1. Takimet e KQZ-së i thërret Kryesuesi ose së paku katër (4) anëtarë. Njoftimi për takim përfshinë edhe agjendën e takimit.
2. Përgjatë periudhës së fushatës dhe deri pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, KQZ-ja mban takime sipas orarit të paracaktuar dhe publikuar.
3. Takimet e KQZ-së vlejné vetëm nëse në to marrin pjesë jo më pak se shtatë (7) anëtarë të KQZ-së
4. Për Rregullat Zgjedhore, regjistrimin e partive politike dhe certifikimin e partive politike, shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve, si dhe për vendimet lidhur me ankesat që kanë të bëjnë me shpalljen e

rezultateve, KQZ-ja vendos me konsensus, përveç kur kjo është e pamundur, atëherë vendoset me dy të tretat (2/3) e votave. Çdo vendim tjetër merret me shumicën e thjeshtë të votave.

5. Takimet i kryeson Kryesuesi i KQZ-së.

6. Vendimi i Komisionit nuk i nënshtrohet ankesës, përveç nëse nuk parashihet ndryshe me këtë ligj.

7. KQZ-ja i krijon rregullat e punës në pajtim me këtë ligj.

8. Anëtari nuk merr pjesë në marrjen e vendimit nga KQZ-ja lidhur me çështjen në të cilën ai ose ajo ose anëtari i tij ose i saj i familjes ka interes të natyrës personale ose financiare, e që mund ta vë në dyshim aftësinë e anëtarit për të vepruar në mënyrë të paanshme.

9. Takimet e KQZ-së janë të hapura për publikun, përveç kur diskutohet për çështje lidhur me personelin e KQZ-së dhe SKQZ-së.

10. KQZ-ja i përgatit Kuvendit të Kosovës një raport vjetor dhe atë në muajin prill. Raporti përmban informata lidhur me aktivitetet e KQZ-së dhe rekomandimet që KQZ-ja i sheh si të përshtatshme që të trajtohen në Kuvend.

11. Të gjitha vendimet e KQZ-së janë dokumente publike dhe sigurojnë përmbushjen e elementeve të aktit administrativ, siç përcaktohet në ligjin në fuqi për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

#### **Neni 64** **Përgjegjësitë dhe Funkcionet e KQZ-së**

1. KQZ-ja është përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji.

2. KQZ-ja i:

2.1. përgatitë dhe shpallë rregullat, format dhe procedurat zgjedhore që kanë të bëjnë me zbatimin e këtij ligji dhe me çdo çështje tjetër që ka të bëjë me drejtimin e zgjedhjeve në kuadër të kompetencës së saj;

2.2. publikon të gjitha rregullat e miratuara, rregullat, udhëzimet dhe procedurat zgjedhore dhe i bën ato të arritshme për opinionin;

2.3. krijon dhe mban listën e personave që kanë të dejtë të votojnë në zgjedhje të veçanta;

2.4. siguron që Zyra për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike të ketë burime për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në këtë ligj;

2.5. përpilon dhe miraton fletëvotimet dhe materialet tjera zgjedhore;

2.6. akrediton vëzhguesit zyrtarë të zgjedhjeve;

- 2.7. certifikon listën votuese lidhur me zgjedhjet;
- 2.8. certifikon rezultatet e zgjedhjeve;
- 2.9. publikon rezultatet e zgjedhjeve;
- 2.10. themelon komisionet komunale të zgjedhjeve dhe këshillat e vendvotimeve;
- 2.11. rritë pjesëmarrjen e grave në të gjitha nivelet e administrimit të zgjedhjeve, për aq sa është e mundur dhe e zbatueshme.

3. KQZ miraton akte të veçanta për procedurën, kushtet dhe çështjet për të cilat mund të parashtrahet ankesë ndaj vendimeve apo kundërshtim administrativ ndaj akteve reale të saj.

4. Të gjitha rregullat e referuara në këtë ligj miratohen nga KQZ me shumicën e dy të tretave (2/3) të votave. Të gjitha këto rregulla publikohen me kohë, në faqen e internetit të KQZ-së.

## **Neni 65**

### **Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

1. Në kryerjen e përgjegjësive dhe funksioneve të tij, Komisionit i ndihmon Sekretariati (këtu e tutje: “Sekretariati i KQZ-së”) i cili vepron në pajtim me këtë ligj.

2. Sekretariati KQZ-së i zbaton vendimet e KQZ-së, përgatitë raporte, rekomandime për vendime të KQZ-së dhe siguron ndihmë tjetër të nevojshme administrative për KQZ-në. Sekretariati, gjithashtu, e asiston KQZ-në në zbatimin e funksioneve dhe përgjegjësive të cilat i janë caktuar në pajtueshmëri me këtë ligj, dhe me instrumentet ndihmëse të përmendura më poshtë.

3. Pas miratimit nga KQZ-ja, Sekretariati lidhë marrëveshje me palën e tretë, në emër të KQZ-së duke u mbështetur në procedurat e themeluara nga KQZ-ja.

## **Neni 66**

### **Menaxhimi i Sekretariatit të KQZ-së**

1. Sekretariati udhëheqet nga drejtori i tij, i cili emërohet dhe i përgjigjet KQZ-së dhe ka mandat të zytarit të nivelit të lartë drejtues dhe emërohet në bazë të procedurave të përcaktuara në ligjin në fuqi për Zyrarët Publik dhe është përgjegjës për:

1.1. organizimin e agjendës së takimeve të KQZ-së nën udhëheqjen e Kryesuesit dhe sigurimin e tërë materialit të nevojshëm para çdo takimi dhe merr pjesë në takimet e KQZ-së;

1.2. raportim në KQZ për të gjitha detyrat e SKQZ-së, me përjashtim të drejtorit ekzekutiv të Zyrës;



1.3. administrimin dhe udhëheqjen e gjithëmbarshme të Sekretariatit dhe sigurimin për zbatimin e të gjitha funksioneve të besuara;

1.4. sigurimin e udhëzimeve të duhura për KQZ-në, dhe këshillave të paanshme e të kualifikuara nga Sekretariati;

1.5. organizimin e Sekretariatit dhe nxjerrjen e procedurave administrative lidhur me çështjet të cilat i përkasin;

1.6. menaxhimin efektiv dhe efikas të burimeve njerëzore dhe financiare të Sekretariatit;

1.7. zbatimin e politikave jo-diskriminuese ndaj personelit të Sekretariatit, përfshirë përfaqësimin e drejtë gjinor në të gjitha fushat dhe nivelet dhe garantimin që përbërja e stafit të Sekretariatit e reflekton karakterin shumetnik të Kosovës;

1.8. kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të tjera të përcaktuara nga KQZ.

2. Zyrtarët e Sekretariatit e kanë statusin e zyrtarit publik. KQZ, në pajtim me Ligjin në fuqi për Zyrtarët Publik, miraton aktet nënligjore lidhur me marrëdhënien e punës së tyre, duke përfshirë sistematizimin dhe klasifikimin e pozitave në kuadër të KQZ dhe organeve të saj.

## **KAPITULLI XI KOMISIONET KOMUNALE TË ZGJEDHJEVE**

### **Neni 67 Përbërja e KKZ-ve dhe Kualifikimi i Anëtarëve**

1. Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) ka shtatë (7) anëtarë dhe ky numër mund të rritet nëse numri i subjekteve politike që kualifikohen për të qenë pjesë e komisionit është më i madh. Secili Komision Komunal i Zgjedhjeve është i përbërë nga:

1.1. Zyrtari Ekzekutiv i KKZ-së i punësuar nga KQZ-ja, i cili njëkohësisht është kryesues i KKZ-së; dhe

1.2. nga një (1) anëtar i nominuar nga subjektet politike që kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet nacionale, nëse i nënshtrohen pragut zgjedhor.

2. Anëtarët e KKZ-së janë persona me të drejtë vote në komunë dhe me qëndrime të larta profesionale e morale, me përvojë administrative ose zgjedhore dhe njohuri të mjaftueshme që i mundëson KKZ-së të kryejë me efektivitet detyrën e vet.

3. KQZ-ja duhet të përpiqet ta garantojë përfaqësimin e drejtë në KKZ për të gjitha komunitetet, me numër të dallueshëm të popullatës brenda një komune, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen gjinore.

4. KQZ-ja emëron KKZ-të brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas shpalljes së zgjedhjeve. Emërimet përfundojnë pesëmbëdhjetë (15) ditë pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, përveç nëse mandati i KKZ-së ndërpritet para përfundimit të afatit ose zgjatet.

5. Asnjë person nuk mund të caktohet të shërbejë si anëtar i KKZ-së, ose të vazhdojë të shërbejë pasi që është caktuar, po që se ai/ajo është:

5.1. deputet i Kuvendit të Kosovës apo në ndonjë shtet tjetër;

5.2. këshilltar i ndonjë kuvendi komunal në Kosovë;

5.3. kandidat për ndonjë post të zgjedhur publik në Kosovë;

5.4. zyrtar i lartë publik në parti politike, sipas regjistrimit të KQZ-së;

5.5. person pa të drejtë vote në Kosovë;

5.6. person të cilit me vendim gjyqësor i është hequr zotësia e veprimit;

5.7. anëtar i komisionit publik zgjedhor jashtë Kosovës;

5.8. person të cilit i është ndaluar shërbimi në cilësinë e anëtarit të KKZ-së nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës;

5.9. anëtar i organizatës jo-qeveritare, që i monitoron zgjedhjet;

5.10. i larguar nga puna nga administrata publike, për shkelje të ligjit;

5.11. i dënuar në tri (3) vitet e fundit me vendim gjyqësor të formës së prerë për veprë penale, me një ose më shumë vjet burgim efektiv;

5.12. funksionar publik me status të veçantë, në bazë të ligjit në fuqi për zyrtarët publikë, brenda ose jashtë Kosovës në pesë (5) vitet e fundit.

6. Asnjë person nuk mund të shërbejë, në të njëjtën kohë, në më shumë se në një KKZ.

7. Anëtar i Administratës Komunale i caktuar të shërbejë si anëtar i Komisionit Komunal Zgjedhor shërben me respekt ndaj detyrave të tij/saj si anëtar i Komisionit Komunal Zgjedhor, nën autoritetin e KQZ-së dhe Zyrtarit Ekzekutiv të KKZ-së gjatë periudhës derisa është i emëruar.

8. Emërimi i një anëtarit të KKZ-së i nënshtrohet betimit dhe nënshkrimit të Kodit të Sjelljes së KQZ-së të miratuar nga KQZ-ja, para fillimit të punës.

9. Pavarësisht paragrafit paraprak të këtij neni, në rast se kërkohet, KQZ-ja ka kompetenca për të emëruar sipas zgjedhjes së saj anëtarët e KKZ-së të cilët nuk i përmbushin kushtet sipas këtij neni.

## **Neni 68** **Përgjegjësitë e Komisionit Komunal Zgjedhor**

1. KKZ administron zgjedhjet brenda komunës përkatëse, nën mbikëqyrjen ekskluzive dhe udhëzimet e KQZ-së, duke garantuar ligjshmëri, legjitimitet dhe efikasitet të procesit zgjedhor. Pa e kufizuar parimin e përgjithshëm të përgjegjësisë të tyre, KKZ duhet të:

- 1.1. themelojë një zyrë brenda objektit të administratës komunale për kryerjen e detyrave të veta;
- 1.2. sigurojë informata të gjithë votuesve, për të gjitha komunitetet dhe të përhapë informata të nevojshme për administrimin e zgjedhjeve;
- 1.3. sigurojë informata të paanshme për partitë politike, nismat qytetare, koalicionet dhe kandidatët e pavarur lidhur me të drejtat dhe obligimet e tyre ndaj zgjedhjeve;
- 1.4. merr pjesë në çfarëdo seancë trajnimi të kërkuar nga KQZ-ja;
- 1.5. ndihmojë në caktimin dhe trajnimin e cilitdo person i cili ndihmon në administrimin e zgjedhjeve përfshirë edhe këshillave të vendotimeve;
- 1.6. ndihmojë marrëveshjet teknike në Vendvotime dhe çdo përgatitje tjetër teknike për zgjedhje përfshirë pranimin e të gjithë materialit jo të ndjeshëm;
- 1.7. sigurojë mbajtjen e përshtatshme të votimit dhe të numërimit dhe përmbledhjen e rezultateve të zgjedhjeve brenda juridiksionit të tyre;
- 1.8. grumbullojë dhe ruajë materiale zgjedhore pas zgjedhjeve; dhe
- 1.9. kryejë detyra tjera të cilat kërkohen nga legjislacioni në fuqi ose Rregullat e KQZ-së.

2. Secili ZKZ i dërgon raporte Sekretariatit të KQZ-së, çdo javë, lidhur me punën e KKZ-ve siç është e caktuar nga SKQZ-ja. Nëse Sekretariati i KQZ-së kërkon nga një ZKZ të shkruajë raport të menjëhershëm, ai duhet ta bëjë atë. ZKZ kryen detyra tjera të caktuara nga KQZ-ja.

3. Komisioni Komunal Zgjedhor mban shënime të rregullta për punën, përfshirë procesverbalet e mbledhjeve, vendimet e bëra, dhe raportet javore të KQZ-së dhe informatat tjera relevante.

4. Komisioni Komunal Zgjedhor organizon fushatë informuese në komunat përkatëse e cila veçanërisht ju adresohet grupeve shoqërore si: gratë, komunitetet joshumicë, votuesit në zonat rurale, votuesit për herë të parë dhe personat me aftësi të kufizuara.

5. Në përmbushjen e këtyre përgjegjësiave ligjore, KKZ bashkëpunon me institucione publike. Komunitat janë të obliguara që t'i ofrojnë mbështetjen e nevojshme KKZ-ve në kuptimin e sigurimit të hapësirave për punë, depo për materiale, transport, objektet publike për nevoja të votimit apo ambiente tjera për organizimin e trajnimeve të komisionerëve dhe numëruesve, si dhe hapësira për adaptimin e qendrave komunale të numërimit.

### **Neni 69** **Procesi i Emërimit**

1. Sekretariati i KQZ-së ia siguron KQZ-së listën e kandidatëve për secilin KKZ. Secila nga listat mund të përfshijë emrat e disave, të gjithëve ose të asnjërit nga të punësuarit në Administratën komunale të propozuar nga Zyrtari Ekzekutiv i Administratës Komunale, me liri veprimi të Sekretariatit të KQZ-së.
2. SKQZ-ja mund t'i konsultojë organizatat joqeveritare, institucionet akademike dhe organizmat tjerë të ngjashëm me qëllim të identifikimit të kandidatëve të kualifikuar dhe të përshtatshëm.
3. Kur KQZ-ja refuzon një person të nominuar, ajo duhet të njoftojë ZKZ-në përkatëse lidhur me refuzimin dhe të kërkojë nga ai/ajo të paraqesë një kandidat tjetër. ZKZ-ja ka në dispozicion dhjetë (10) ditë për të propozuar kandidatin tjetër dhe KQZ-ja vendos për kandidatin tjetër pa u vonuar.
4. Çdo person ose persona tjerë të cilët Sekretariati i KQZ-së i konsideron të përshtatshëm për anëtarësim në KKZ, duke i kushtuar kujdes të veçantë kërkesës për përfaqësim të drejtë gjinor dhe etnik.
5. Sekretariati i KQZ-së i lëshon Certifikatë të Emërimit secilit anëtarë të KKZ-së.
6. Anëtarët e emëruar në Komisione Komunale Zgjedhore e fillojnë punën e tyre menjëherë pas emërimit nga KQZ-ja.
7. Kundër vendimit të KQZ-së për mosemërimin e anëtarit të KKZ-së, subjektet politike dhe palët tjera me interes juridik mund të parashtrajnë ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga shpallja e vendimit nga KQZ. Ankesa shqyrtohet dhe vendoset nga PZAP brenda shtatëdhjet e dy (72) orëve nga parashtrimi i saj.

### **Neni 70** **Përfundimi i Anëtarësisë në KKZ**

1. KQZ-ja mund ta revokojë në çdo kohë emërimin e secilit anëtar të KKZ-së nëse anëtar:
  - 1.1. nuk i kryen detyrat e tij/saj sipas rregullave të KQZ-së;
  - 1.2. vepron në mënyrë të anshme dhe joprofesionale;
  - 1.3. nuk merr pjesë në dy (2) takime të njëpasnjëshme të KKZ-së pa ndonjë arsye të bazuar;

1.4. merr pjesë në një fushatë zgjedhore në emër të një subjekti politik ose ndërhyr në procesin zgjedhor;

1.5. nuk lajmërohet në punë dy (2) ditë me radhë gjatë fushatës zgjedhore pa ndonjë arsye të bazuar.

2. Anëtari i KKZ-së, të cilit iu ka revokuar emërimi, menjëherë e ndërprente përfshirjen në punët e KKZ-së dhe ia kthen Shefit Ekzekutiv të KKZ-së pajisjet e KKZ-së.

### **Neni 71**

#### **Kompensimi i Anëtarëve të KKZ-së**

1. Anëtarët e KKZ-ve dhe Kryesuesi paguhen për kryerjen e detyrave të tyre nga burimet e KQZ-së në pajtim me rregullat e miratuara për këtë qëllim.

2. Anëtarët e KKZ-së të punësuar në administratë, marrin pagesë që është e barabartë me gjysmën e pagës së anëtarit të KKZ-së, si shtesë e pagës së tyre të zakonshme.

### **Neni 72**

#### **Procesi i Vendimmarrjes**

1. Komisioni Komunal i Zgjedhjeve i merr vendimet me shumicën e të gjithë anëtarëve të pranishëm.

2. Asnjë nga anëtarët e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve nuk merr pjesë në vendimin lidhur me çështjet për të cilat një anëtar i familjes së tij/saj mund të ketë interes personal, financiar ose të natyrës tjetër, ose që mund të sjellë dyshime rreth aftësisë së tij për veprim të paanshëm.

3. Komisioni Komunal i Zgjedhjeve mban procesverbale për secilën mbledhje dhe konstaton vendimmarrjen.

4. Ndaj vendimeve të Komisionit Komunal Zgjedhor mund të parashtrohet ankesë në KQZ.

### **Neni 73**

#### **Qasja në Takimet dhe Dokumentacionin e Komisionit Komunal Zgjedhor**

Një vëzhgues i akredituar ka qasje në të gjitha takimet dhe në dokumentacionin e KKZ-së. Nëse Komisioni Komunal i Zgjedhjeve nuk e lejon pjesëmarrjen në takim ose qasjen në një dokument, mund të parashtrohet ankesë në KQZ. KQZ-ja merr një vendim lidhur me ankesën brenda dyzet e tetë (48) orëve dhe ndërmerr veprime të duhura, të cilat ajo i konsideron të përshtatshme.

## **KAPITULLI XII KËSHILLAT E VENDVOTIMEVE**

### **Neni 74 Dispozitat e Përgjithshme**

1. Përbërja e Këshillit të Vendvotimit reflekton strukturën e anëtarëve të KKZ-së. Komisioni Komunal i Zgjedhjeve mundet, në raste të veçanta, ta shtojë numrin e anëtarëve në Këshillin e Vendvotimit dhe për këtë menjëherë ta njoftojë KQZ-në.
2. Duke u mbështetur në vendimin e KQZ-së, mund të formohet një KVV i dytë përgjegjës për numërimin e rezultateve.
3. Të gjithë personat e emëruar si anëtarë të Këshillave të Vendvotimit (KVV) duhet t'i plotësojnë kriteret për emërim të saktësuar në këtë ligj.
4. Secili Komision Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) i paraqet SKQZ-së propozimet e atyre personave të cilët i plotësojnë kriteret relevante të emërimit. SKQZ-ja ia paraqet listën e siguruar nga KKZ-ja, KQZ-së për miratim, së bashku me rekomandimet ose vërejtjet.
5. KQZ-ja e shqyrton listën e paraqitur me persona nga Sekretariati i KQZ-së dhe vendosë me shumicën e thjeshtë që t'i emërojë ose jo personat e paraqitur, varësisht prej rastit.
6. Çdo anëtar i KVV-ve i cili nuk merr pjesë në trajnime të organizuara nga KKZ-ja pa ndonjë arsye të bazuar parandalohet të punoj ditën e zgjedhjeve dhe e humb të drejtën mbi një pjesë ose tërë pagesën, siç vendoset nga KQZ-ja.
7. Çdo anëtar i KVV-së i cili nuk është i pranishëm në vendvotim ku është caktuar të ndodhet në Ditën e Zgjedhjeve e humbë të drejtën për pagesë dhe zëvendësohet menjëherë nga KKZ-ja me një anëtar rezervë të trajnuar dhe të emëruar.
8. Në kohën e emërimit, çdo anëtar i KVV-së e nënshkruan Kodin e Sjelljes, siç parashihet nga KQZ-ja.
9. Çdo anëtar i KVV-së, pavarësisht nga përkatësia e partisë politike ose pikëpamja politike, vepron në mënyrë të paanshme në shërbim të gjithë votuesve.
10. KVV-ja është përgjegjëse për sigurimin e integritetit, sigurisë dhe të qetësisë në procesin e votimit dhe numërimit në Vendvotim nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë nga KKZ-ja.
11. Këshillat e Vendvotimeve në një qendër votimi në përfaqësi diplomatike përbëhen nga tre (3) deri në pesë (5) anëtarë. Kudo që është e mundur, përbërja duhet të reflektojë subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend, që ju kanë nënshtruar pragut dhe që janë certifikuar e garojnë në zgjedhje. KQZ-ja përzgjedh një sekretar nga radhët e administratës. Njëri nga anëtarët e shërbimit të jashtëm (stafi administrativ i përfaqësisë diplomatike) apo staf tjetër nga administrata, kryen detyra të njëjta me menaxherin e qendrës së votimit në Kosovë. Në rastet kur subjektet politike nuk nominojnë anëtarë, apo për çfarëdo arsye

anëtarët e emëruar nuk paraqiten në vendvotime, atëherë KQZ-ja mund të caktojë anëtarë nga stafi i KQZ-së apo nga stafi i përfaqësisë diplomatike.

### **Neni 75**

#### **Kualifikimi dhe Kriteret e Emërimit të Anëtarëve të KVV-ve dhe Kryesuesit**

1. Për t'u emëruar anëtar në KVV, një person duhet:
  - 1.1. të jetë votues i regjistruar në të njëjtën komunë ku ndodhet Vendvotimi/Qendra e Votimit;
  - 1.2. të ketë aftësi të lexojë dhe shkruajë në gjuhën e cila zyrtarisht përdoret në atë komunë.
2. Për t'u emëruar Kryesues i KVV-së, personi duhet të caktohet anëtar i KVV-së në pajtim me dispozitat e këtij neni dhe si shtesë duhet të ketë të përfunduar së paku shkollimin e mesëm;
3. Asnjë person nuk mund të shërbejë si anëtar i KVV-së nëse ai/ajo është:
  - 3.1. kandidat për ndonjë post të zgjedhur publik në Kosovë;
  - 3.2. person pa të drejtë vote në Kosovë;
  - 3.3. person të cilit me vendim gjyqësor i është hequr zotësia e veprimit;
  - 3.4. anëtar i komisionit publik zgjedhor jashtë Kosovës;
  - 3.5. person të cilit i është ndaluar shërbimi në cilësinë e anëtarit të KVV-së nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa;
  - 3.6. anëtar i ndonjë institucioni ose organi zgjedhor;
  - 3.7. anëtar i organizatës jo-qeveritare, që i monitoron zgjedhjet;
  - 3.8. i larguar nga puna nga administrata publike, për shkelje të ligjit;
  - 3.9. i dënuar në tri (3) vitet e fundit me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale, me një ose më shumë vjet burgim efektiv.
  - 3.10. funksionar publik me status të veçantë, në bazë të ligjit në fuqi për zyrtarët publikë, brenda osë jashtë Kosovës në pesë (5) vitet e fundit.

### **Neni 76**

#### **Metoda e Përzgjedhjes së Këshillave të Vendvotimeve**

1. Çdo KVV miratohet nga KQZ-ja dhe udhëhiqet nga Kryesuesi.

2. Në kohën e përcaktuar nga KQZ-ja, SKQZ-ja i fton të gjitha subjektet politike të certifikuara, të përfaqësuara në kuvendin komunal, të cilat garojnë në zgjedhjet shtetërore, t'i dorëzojnë në KKZ propozimet për personat që ata dëshirojnë t'i emërojnë anëtarë të KVV-ve të formuara në kuadër të komunës së tyre.

3. SKQZ-ja kërkon nga subjektet politike të reja, OJQ-të dhe organizatat tjera qytetare t'i dorëzojnë nominimet plotësuese për KVV.

4. Të gjitha nominimet në kuadër të nenit 74 paragrafëve 2 dhe 3 të këtij ligji i dorëzohen KKZ-së përkatëse jo më vonë se pesë (5) ditë pasi që kërkesa për nominim i është bërë nga Sekretariati i KQZ-së.

5. Lista e nominimeve të KVV-e duhet të përfshijë:

5.1. emrin e subjektit politik ose të OJQ-së të cilët e bëjnë kërkesën, emrin e personit kontaktues dhe detajet kontaktuese të tij/saj;

5.2. emrin, mbiemrin, numrin personal, datën e lindjes të çdo të emëruari;

5.3. përshkrimin e hollësishëm për çdo të emëruar nëse ai/ajo ka përvojë paraprake në zgjedhje dhe diplomë të shkollës së mesme; dhe

5.4. datën dhe vendin e dorëzimit të listës së nominimeve, nënshkrimin e përfaqësuesit të subjektit politik ose OJQ-së, sikurse edhe nënshkrimin e pranimit të listës nga përfaqësuesi i KKZ-së.

## **Neni 77**

### **Emërimi i Anëtarëve dhe Kryesuesve të KVV-ve**

1. Menjëherë pas pranimit të të gjitha nominimeve, KKZ-të i caktojnë të emëruarit në VV-të e propozuara për ta duke e zbatuar grupin e rregullave në vijim:

1.1. jo më shumë se një person prej një listë të nominimeve në KVV, të dorëzuar sipas nenit 76 paragrafi 2 të këtij ligji, të emërohet anëtar i KVV-së në të njëjtin VV;

1.2. gjatë përzgjedhjes së kandidatëve nga lista e nominimeve të KVV-së të dorëzuar sipas nenit 76 paragrafi 3 të këtij ligji, përparësi u jepet kandidatëve me cilësi më të mira dhe veçanërisht atyre me përvojë paraprake në zgjedhje;

1.3. jo më shumë se një person nga familja e ngushtë mund të emërohet në të njëjtin KVV. Për qëllime të këtij neni, familja e ngushtë përfshinë bashkëshortin/ën, fëmijët, prindërit dhe vëllezërit e motrat;

1.4. në komunat e reja ose aty ku nuk janë certifikuar rezultatet nga zgjedhjet e kaluara, anëtarësia e KVV-ve përzgjidhet me short ndërmjet atyre subjekteve politike të certifikuara për pjesëmarrje në zgjedhjet e ardhshme në atë komunë.



2. KKZ-ja ia dorëzon këto nominime Sekretariatit të KQZ-së për rekomandim të KQZ-së jo më vonë se pesë (5) ditë pune pas pranimit të nominimeve. KQZ-ja i emëron të gjithë anëtarët e KVV-ve, përfshirë anëtarët rezervë të KVV-ve, jo më vonë se katër (4) ditë pas pranimit të nominimeve.

3. Kryesuesit e këshillave të vendotimeve zgjidhen në mënyrë të barabartë në mesin e katër (4) subjekteve politike të certifikuara që kanë fituar numrin më të madh të votave për Kuvendin e Kosovës gjatë zgjedhjeve të fundit në atë komunë.

4. Pavarësisht paragrafit paraprak të këtij neni, në rast se kërkohet, KQZ-ja ka kompetenca për të emëruar sipas zgjedhjes së saj anëtarët e KKV-ve të cilët nuk përmbushin kushtet sipas këtij neni.

5. Kundër vendimit të KQZ-së për mosemërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të këshillave të vendotimit, subjektet politike dhe palët tjera me interes juridik mund të parashtrijnë ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga shpallja e vendimit nga KQZ. Ankesa shqyrtohet dhe vendoset nga PZAP brenda shtatëdhjet e dy (72) orëve nga parashtrimi i saj.

## **Neni 78**

### **Pagesat e Anëtarëve dhe Kryesuesve të KVV-ve**

Anëtarët e KVV-ve dhe Kryesuesit e tyre paguhen për kryerjen e detyrave të tyre me mjetet e ndara nga Buxheti i Republikës i Kosovës. KQZ-ja do të nxjerrë një vendim të veçantë, me të cilin do të rregullohet kjo çështje.

## **Neni 79**

### **Emërimi i Rezervave të KVV-ve**

1. Procedurat e saktësuara në nenin 77 të këtij ligji zbatohen për emërimin e një numri shtesë prej dhjetë për qind (10 %) nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të KVV-ve si anëtarë rezervë në kuadër të secilës komunë.

2. Një anëtar i emëruar zëvendësohet me një anëtarë rezervë nga KKZ-ja nëse, për çfarëdo arsye, anëtari i emëruar nuk është në dispozicion për të shërbyer para ose në ditën e zgjedhjeve. Nëse nuk ka numër të mjaftueshëm të anëtarëve rezervë në dispozicion, një KKZ mund t'i plotësojë vendet e zbrazëta me persona për të cilët ajo mendon se janë të përshtatshëm dhe i plotësojnë kriteret e vendosura në nenin 75 të këtij ligji. Një KKZ duhet të:

2.1. sigurojë që jo më shumë se një person nga subjekti politik i përcaktuar në nenin 77 paragrafi 2 të këtij ligji të emërohet anëtar i KVV-së në të njëjtin VV;

2.2. sigurojë që zëvendësimi ta nënshkruajë Kodin e Sjelljes; dhe

2.3. organizojë trajnim të duhur për zëvendësimin.

## **Neni 80**

### **Gjobat dhe Masat Tjera**

1. Subjektet politike të certifikuara ose OJQ-të që kanë nominuar persona për të qenë anëtarë të KVV-ve janë përgjegjës për të siguruar që personat e tillë marrin pjesë në të gjitha seancat e trajnimit të organizuara nga KQZ-ja.
2. Subjektet politike të certifikuara ose OJQ-të që kanë nominuar persona për të qenë anëtarë të KVV-ve janë përgjegjës për të siguruar që personat e tillë janë të përpiktë në vijimin dhe kryerjen e detyrave në vendvotimin e tyre në terminet dhe periudhat kohore siç udhëzohen nga KKZ-ja.
3. Kur personi, ose personat, që emërohen nga një subjekt politik i certifikuar ose OJQ dështojnë në përmbushjen e obligimeve pa ndonjë arsye të fortë të saktësuar në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, çështja raportohet nga KKZ-ja në Komisionin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa. Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa mund të shqiptojë gjobë ose sanksionim, nëse gjen se çështja është provuar.
4. Aty ku, sipas mendimit të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve, një anëtar i këshillit të vendvotimit nuk është, për cilëndo arsye, i gatshëm ose është i paafte t'i përmbushë obligimet e veta, KKZ-ja i jep fund emërimit të atij anëtari. Vendi vakant që del si rezultat i një vendimi i tillë duhet, deri sa është e mundur, të plotësohet në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

## **Neni 81**

### **Kodi i Sjelljes për Anëtarët e KVV-ve**

Emërimi i secilit anëtar në KVV është i kushtëzuar me dhënien e betimit dhe nënshkrimin e Kodit të Sjelljes siç parashihet me rregull të KQZ-së.

## **KAPITULLI XIII**

### **QENDRAT E VOTIMIT DHE VOTIMI**

## **Neni 82**

### **Dispozitat e Përgjithshme**

1. LPV-ja e votuesve të caktuar në të njëjtën QV, përgatitet në mënyrën e përshkruar nga KQZ-ja, në mënyrë që asnjë VV brenda QV-së nuk tejkalon shtatëqind e pesëdhjetë (750) votues. Ky kufizim nuk vlen për votimin në përfaqësi diplomatike, në të cilat numri i votuesve caktohet me vendim të KQZ-së. Ndërsa, për vendvotimet brenda vendit, përjashtimet nga kjo rregull mund të autorizohen nga KQZ-ja.
2. Një VV duhet të jetë mjaft i madh për të siguruar mbajtjen e drejtë të votimit duke vendosur të gjitha stacionet e punës siç janë përkufizuar në këtë ligj dhe duke siguruar fshehtësinë e votës, pamjen e lirë dhe kontrollin e kutisë së votimit, dhe qasje të papenguar për vëzhgues.

3. Personat në vijim janë të autorizuar të jenë të pranishëm në vendvotim ose Qendër të Votimit:

- 3.1. personat e pranishëm me qëllim të votimit;
- 3.2. anëtarët e Këshillit të Vendvotimit dhe stafi i Qendrës së Votimit;
- 3.3. anëtarët e KQZ-së dhe personeli i SKQZ-së;
- 3.4. anëtarët e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve;
- 3.5. vëzhguesit e akredituar të procesit zgjedhor;
- 3.6. policia, kur thirren për të vendosur rregull; dhe
- 3.7. përkthyesit për personat e shënuar në nënparagrafët 3.3., 3.5. dhe 3.6. të këtij paragrafi.

4. Përgjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, numri maksimal i votuesve në qendrat e votimit të hapura në përfaqësitë diplomatike, përcaktohet paraprakisht me vendim të veçantë dhe bazohet, përveç tjerash, edhe në vlerësimet e KQZ-së për kushtet e objektit dhe hapësirat përkatëse të tij. Platforma elektronike e regjistrimit pranon për t'u regjistruar vetëm aq votues sa lejojnë kushtet logjistike. Përfaqësia diplomatike kujdeset për të marrë leje, nëse është e nevojshme, pranë autoriteteve kompetente të vendit pranues.

### **Neni 83**

#### **Lokacionet e Vendvotimeve dhe Qendrave të Votimit**

1. Mbështetur në rekomandimet e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), KQZ-ja, përmes Sekretariatit të KQZ-së, jo më vonë se dyzet (40) ditë para zgjedhjeve, i publikon lokacionet e sakta të të gjitha QV-ve.
2. Secilit votues të regjistruar i caktohet Qendra e Votimit që është lokacioni ku emri i tij/saj shfaqet në Listën Përfundimtare të Votuesve të përdorur gjatë mbajtjes së votimit në ditën e zgjedhjeve.
3. Sa më shumë që të jetë e mundur asnjë votues nuk duhet të udhëtojë më tepër se tre (3) km deri në vendin e tij apo saj të votimit.
4. Ndryshimet pasuese të lokacioneve të QV-ve lejohen në rastet e force madhore, ose arsye tjera objektive dhe të paparashikueshme që do të bënin QV-në të papërshtatshme për qëllime të votimit. Sekretariati i KQZ-së e informon menjëherë KQZ-në për këto ndryshime.
5. Nëse lokacioni i QV-së është ndryshuar, KKZ-ja i njofton votuesit për ndryshimin përmes burimeve në dispozicion të mediave lokale. Si shtesë, KKZ-ja vendos lajmërim në lokacionin origjinal të QV-së duke këshilluar votuesit për lokacionin e ri të QV-së.

6. VV-të janë në vend të qasshëm për të mundësuar votuesit të formojnë dhe të qëndrojnë në rresht dhe duhet, kur është e mundshme, të kenë qasje të niveluar që personat me aftësi të kufizuara të kenë hyrje dhe dalje të papenguar. VV-të kanë ndriçim adekuat dhe mbrojtje nga aksidentet elementare.

7. Një QV ose VV nuk duhet të jetë në një vend të kultit, ndërtesë e cila është pronë apo seli e subjektit politik, ose hapësira në të cilat shërbehet apo konsumohet alkooli.

8. Specifikat e vendvotimeve në përfaqësi diplomatike apo hapësira nën administrimin e përfaqësive diplomatike përcaktohen me akt nënligjor nga KQZ-ja.

#### **Neni 84 Siguria e Vendvotimit**

1. Kryesuesi i KVV-së, me ndihmën e të gjithë anëtarëve të KVV, siguron qetësinë dhe sigurinë e procesit të votimit brenda VV-së. Rendi në rresht para VV-së mbahet nga anëtari i KVV-së i caktuar kontrollues i rreshtit.

2. Në rast të çrregullimit serioz brenda ose në afërsi të drejtpërdrejtë të VV-së, Kryesuesi i KVV-së kërkon ndihmë të menjëhershme nga policia. Incidenti shënohet menjëherë në Librin e Votimit.

3. Në rast se çrregullimi kthehet në kërcënim serioz të integritetit të procesit të votimit ose kundër njerëzve brenda VV-së, Kryesuesi i KVV-së mund të vendosë të ndërpresë votimin dhe të mbyllë VV-në deri sa të ri-vendoset rregull. Kryesuesi i KVV-së e informon menjëherë KKZ-në dhe e regjistron ngjarjen në Librin e Votimit, përfshirë periudhën gjatë së cilës votimi është ndërprerë.

4. Asnjë person që mban armë ose emblemë nuk lejohet brenda VV-së, përveç policit të Kosovës në detyrë i cili është në uniformë. Policët e Kosovës në detyrë nuk bën të sillen brenda VV-së pas hedhjes së votës së tyre.

#### **Neni 85 Materiali për Fushatën Zgjedhore dhe Materiali për Informim të Votuesve në VV dhe QV**

1. Të gjitha subjektet politike të cilat nuk kanë larguar materialet e fushatave të tyre zgjedhore të vendosura brenda dhe rreth cilitdo VV ose QV në objektin e shkollës/qendrës dhe oborrit e saj, çfarëdo materiali i tillë i mbetur njëzet e katër (24) orë para fillimit të votimit duhet të largohet nga anëtarët e KVV-ve ose menaxheri i QV-së. Subjektet politike të cilat nuk kanë larguar dhe/ose janë gjetur duke postuar material të fushatës zgjedhore pas afatit kohor të vendosur duhet të raportohen në PZAP për shkelje të këtij ligji.

2. Materiali i shtypur, i prodhuar nga Sekretariati i KQZ-së në emër të KQZ-së, duke shënuar emrat e të gjithë kandidatëve të të gjitha subjekteve të certifikuara politike dhe procedurat e votimit duhet të paraqiten në VV për përfitim nga votuesit. Këto lista duhet, po ashtu, të paraqiten në derën kryesore të hyrjes të secilës QV.

3. Shenjat informuese në ndërtesë duhet të paraqesin në mënyrë të qartë numrin e QV-së. Brenda QV-së, veçanërisht kur ka më tepër se një VV, shenjat për të drejtuar votuesit në VV-në e duhur duhet të paraqiten dukshëm. Secila VV duhet të shënjohej qartë me shenja që tregojnë numrin e VV-së dhe shkronjat nga LPV-ja të atyre votuesve të caktuar në atë VV.

4. Asnjë informatë e fushatës zgjedhore nuk duhet të emetohet në çfarëdo pajisje komunikuese në Qendër të Votimit, dhe as brenda distancës së dëgjimit.

### **Neni 86** **Procedurat para fillimit të votimit**

1. KQZ-ja vendos rregullat e procedurës, shpërndarjet, pranimin, paketimin, transportin dhe sigurinë e materialeve për zgjedhje, të cilat i dërgohen KKZ-së, KVV-së, si dhe ekipeve që dërgohen në përfaqësi diplomatike. KQZ-ja me akt nënligjor përcakton ekipet, procedurat e pranimit, transportimit, paketimit dhe vlefshmërinë e zarfeve, duke përfshirë edhe ekipet që do të shkojnë të marrin dërgesat në kutitë postare jashtë Kosovës. Përbërja e ekipeve do të jetë e ngjashme me Këshillat e Votimit në përfaqësi diplomatike dhe do të drejtohen nga një zyrtar i përzgjedhur nga KQZ. Materialet zgjedhore apo që ndërlidhen me votimin jashtë vendit, kanë statusin e dërgesës diplomatike.

2. Në Ditën e Zgjedhjeve, Kryesuesi i KVV-së dhe/ose Zëvendësi e tij duhet që, në përcjellje të policisë, t'i dërgojnë materialet e shënuara në nenin 103 paragrafi 1 të këtij ligji nga KKZ-ja në QV.

3. Të gjithë anëtarët e KVV-së duhet të jenë të pranishëm në VV së paku një (1) orë para fillimit të votimit.

4. Kryesuesi i KVV-së i kryen të gjitha detyrat e përcaktuara nga rregullat e KQZ-së të nevojshme për të hapur VV-të sikurse është përcaktuar me rregullat e KQZ-së.

5. Nëse VV-ja hapet me vonesë, Kryesuesi i KVV-së e informon menjëherë KKZ-në, e cila e informon Sekretariatit e KQZ-së dhe regjistron kohën e hapjes në Librin e vendvotimit.

### **Neni 87** **Përshkrimi i Fletëvotimit dhe materialit në lidhje me Fletëvotimin**

1. Emri i subjektit politik dhe kandidatëve të tyre paraqiten në fletëvotim siç paraqiten në origjinalin e aplikimit për certifikim, subjekt i modifikimeve nëse ka dhe në fund të miratuara nga KQZ-ja.

2. Votuesi udhëzohet për të shënuar zgjedhjen e tij/saj aq qartë që të mos ketë paqartësi mbi preferencat.

3. Emrat e të gjithë kandidatëve në materialin e shtypur të ekspozuara në vendvotime ose Qendra të Votimeve shfaqen drejtpërdrejt nën emrin e partisë politike, koalicionit ose nismës qytetare që ka dorëzuar listën e kandidatëve.

4. KQZ-ja përcakton numrin e fletëvotimeve të cilat shtypen dhe shpërndahen. Numri i fletëvotimeve nuk tejkalon për më shumë se pesë për qind (5 %) numrin e votuesve në listën e votuesve.

5. Fletëvotimi duhet të përmbajë:

5.1. treguesin e qarkut elektoral;

5.2. organin publik që do të zgjidhet;

5.3. numrin rendor të vendosur para secilit subjekt politik individual zgjedhor;

5.4. emrin dhe akronimin e secilit subjekt politik sipas radhës së përcaktuar me shortin për fletëvotim;

5.5. tiparet e sigurisë, sikurse janë përcaktuar nga KQZ-ja;

5.6. çfarëdo informate tjetër të kërkuar me këtë ligj dhe me rregullat e miratuara në përputhje me të.

6. KQZ-ja më tutje përcakton me anë të rregullores detajet e fletëvotimeve, duke përfshirë:

6.1. përmbajtjen;

6.2. formatin dhe ekspozimin/dukjen;

6.3. mënyrën dhe kontrollin e printimit;

6.4. verifikimin, shpërndarjen dhe trajtimin e fletëve të votimit;

6.5. veçoritë e sigurisë; dhe

6.6. çfarëdo çështje tjetër lidhur me procesin.

7. Fletëvotimet shtypen nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejt të KQZ-së.

8. Fletëvotimet shtypen në të gjitha gjuhët zyrtare në nivel kombëtar dhe në nivel lokal, sipas Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve. Subjekti politik i certifikuar mund të zgjedhë gjuhën dhe shkrimin në të cilën emri i tij/saj është i shkruar në fletëvotim.

## **Neni 88** **Orari i Votimit**

1. Qendrat e votimit hapen në orën 7:00 dhe mbyllen në orën 19:00.

2. Askush nuk mund të votojë pas kohës së mbylljes së qendrave të votimit, përveç votuesve të cilët presin në radhë në VV në kohën e mbylljes.

## **Neni 89**

### **E Drejta e Votës dhe Fshtësia e Votës**

1. Votuesi më të drejtë për të votuar ka të drejtë vote nëse ai/ajo është i regjistruar në Kosovë ose ka aplikuar suksesshëm për votim jashtë Kosovës siç përcaktohet në nenet 6 dhe 7 të këtij ligji.
2. Askush nuk e parandalon ose orvatet të parandalojë një votues me të drejtë për të votuar nga ushtrimi i së drejtës së tij/saj për të votuar.
3. Askush nuk lejohet të votojë në emër të një votuesi tjetër, përveç përmbushjes së rrethanave nga paragrafi 5 i këtij neni.
4. Secili votues e plotëson fletëvotimin e vet në fshtësi mbrapa kabinës së votimit. Vetëm një person lejohet mbrapa kabinës së votimit gjatë një intervali të caktuar kohor përveç nëse votuesi ka kërkuar ndihmë nga personi tjetër, siç përcaktohet në paragrafin 5 të këtij neni.
5. Votuesi i cili është me aftësi të kufizuara në atë mënyrë që nuk është në gjendje të shënojë ose hedh fletëvotimin, mund të ndihmohet nga një person tjetër i zgjedhur nga votuesi, me kusht që personi që ndihmon është votues në qendrën e njëjtë të votimit me votuesin. Personi i tillë e ndihmon vetëm një votues dhe nuk është anëtar i KVV-së ose vëzhgues i akredituar, përjashtimisht për anëtarët e ngushtë të familjes. Për këtë lloj të votimit, KQZ do t'i caktojë kriteret me rregullën zgjedhore.
6. Kryesuesi i Këshillit të vendvotimit obligohet që të shënojë në librin e votimit, rastet e votimit me asistencë, duke përfshirë arsyet konkrete dhe të shënojë të dhënat personale të votuesit dhe të dhënat personale të personit që ka ndihmuar.
7. Personi i miratuar për të ndihmuar votuesin shkruan dhe nënshkruan emrin e tij/saj në Listën e duhur të Votuesve ose Zarfën për Fletëvotim me Kusht, afër emrit ose një hapësire tjetër të ofruar nga votuesi i cili është ndihmuar dhe arsyen e votimit me kusht.
8. Anëtarët e KVV-së nuk mund në asnjë mënyrë të ndikojnë në vendimin e votuesit.
9. Anëtarët e Këshillit të Vendvotimit dhe/ose stafi i Vendvotimit shpjegojnë procedurën e votimit vetëm nëse u kërkohet nga zgjedhësi.
10. Anëtarët e KVV-së kujdesen veçanërisht për të siguruar që zgjedhësi nuk shqetësohet nga askush përderisa shënjon fletën e tij të votimit, dhe se fshtësia e votimit është plotësisht e siguruar.

## **Neni 90**

### **Dokumentet e Pranueshme të Identifikimit**

1. Për qëllim të zgjedhjeve, shtetasi me të drejtë vote brenda vendit dhe në përfaqësi diplomatike, mund të votojë nëse ai ose ajo identifikohet saktësisht në Listën e Votuesve dhe ofron njërin prej dokumenteve të vlefshme të identifikimit, të lëshuara nga Republika e Kosovës, si në vijim:

- 1.1. letërnjoftimin;
- 1.2. pasaportën;
- 1.3. lejen e vozitjes.

### **Neni 91** **Votimi i Rregullt**

1. Procedurat për votim të rregullt vendosen përmes rregullës së KQZ-së.
2. Votimi në zgjedhjet e njëjta më shumë se një herë përbën veprë penale dhe është i dënueshëm në përputhje me Kodin Penal të Kosovës.

### **Neni 92** **Votimi i Anëtarëve të Këshillit të Vendvotimit**

Anëtarët e KVV-ve dhe Kryesuesi votojnë të parët kur hapet vendvotimi.

### **Neni 93** **Mbyllja e Vendvotimit**

1. Çdo person në rresht në orën e mbylljes së VV-së, lejohet të votojë nëse ka të drejtë për të votuar. Kontrolluesi i rreshtit e informon personin e fundit në rresht se ai/ajo është personi i fundit që voton. Çdo person tjetër që i bashkohet rreshtit pas atij personi, nuk lejohet të hyjë në VV, dhe informohet për pamundësinë e tij/saj për të votuar.
2. Pasi të votojë personi i fundit në rresht në kohën e përfundimit të votimit, kryesuesi i KVV-së e mbyll VV-në, e mbyll kutinë e votimit në atë mënyrë që kjo të mund të shikohet nga vëzhguesit e pranishëm, dhe në librin e votimit e shënon kohën e saktë të mbylljes.

### **Neni 94** **Libri i Votimit**

1. Secili VV e ka Librin e Votimit në të cilin shënohen të gjitha ngjarjet domethënëse në lidhje me mbajtjen e votimeve të cilat ndodhin në vendvotim gjatë ditës së zgjedhjeve.
2. Vetëm Kryesuesi i KVV-së, anëtarët e KVV-së, dhe vëzhguesit e akredituar të pranishëm lejohen të bëjnë shënime në Librin e Votimit. Nëse votuesi ka ankesë në lidhje me ndonjë aktivitet brenda VV-së, ai/ajo mund të kërkojë nga Kryesuesi i KVV-së regjistrimin e ankesës së tij/saj në Librin e Votimit dhe/ose të dorëzojë një ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa në përputhje me procedurat e përcaktuara.



## **Neni 95**

### **Votimi me Kusht**

1. Votuesi në Kosovë, emri dhe mbiemri i të cilit nuk gjendet në Listën përfundimtare të votuesve, lejohet të votojë me kusht në QV-në që lëshon fletëvotime me kusht, përveç nëse KQZ, vendosë ndryshe.
2. KQZ-ja në vazhdimësi, bashkë me institucionet tjera, merr hapa për të përmirësuar listën votuese edhe në periudha jozgjedhore.
3. KQZ-ja cakton listën e qendrave të votimit ku lejohet votimi me kusht.
4. KQZ-ja krijon mundësi për ndërrimin e qendrës votuese edhe në periudha jozgjedhore përmes platformës elektronike, ku qytetarët mund të ndërrojnë qendrën e votimit brenda komunës.
5. KQZ-ja vendos anëtarët e këshillave të votimit në listën e votuesve në qendrën ku shërbejnë, nëse nuk janë të njëjtës qendër votimi.
6. KQZ-ja zhvillon fushatë informuese dhe edukuese për votuesit, se si ndryshohet qendra e votimit dhe në cilat qendra lejohet votimi me kusht.
7. KQZ-ja përcakton numrin e qendrave të votimit me kusht. KQZ-ja mund të mos organizojë votimin me kusht nëse vlerëson se kanë pushuar arsyet e organizimit të tij.
8. Votimi me kusht nuk aplikohet për votuesit që votojnë në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Kosovës.
9. KQZ-ja me akt të veçantë rregullon kushtet, procedurat dhe aspektet tjera të votimit me kusht.

## **KAPITULLI XIV**

### **VOTIMI JASHTË KOSOVËS**

## **Neni 96**

### **Dispozitat e Përgjithshme**

1. Shtetasi me të drejtë vote, i cili jeton jashtë Kosovës, mund të votojë për zgjedhje nëse ai ose ajo aplikon dhe regjistrohet suksesshëm për votim jashtë Kosovës.
2. Vota përmes votimit jashtë Kosovës, e dërguar me postë në kutinë postare të KQZ-së në Kosovë, pranohet nga KQZ-ja deri të nesërmen e ditës së zgjedhjeve në orën 16:00, me kusht që të ketë vulën e dërgimit para ditës së zgjedhjeve. Ndërsa, votat e dërguara përmes postës në kutinë postare jashtë Kosovës, të hapur nga përfaqësitë diplomatike, me autorizim të KQZ-së, pranohen nga ekipet që dërgon KQZ-ja, vetëm ato që kanë arritur në kutinë postare, më së voni deri në orën e mbylljes së vendvotimeve në përfaqësinë diplomatike.

3. Votimi jashtë Kosovës organizohet nga KQZ-ja dhe votuesit mund të votojnë duke u përcaktuar individualisht për mënyrën e votimit, në momentin e regjistrimit përmes platformës së KQZ-së:

3.1. fizikisht, në përfaqësi diplomatike të Republikës së Kosovës apo hapësira të tyre, të cilat shndërrohen në qendra të votimit sipas kriterëve të përcaktuara nga KQZ-ja për adaptimin në qendra të votimit. Kjo mënyrë votimi nuk aplikohet në zgjedhje lokale;

3.2. duke dërguar fletëvotimet përmes kutisë postare të KQZ-së, në postën e Kosovës;

3.3. duke dërguar fletëvotimet përmes postës në një nga kutitë postare të hapura nga KQZ-ja përmes dhe me lehtësimin e përfaqësive diplomatike, jashtë Kosovës.

4. Votimi në përfaqësi diplomatike organizohet një ditë para ditës së zgjedhjeve në Kosovë. Votimi fillon në ora 07:00 dhe mbyllet në ora 19:00, sipas orës lokale të vendit përkatës. Fletëvotimet nga votimi në përfaqësi diplomatike dhe pakot me fletëvotime të pranuar nga përfaqësitë diplomatike nuk hapen, nuk numërohen, apo vlerësohen, por vetëm regjistrohen dhe dërgohen bashkë me materialin tjetër zgjedhor në KQZ, si dërgesa diplomatike. Këto materiale grumbullohen me komision, në prani të vëzhguesve të pranishëm të interesuar, mbyllet në kuti të sigurta, blombohen në mënyrën e caktuar nga KQZ-ja dhe dërgohen si postë diplomatike në KQZ në Kosovë. Procedura e njëjtë përdoret edhe për marrjen e dërgesave postare nga kutia postare jashtë Kosovës. KQZ-ja nxjerr procedura të veçanta për mënyrën e numërimit të zarfeve, paketimit dhe dërgimit.

5. Votuesit që zgjedhin të votojnë përmes postës, pakot e tyre me fletëvotime mund t'i dërgojnë direkt në kutinë postare të KQZ-së në Kosovë, apo në adresë të kutisë postare jashtë Kosovës të hapura nga KQZ-ja, me ndihmën e përfaqësive diplomatike, në shtetin ku voton votuesi, apo në shtetin më të afërt ku është e hapur kutia postare.

6. KQZ, përmes akteve nënligjore, përcakton kriteret dhe kushtet që duhet të përmbushin objektet e përfaqësive diplomatike të shndërruara në hapësira votimi, si dhe përcakton numrin maksimal të votuesve që mund të votojnë, për secilën përfaqësi diplomatike.

7. KQZ, përmes aktit nënligjor, rregullon mënyrën e regjistrimit për votim në përfaqësi diplomatike, mënyrën e votimit, mbikëqyrjes, vëzhgimit, shpërndarjes, paketimit dhe dërgimit të materialit të votimit dhe të gjitha çështjet tjera që ndërlidhen me votimin për shtetasit jashtë vendit.

8. KQZ-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, vlerëson hapësirat fizike për secilën përfaqësi diplomatike dhe, në përputhje me kriteret e përcaktuara, merr vendim për numrin e vendvotimeve dhe për numrin e votuesve për secilën përfaqësi diplomatike. Jo më vonë se pesë (5) ditë nga dita e shpalljes së datës së zgjedhjeve, KQZ kërkon nga MPJ, listën e të gjitha përfaqësive diplomatike, bashkë me detajet e nevojshme mbi hapësirën e objekteve. Ministria e Punëve të Jashtme obligohet që t'i ofrojë KQZ-së të gjitha informacionet e kërkuara brenda tre (3) ditë, nga dita e pranimit të kërkesës. MPJ përshtat hapësirat e objekteve të përfaqësive diplomatike në vendvotime sipas kriterëve të përcaktuara nga KQZ.

9. KQZ secilin votues të regjistruar për të votuar nga jashtë Kosovës, e largon nga Lista e Votuesve brenda Kosovës.

10. KQZ mbulon shpenzimet e këshillave të vendvotimit dhe ekipeve që angazhohen për të organizuar votimin në përfaqësi diplomatike dhe për grumbullimin e zarfeve në kutinë postare jashtë vendit, përfshirë edhe komisionerët e partive politike.

11. Ekipet që angazhohen me qëllim të votimit jashtë vendit, alokohen në listën votuese në përfaqësi diplomatike për të mos i humbur e drejta e votimit.

### **Neni 97** **Aplikimi për Fletëvotim**

1. Shtetasi me të drejtë vote mund të aplikojë për t'u regjistruar si votues jashtë Kosovës, duke e dorëzuar të plotësuar formularin e aplikimit për regjistrim, nëpërmjet njërës nga këto mënyra:

1.1. përmes platformës elektronike, e cila garanton verifikimin e aplikuesit;

1.2. përmes postës, në një nga Kutitë Postare të KQZ-së.

2. Vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe në rast të pamundësisë objektive për regjistrim, sipas platformës elektronike nga nënparagrafi 1.1 i këtij neni, KQZ mundëson regjistrimin si votues jashtë Kosovës edhe përmes e-mail-it personal, duke dërguar formularin dhe dokumentet e nevojshme në adresat elektronike të caktuara nga KQZ.

3. KQZ nxjerr akt të veçantë për përcaktimin e procedurave për aplikim, regjistrim dhe votim të shtetasve me të drejtë vote, që jetojnë jashtë vendit.

### **Neni 98** **Konfirmimi dhe Procesi i Ankesave**

1. KQZ e njofton secilin aplikues jashtë Kosovës, nëse aplikimi është aprovuar apo refuzuar.

2. Çdo aplikues, të cilit i është refuzuar regjistrimi, ka të drejtë në kundërshtim administrativ ndaj njoftimit brenda Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. KQZ themelon një komision brenda institucionit, i cili do të shqyrtojë kundërshtimin administrativ të parashtruar kundër njoftimit, ndërsa për rastet e refuzimit KQZ nxjerr vendim.

3. Çdo aplikues të cilit i është refuzuar kundërshtimi administrativ, ka të drejtë ankese në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i vendimit. PZAP vendos për ankesën brenda nëntëdhjet e gjashtë (96) orëve, nga parashtrimi i saj.

## **KAPITULLI XV**

### **VOTIMI I PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA**

#### **Neni 99**

##### **Dispozitat e Përgjithshme**

1. KQZ-ja përcakton rregullat për votim për personat me nevoja të veçanta:

1.1. votuesit me të drejtë vote të cilët nuk mund të dalin nga shtëpitë e tyre për të votuar personalisht në vendvotimin e zakonshëm për shkak të paaftësisë fizike, mjekësore ose çfarëdo paaftësie tjetër;

1.2. votuesit me të drejtë vote, me lëvizje të kufizuar në ndonjë institucion: votuesit në hospitalizim, njerëzit e moshuar në shtëpitë e caktuara veçanërisht për të moshuarit, personat në trajtim në institucionet e shëndetit mendor, të burgosurit në burgje dhe të paraburgosurit në qendrat e paraburgimit;

1.3. votimi në rrethana të veçanta: votuesi që për shkaqe sigurie dhe votuesit që janë në arrest shtëpiak, nuk mund të votojnë në vendvotimin e tyre të caktuar. Për këtë lloj votimi, Komisioni Komunal i Zgjedhjeve ndërmerr të gjitha veprimet për regjistrimin dhe miratimin e këtyre kategorive të votimit.

#### **Neni 100**

##### **Procesi i Vendosijes**

1. KKZ-ja lëshon një njoftim me shkrim të dhënë nga KQZ-ja duke informuar kështu çdo votues me të drejtë vote ose grup të votuesve të cilëve u është mohuar kërkesa për VPNV, duke i informuar për të drejtën e tyre për të ushtruar ankesë pranë Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia deri në datën e caktuar në njoftim.

2. Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia shqyrton secilën parashtrësë që e merr në përputhje me Rregullat e Procedurës dhe afatet e përcaktuara me këtë ligj dhe rregullat e KQZ-së.

3. Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia mund të urdhërojë KQZ-në që të përfshijë ose të përjashtojë votuesit me të drejtë vote nga lista e votuesve e VPNV-së, në bazë të autoritetit të saj.

## **KAPITULLI XVI**

### **PROCESI I NUMËRIMIT TË FLETËVOTIMEVE DHE SHPALLJA E REZULTATEVE TË ZGJEDHJEVE**

#### **Neni 101**

##### **Dispozitat e përgjithshme**

1. Procedurat e numërimit të fletëvotimeve udhëhiqen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencja, efikasiteti, mundësia për rinumërimin dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës.
2. Fletëvotimet e rregullta nga vendvotimet brenda Kosovës, numërohen në ato vendvotime, menjëherë pas mbylljes së procesit votues.
3. Për zgjedhjet për Kuvend të Kosovës dhe kuvendet komunale, numërimi i votave për subjektet politike bëhet në vendvotime pas përfundimit të votimit dhe plotësohen formularët përkatës. Ndërsa, votat për kandidatët e subjekteve politike numërohen në qendra komunale të numërimit të fletëvotimeve për kandidatë. Votat për kandidatët për kryetarë komune numërohen në vendvotim, menjëherë pas mbylljes së vendvotimeve.
4. Çdo komunë do të ketë një qendër komunale të numërimit të votave, në të cilën do të bëhet pranimi i kutive të votimit dhe materialeve zgjedhore, do të numërohen dhe do të bëhet vlerësimi i votave për kandidatët dhe do të plotësohen formularët e rezultateve të kandidatëve për secilin vendvotim.
5. Qendrat komunale të numërimit, caktohen në salla me përmasa të mëdha ose palestra sportive. Vendet e numërimit të votave për kandidatë vihen në dispozicion të KKZ-ve, jo më vonë se dhjetë (10) ditë para datës së zgjedhjeve. KKZ-ja, jo më vonë se pesë (5) ditë para datës së zgjedhjeve, fton për vizitë dhe njohje të vendit të numërimit të votave të kandidatëve, subjektet politike, vëzhguesit dhe anëtarët e KKZ-së. Numërimi bëhet duke ofruar transparencë të plotë. Në përzgjedhjen e vendit, KQZ-ja merr parasysh edhe mundësinë për aplikimin e teknologjisë mbështetëse për numërimin e votave.
6. Përpara hapjes së qendrave komunale të numërimit të votave, KQZ-ja me qëllim të fillimit dhe mbarëvajtjes së procesit të numërimit të votave të kandidatëve, përgatit infrastrukturën e nevojshme logjistike të vendit të numërimit.
7. KQZ-ja vendos tavolina pune për çdo grup numërimi, duke siguruar që ato të kenë hapësirë të mjaftueshme për kryerjen e procesit të numërimit të votave. Tavinat vendosen në mënyrë të tillë që të jenë të dukshme nga anëtarët e KKZ-së, nga vëzhguesit, kandidatët dhe përfaqësuesit e mediave.
8. Vëzhguesit qëndrojnë përballë grupeve të numërimit, në një largësi të përshtatshme nga tavolinat e punës. Vëzhguesit nuk mund të kenë kontakt fizik me materialet e votimit. Tavinat e grupeve të numërimit dhe vendi i anëtarëve të KKZ-së, duhet të jenë në të njëjtën sallë ku kryhet procesi i numërimit të votave. Ekipet e numërimit do të reflektojnë përbërjen e KVV-ve. Skema organizative e funksionimit dhe numri i tavolinave të numërimit për çdo vend të numërimit të votave, përcaktohen me rregulla të KQZ-së.

9. Pajisjet e nevojshme logjistike për procesin e numërimit të votave sigurohen nga KQZ-ja, në bashkëpunim me organet e tjera qendrore ose lokale.

10. KQZ-ja përcakton, me akte nënligjore, kriteret për numrin e grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave, mënyrën e organizimit të punës, ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupit të numërimit dhe rregullat për radhën e veprimeve. Grupet e numërimit emërohen nga KQZ-ja, në bazë të nominimeve të partive politike dhe duke ju dhënë përparësi anëtarëve të këshillave të votimit që kanë shërbyer në ditën e zgjedhjeve. Në rastet kur subjekti politik nuk nominon anëtarë për numërim apo nominon pamjaftueshëm, apo kur numëruesit e subjekteve politike nuk paraqiten në vendin e numërimit, KQZ emëron numërues nga stafi i saj.

11. Punën në QKN e drejton KKZ. Menaxher i QKN-së është udhëheqësi i KKZ-së. KQZ-ja rekruton stafin për të mbështetur punën e KKZ-së dhe ekipeve për numërim.

12. KKZ-ja miraton një orar të numërimit në qendrën komunale të numërimit për secilin vendvotim, për qëllime vëzhgimi por edhe numërimi. Numërimi fillon në mëngjesin e ditës së nesërme, pas ditës së zgjedhjeve.

13. Të dhënat dhe rezultatet për çdo vendvotim dërgohen për tabulim në QNR, menjëherë pas përfundimit të punës së çdo ndërrimi. Kopjet e formularëve të rezultateve skanohen, publikohen dhe vendosen në vende të qasshme për vëzhguesit, si dhe ju ofrohen subjekteve politike dhe kandidatëve, sipas kërkesës.

14. Procedurat e numërimit rregullohen me rregullat të veçanta të KQZ-së.

15. Pas përfundimit të gjithë procedurave të numërimit të votave të kandidatëve, materialet dorëzohen në QNR.

16. Pas përfundimit të numërimit të votave për kandidatët dhe futjes së të dhënave dhe rezultateve në QNR, si dhe pas përfundimit të periudhës për ankesa, KQZ shpallë rezultatet përfundimtare.

17. KQZ obligohet të garantojë transparencë të plotë të numërimit të votave në QKN dhe QNR, duke përfshirë mundësinë e përdorimit të teknologjisë në monitorimin, leximin apo skanimin e materialeve.

## **Neni 102**

### **Raportimi i numërimit preliminar në vendvotim**

1. Çdo anëtar i komisionit të vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendvotim mund të regjistrojë mospajtimin e tij në librin e votimeve të vendvotimit dhe mund të dërgojë një vërejtje te Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në përputhje me këtë ligj.

2. Kryesuesi i komisionit të vendvotimit dhe mbikëqyrësi i KQZ-së, nëse i pranishëm, është përgjegjës për përmbledhjen dhe saktësinë e rezultateve të votimit të marra nga shënimet e vendvotimit të bëra në format e kërkuara dhe e dërgon formën e kompletuar të FPR-së në vendin e caktuar.

3. Rezultatet e numërimit në VV vendosen në vendvotim nga kryesuesi i vendvotimit.

4. Qendrat e votimit në nivelin komunal mbledhin dhe sistemojnë të dhënat e rezultateve preliminare, në mënyrë tabelore për secilin vendvotim dhe të njëjtat i dërgojnë me kohë në KQZ.

5. KQZ bën përmbledhjen e rezultateve preliminare (paraprake) të vendvotimeve dhe i bën publike brenda dyzet e tetë (48) orëve nga mbyllja e vendvotimeve.

### **Neni 103**

#### **Ruajtja e fletëvotimeve dhe transportimi i materialit zgjedhor**

1. Pas përfundimit të numërimit, të gjitha fletëvotimet e përdorura dhe ato të papërdorura, lista përfundimtare e votuesve, lista e votuesve me kusht, libri i votimit, zarfet me fletëvotime me kusht që përmbajnë fletëvotimet e shënuara dhe materialet tjera zyrtare zgjedhore në vendvotim duhet të:

1.1. paketohen dhe transportohen në përputhshmëri me rregullat KQZ-së;

1.2. transportohen në kushte të sigurta deri në vendin e saktësuar nga KQZ-ja.

2. Kryesuesi i KVV-së e shoqëron transportin e fletëvotimeve dhe materialit zgjedhor deri në pikën e caktuar të grumbullimit, e nëse kërkohet, shoqërohet nga një anëtar i opozitës, i një niveli të respektueshëm, i zgjedhur me konsensus, ose në mungesë të konsensusit, i zgjedhur me short nga kryesuesi.

3. Fletëvotimet, format dhe materialet tjera zgjedhore të transportuara në një vend të caktuar në Kosovë ruhen në kushte të sigurta derisa të zgjidhen të gjitha ankesat dhe derisa të certifikohen rezultatet nga KQZ-ja.

4. KQZ-ja me një vendim, pas certifikimit zyrtar të rezultatit të zgjedhjeve, shkatërron materialet e përmendura në kohën e përshtatshme brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve, përveç nëse udhëzohet ndryshe nga PZAP-ja.

### **Neni 104**

#### **Vëzhguesit**

1. Të gjitha aktivitetet e zhvilluara nga QKN-ja dhe QNR-ja mund të vëzhgohen nga anëtarët e KQZ-së dhe stafit të Sekretariatit të KQZ-së, anëtarët e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) dhe vëzhguesit zgjedhor të akredituar.

2. KQZ merr vendim për caktimin e numrit të vëzhguesve prezent në QKN dhe QNR. Asnjë entitet nuk mund të dërgojë më shumë se një vëzhgues për tavolinë numërimi në të njëjtën kohë në QKN dhe QNR. Në rast se KQZ vlerëson se numri i vëzhguesve të pranishëm, paraqet pengesë për procesin e numërimit, ajo mund të udhëzojë entitetet që të zvogëlojnë numrin e tyre.

**Neni 105**  
**Ankesat për procesin e QKN dhe QNR**

1. Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar.
2. Paraqitja e ankesës nuk e pengon ose ndërpret procesin e numërimit.
3. Për të gjitha ankesat e parashtruara, PZAP-ja vendosë jo më vonë se shtatëdhjet e dy (72) orë nga momenti i pranimit të tyre në PZAP.

**Neni 106**  
**Rezultatet zgjedhore**

1. KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotime dhe qendrat e numërimit si dhe kur të gjitha ankesat që u përkasin votimit dhe numërimit të vendosura nga PZAP-i dhe çdo ankesë ndaj vendimeve të PZAP-ja lidhur me to të jetë vendosur nga Gjykata Supreme e Kosovës.
2. Para certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve, KQZ-ja mund të urdhërojë rinumërimin e votave në cilindo vendvotim, qendër të numërimit ose edhe përsëritjen e votimit në një qendër votimi apo në një komunë.
3. Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë cenuar me vendimin e KQZ-së, sa i përket shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, mund të parashtrorë ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga shpallja e tij. Ankesa vendoset nga PZAP brenda nëntëdhjet e gjashtë (96) orëve, nga parashtrimi i saj.
4. Rezultatet e zgjedhjeve janë përfundimtare dhe detyruese atëherë kur janë certifikuar nga KQZ-ja. KQZ-ja i publikon rezultatet e zgjedhjeve pasi që ato të jenë certifikuar. Sekretariati i KQZ-së i publikon këto rezultate përfundimtare në formë tabelore duke përfshirë edhe publikimin në faqen e vetë të internetit:
  - 4.1. numri i zgjedhësve të regjistruar;
  - 4.2. numri zgjedhësve të cilët kanë votuar në secilin vendvotim;
  - 4.3. numri i zgjedhësve të cilët kanë votuar jashtë vendvotimit;
  - 4.4. numri i zgjedhësve që kanë votuar (numri përfundimtar i votimeve të bëra);
  - 4.5. numri i pranuar i fletëvotimeve të vlefshme;
  - 4.6. numri i fletëvotimeve të papërdorura;
  - 4.7. numri i fletëvotimeve të përdorura;



- 4.8. numri i fletëvotimeve të pavlefshme;
- 4.9. numri i fletëvotimeve të zbrazëta;
- 4.10. numri i fletëvotimeve të dëmtuara;
- 4.11. numri i votave për secilin subjekt politik;
- 4.12. numri i votave të fituara për secilin kandidat individual;
- 4.13. numri i ulëseve të fituara për secilin etnitet;
- 4.14. emrat e kandidatëve të zgjedhur.

## **KAPITULLI XVII**

### **INFORMIMI I VOTUESVE DHE MEDIA**

#### **Neni 107**

#### **Dispozitat e përgjithshme**

1. KQZ-ja, në kohë të duhur, organizon dhe sponsorizon fushatën për edukimin e votuesve. Ajo shpërndan nëpër të gjithë vendin, sipas Ligjit për përdorim të gjuhëve, informatat për:

1.1. procedurat e votimit; dhe

1.2. të drejtat e votuesve dhe procedurat për mbrojtjen e tyre, përfshirë edhe mekanizmat për ankesë.

2. Në secilin vendvotim, në ditën e zgjedhjeve, materiali i shtypur, i dizajnuar dhe i përgatitur në emër të KQZ-së, me emra të numëruar të subjekteve politike dhe emrave të kandidatëve, e po ashtu edhe të procedurave të votimit, nxirret, ekspozohet ose publikohet nga Sekretariati i KQZ-së në dobi të votuesve. Emrat e kandidatëve në materiale të tilla të shtypura ose të ekspozuara renditen në të njëjtën mënyrë siç paraqiten në listën e regjistrimit të kandidatëve, të certifikuar nga KQZ-ja në lidhje me subjektet politike të cilat i kanë paraqitur.

3. Gjatë bërjes së fushatës për edukimin e votuesve, SKQZ-ja i kushton vëmendje të veçantë votuesve të grupeve shoqërore si: gratë, komunitetet joshumicë, votuesit në zonat rurale, votuesit për herë të parë dhe personat me aftësi të kufizuara.

**Neni 108**  
**Transmetimi i informatave për votuesit**

1. KQZ-ja përgatit material të përshtatshëm për transmetim në radio dhe televizion për informimin e publikut për procesin zgjedhor në Kosovë.
2. Materiali informues i përgatitur nga KQZ-ja për emetim në televizion përmban mënyrë për transmetimin simultan për njerëzit me dëgjim të dëmtuar në gjuhën adekuate për nevojat e grupeve gjuhësore të cilat shërbejnë nga transmetuesi.

**Neni 109**  
**Shkeljet**

Nëse transmetuesi televiziv ose i radios dështon t'i përmbahet dispozitave të këtij ligji ose legjislacionit në zbatim, KQZ-ja e njofton menjëherë KPM-në.

**KAPITULLI XVIII**  
**SISTEMI ZGJEDHOR PËR KUVENDIN E KOSOVËS**

**Neni 110**  
**Dispozitat e Përgjithshme**

1. Kosova është një zonë e vetme zgjedhore.
2. Subjekti politik që nuk është kandidat i pavarur e paraqet listën e kandidatëve në përputhje me nenet 28 dhe 30 të këtij ligji dhe rregullat e KQZ-së.
3. Secili subjekt politik i certifikuar paraqitet në votim me “listë të hapur”.
4. Votuesi pajiset me një fletëvotim të vetëm për zgjedhje dhe në të shënjon:
  - 4.1. votën për një (1) subjekt politik;
  - 4.2. votën për një (1) deri në dhjetë (10) kandidatë nga lista e subjektit politik për të cilin ka votuar votuesi.
5. Nëse një fletëvotim shënjohe për më shumë se dhjetë (10) kandidatë, atëherë numërohet vetëm vota për subjektin politik.

## **Neni 111**

### **Ndarja e vendeve**

1. Vendet në Kuvend ndahen sipas sistemit të përfaqësimit të caktuar nga neni 64 i Kushtetutës.

2. Njëqind e njëzet (120) vendet në Kuvend zgjidhen me votim të fshehtë, bazuar në listat e hapura dhe ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvendin. Në kuadër të kësaj ndarjeje, njëzet (20) prej tyre janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë, si vijon:

2.1. partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin serb, do të kenë numrin e vendeve në Kuvend të fituar në zgjedhjet e hapura, me minimumin dhjetë (10) vende të garantuara, në rast se numri i vendeve të fituara është më i vogël se dhjetë (10);

2.2. partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet e tjera, në Kuvend do të kenë numrin e vendeve të fituara në zgjedhjet e hapura me minimumin e vendeve të garantuara si në vijim: komuniteti rom një (1) vend; komuniteti ashkali një (1) vend; komuniteti egjiptian një (1) vend; dhe një (1) vend shtesë do t'i jepet komunitetit rom, ashkali, ose egjiptian, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti boshnjak tri (3) vende, komuniteti turk dy (2) vende dhe komuniteti goran një (1) vend, nëse numri i vendeve të fituara nga secili komunitet është më i vogël se numri i vendeve të garantuara.

3. Njëqind e njëzet (120) vendet në Kuvend, siç përcaktohen në paragrafin 2 të këtij neni, ndahen në bazë të numrit të përgjithshëm të votave të vlefshme që i ka fituar secili subjekt politik, si në vijim:

3.1. Në mesin e subjekteve politike që përfaqësojnë komunitetin shumicë të cilat kanë fituar së paku pesë për qind (5%) nga numri i përgjithshëm i votave të vlefshme në zgjedhjet për Kuvend dhe subjekteve politike që përfaqësojnë komunitetet që nuk janë shumicë;

3.2. numri i përgjithshëm i votave të vlefshme, të fituara nga secili subjekt politik në zgjedhjet për Kuvend të Kosovës, pjesëtohet me 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, e kështu me radhë, derisa numri i pjesëtuesve të shfrytëzuar t'i përgjigjet numrit të plotë të vendeve;

3.3. koeficientet e përftuar nga çdo pjesëtim, renditen në listë nga koeficienti më i madh tek ai më i vogël, duke renditur përkrah tyre subjektin, të cilit i përket koeficienti përkatës. Në rast se koeficienti është një numër me mbetje dhjetore, si koeficient merret numri i plotë më i afërt. Renditja vazhdon derisa të ndahen të gjitha vendet;

3.4 nëse një subjekti politik i ndahen vende që janë të njëjtë me numrin e kandidatëve në listën e tyre dhe ka ende vende për të ndarë, atëherë koeficientet i atij subjekti nuk merret parasysh gjatë ndarjes së vendeve të mbetura;

3.5. një subjekt politik përfiton një numër vendesh të barabartë me numrin e koeficientit më të madh, të përfshirë në listën e përcaktuar në nënparagrafin 3.3. të këtij neni, duke respektuar nënparagrafët 3.1., 3.2. dhe 3.4. të këtij neni;

3.6. në rast se gjatë ndarjes së vendit ndodhë barazimi, për shkak se dy ose më shumë subjekte kanë të njëjtin koeficient, vendi i jepet atij subjekti që ka numrin më të madh të votave. Nëse subjektet politike kanë numër të barabartë votash, vendi ndahet me hedhje të shortit nga kryesuesi i KQZ-së, në praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve politike në fjalë.

4. Të gjitha votat e fituara nga kandidatët që janë në listën e hapur të subjektit politik numërohen ndaras. Listat me kandidatë rirenditen sipas mënyrës zbritëse në bazë të numrit të votave të fituara për secilin kandidat.

5. Vendet që i ndahen subjektit politik në paragrafin 2 të këtij neni u ndahen kandidatëve që gjenden në listën e rirenditur të kandidatëve të subjektit politik në paragrafin 4 të këtij neni, duke filluar nga kandidati i parë në listë sipas një renditje zbritëse, deri në mbarim të vendeve që i ndahen subjektit politik pavarësisht numrit të votave të kandidatëve. Vendet shtesë që u ndahen subjekteve politike që përfaqësojnë komunitetin serb dhe komunitetet tjera joshumicë në Kosovë sikurse në paragrafin 3 të këtij neni u ndahen kandidatëve pasues nga lista e rirenditur nga paragrafi 4 i këtij neni e kandidatëve të subjektit politik.

6. Nëse pas ndarjes së vendeve të përcaktuara për kandidatët në listën e një subjekti politik, ashtu siç është përcaktuar në paragrafin 5 të këtij neni, kandidatëve të gjinisë pakicë nuk u janë ndarë së paku tridhjetë për qind (30%) nga numri i përgjithshëm i vendeve të ndarë për atë subjekt politik, kandidati i fundit i zgjedhur i gjinisë shumicë zëvendësohet nga kandidati i radhës i gjinisë pakicë në listën e rirenditur për kandidatë, derisa numri i përgjithshëm i vendeve të ndara për gjininë pakicë të jetë së paku tridhjetë për qind (30%). Ky paragraf nuk zbatohet ndaj ndarjes së vendeve nga lista që përbëhet prej një (1) apo dy (2) kandidatëve.

7. Asnjë person që është anëtar i ndonjë organi tjetër ligjvënës të zgjedhur nuk mund të ketë vend në Kuvend. Një anëtar i Kuvendit që është ose bëhet anëtar i ndonjë organi tjetër ligjvënës të zgjedhur pas marrjes së vendit në Kuvend, humb mandatin e tij në Kuvend.

8. Një person që humb mandatin sipas këtij neni zëvendësohet në pajtim me dispozitat nga neni 112 i këtij ligji.

## **Neni 112**

### **Zëvendësimi i Anëtarëve të Kuvendit**

1. Vendet e shpërndara në përputhje me këtë Ligj mbahen personalisht nga kandidatet e zgjedhur dhe jo nga subjekti politik. Mandati i anëtarit nuk do të ndryshohet apo ndërpritet para se të përfundojë mandati përveç në rastet vijuese:

1.1. dënimi i anëtarit për veprë penale për të cilën ai apo ajo është dënuar me burgim sikurse parashikohet me anë të nenit 70 paragrafit 3, nënparagrafit (6) të Kushtetutës;

1.2. dështimi i anëtarit që të marrë pjesë në seancat e Kuvendit apo të Komisioneve për gjashtë (6) muaj radhazi, anëtar i të cilave ai apo ajo janë, përveç nëse jepet ndonjë arsye bindëse në pajtim me Rregulloren e Kuvendit;

1.3. humbja e mandatit të anëtarit, sipas nenit 30 të këtij ligji;

1.4. vdekja e anëtarit;

1.5. paaftësia mendore ose fizike e anëtarit, e përcaktuar me anë të vendimit përfundimtar gjyqësor, apo

1.6. dorëheqja e anëtarit.

2. Një anëtar i Kuvendit të Kosovës mandati i të cilit përfundon në pajtim me nenin me paragrafin 1 të këtij neni zëvendësohet si vijon:

2.1. Nga kandidati i ligjshëm në radhë, i cili ka fituar numrin më të madh të votave të listës së riorganizuar të kandidatëve të subjektit politik, në emër të së cilës garoi anëtari, nëse në një rast të tillë nuk cenohet garancia e përfaqësimit të detyrueshëm minimal të gjinisë së nënpërfaqësuar, në kuotën prej tridhjetë për qind (30%) të subjektit politik;

2.2. Vetëm nëse nuk ka kandidatë tjerë të ligjshëm, pavarësisht votave të tij/saj në listën e kandidatëve, shkon kandidati i ardhshëm legjitim nga lista e kandidatëve të subjektit politik që ka pasur koeficientin më të madh të votave sipas formulës së përcaktuar në nenin 111 paragrafi 4 të këtij ligji nga zgjedhjet e fundit të të njëjtit lloj; dhe

2.3. nëse anëtari është kandidat i pavarur, shkon kandidati i ardhshëm legjitim nga lista e kandidatëve të subjektit politik që ka pasur koeficientin më të madh të votave sipas formulës së përcaktuar në nenin 111 paragrafi 4 të këtij ligji.

3. Pasi që një ulëse të mbetet e zbrazët, Kryetari i Kuvendit i bën kërkesë me shkrim Presidentit për mbushjen e ulëses së zbrazët. Një kërkesë e tillë duhet të përfshijë edhe sqarimin se pse u lirua kjo ulëse.

4. Pas pranimit të kërkesës sipas paragrafit 3 të këtij neni, nëse sqarimi i dhënë është i mjaftueshëm, Presidenti duhet të kërkojë nga KQZ-ja të rekomandojë emrin e personit për ta mbushur vendin e lirë. KQZ-ja duhet që në afatin prej pesë (5) ditëve të punës nga momenti i marrjes së kërkesës, t'ia ofrojë Presidentit emrin radhës së personit të ligjshëm sipas paragrafit 2 të këtij neni.

## **KAPITULLI XIX**

### **SHPENZIMET/KOSTOJA E ZGJEDHJEVE**

#### **Neni 113**

##### **Financimi i zgjedhjeve**

1. Qeveria e Kosovës financon mbajtjen e zgjedhjeve.
2. KQZ-ja administron fondet e ndara për mbajtjen e zgjedhjeve sipas normave të caktuara në këtë ligj.
3. Buxheti i KQZ-së përbën një vijë të veçantë në buxhetin shtetëror.
4. KQZ-ja i cakton rregullat për distribuimin dhe përdorimin e fondeve të nevojshme për mbajtjen e zgjedhjeve nga komisionet zgjedhore dhe funksionimit adekuat të sekretariatit të KQZ-së në përputhshmëri me përgjegjësit e saj, duke marrë parasysh ligjet e aplikueshme mbi menaxhimin e financave publike.
5. KQZ-ja mund të pranoj donacione, përveç parave të cilat janë në shërbim të procesit zgjedhor, duke mos ndërhyrë në pavarësinë dhe autoritetin e tij.
6. Brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve prej ditës së shpalljes të rezultateve zyrtare të zgjedhjeve, KQZ-ja do të publikoj një raport të plotë për shpenzimet zgjedhore dhe mënyrën e shpenzimit.
7. Përdorimi i drejtë i fondeve të caktuara për zgjedhje si dhe donacionet, kontrollohen nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës.

#### **Neni 114**

##### **Përkrahja publike për fushatat zgjedhore**

Institucionet publike, duhet t'u mundësojnë në baza të barabarta të gjitha subjekteve politike të certifikuara dhe KQZ-së qasje në godinat, pajisjet, si dhe tu ofrohen lehtësira tjera për të zhvilluar një fushatë zgjedhore në përputhshmëri me rregullat e tyre të zakonshme.

## **KAPITULLI XX**

### **PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**

#### **Neni 115**

#### **Statusi dhe emërimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

1. PZAP është organ i përhershëm i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është caktuar me këtë ligj dhe rregullat zgjedhore.
2. Këshilli Gjyqësor i Kosovës emëron kryesuesin e PZAP-së, nga radha e gjykatësve të Gjykatës Supreme, ndërsa anëtarët emërohen nga radha e gjykatësve të Gjykatës së Apelit. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në pajtim me natyrën e punës së PZAP, miraton akt të veçantë për kushtet dhe përvojën specifike të gjyqtarëve që mund të emërohen në PZAP.
3. Anëtarët e PZAP-së shërbejnë për një mandat të ripërtërishëm prej katër (4) viteve.
4. Në rast se pozita e kryesuesit apo një anëtar i mbetet e zbrazët, Këshilli Gjyqësor i Kosovës emëron një person në atë pozitë brenda tridhjetë (30) ditëve.
5. PZAP-ja dorëzon Raport Vjetor Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më së largu më 1 mars të vitit pasues pas mbajtjes së zgjedhjeve dhe pas shqyrtimit të tij, i njëjti publikohet. Forma, struktura dhe përmbajtja e raportit, përcaktohet paraprakisht nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.
6. Përveç raportit nga paragrafi 5 i këtij neni, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në kuadër të raportit vjetor lidhur me sistemin e drejtësisë të cilin ia dërgon Kuvendit të Republikës së Kosovës, siç përcaktohet në paragrafin 8 të nenit 108 të Kushtetutës, në një kapitull të veçantë të saj, përmbledh edhe punën e PZAP-së për vitin në të cilin janë mbajtur zgjedhjet.
7. Për kryerjen e detyrave të tyre, kryesuesi dhe anëtarët e PZAP-së janë përgjegjës para Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

#### **Neni 116**

#### **Përbërja e PZAP-së**

1. PZAP-ja përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë. PZAP-i mund të mblidhet në seanca të ndara me nga së paku tre (3) anëtar.
2. Anëtarët e emëruar të PZAP-së në periudhën duke filluar prej gjashtëdhjetë (60) ditë para ditës së zgjedhjeve deri në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve i japin përparësi të plotë obligimeve të tyre si anëtar të PZAP-së. Institucionet përkatëse obligohen t'i ofrojnë ndihmën e nevojshme PZAP-së gjatë periudhës së lartpërmendur.

## **Neni 117**

### **Procedurat e PZAP-së**

1. PZAP-ja miraton akt të veçantë për procedurat e parashtrimit dhe vendosjes së ankesave nga palët e autorizuar, siç përcaktohet me dispozitat e këtij ligji.
2. Takimet e PZAP-së apo të paneleve janë të hapura për publikun. Gjate vendosjes për një ankesë, PZAP shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mban seancë dëgjimore, në rast se e konsideron këtë të nevojshme. Në rastet kur ankesa parashtrohet nga subjekti politik dhe çështja kontestuese lidhet me certifikimin apo rezultatin zgjedhor të subjektit politik ose kandidatit për kryetar komune, seanca dëgjimore me palët është e obligueshme. Seanca dëgjimore nuk aplikohet në procesin e shqyrtimit të ankesave të kandidatëve individualë të subjekteve politike.
3. Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse.
4. PZAP-ja mund të urdhërojë rinumërimin e fletëvotimeve në një vendvotim apo qendër votimi si dhe shqyrtimin e materialit votues si pjesë të hetimeve për ankesën e parashtruar.

## **Neni 118**

### **Vendimet**

1. PZAP-ja pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht.
2. PZAP-ja ofron bazat ligjore dhe faktike për vendimet e tij me shkrim. PZAP-ja u ofron kopjet e vendimeve të tij me shkrim, palëve të përfshira, brenda afatit prej shtatëdhjet e dy (72) orëve nga momenti i dorëzimit të ankesës në rast se ai ndikon në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve. Për vendimet tjera PZAP-ja ofron kopjet e vendimeve të tij me shkrim, palëve të përfshira në çështje, brenda pesë (5) ditëve kalendarike.
3. Vendimet e PZAP-së publikohen në përputhshmëri me rregullat dhe procedurat e PZAP.
4. Vendimi i PZAP-së mund të ankimohet në Gjykatën Supreme të Kosovës, sikurse që PZAP-ja mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar. Ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i vendimit të PZAP-së, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë se pesë mijë euro (5.000 €), ose në rast se çështja lidhet me një të drejtë themelore. Gjykata Supreme e Kosovës vendos në afatin prej pesë (5) ditësh nga paraqitja e ankesës.
5. Vendimi i PZAP-së është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga KQZ-ja, përveç nëse Gjykata Supreme të Kosovës vendos ndryshe.



## **Neni 119**

### **Ankesat**

1. Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të parashtrojë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit dhe PZAP vendos për ankesën brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve nga parashtrimi i saj.
2. Zyra mund të parashtrojë ankesë në PZAP sa i përket dështimit të subjektit politik për të vepruar në pajtim me këtë ligj ose rregullat e KQZ-së të cilat prekin procesin zgjedhor ose procesin e regjistrimit.
3. PZAP-ja vendos për të gjitha ankesat ndaj vendimeve të KQZ-së, të përcaktuara shprehimisht me këtë ligj.
4. PZAP-ja mund të vendos sanksione ndaj një subjekti politik për shkeljen e këtij ligji apo rregullave të KQZ-së, shkelje të cilat janë bërë nga anëtarët, përkrahësit dhe kandidatët e subjektit. Një subjekt politik mund t'i ofrojë fakte PZAP-së për të treguar se ka bërë përpjekje të arsyeshme për të parandaluar dhe dekurajuar anëtarët, përkrahësit dhe kandidatët për të mos shkelur këtë ligj ose rregullat zgjedhore. PZAP-ja shqyrton këto fakte për të vendosur për sanksionet përkatëse, në rast se ka, për t'iu shqiptuar subjektit politik. Para shqiptimit të gjobës, PZAP-ja kërkon nga subjektet politike evitimin e menjëhershëm të shkeljes brenda afatit të caktuar. Kjo vlen për shkeljet që mund të mënjahen dhe nuk kanë pasoja të mëdha dhe të pariparueshme.
5. PZAP-ja mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtojë çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.
6. Ofrimi i informatave të rrejshme në PZAP, paraqet shkelje të këtij ligji e sanksionuar nga PZAP-ja.

## **Neni 120**

### **Përmirësimet dhe sanksionimet ndaj shkeljeve**

1. Në rast se PZAP përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të:
  - 1.1. urdhërojë një subjekt politik ose një organizatë vëzhguese të ndërmarrë masa përmirësuese;
  - 1.2. para certifikimit të rezultateve zgjedhore, është në kompetencë të PZAP-së, në raste të jashtëzakonshme të anulojë rezultatet në një vendvotim apo qendër votimi, dhe ta urdhërojë KQZ të përsërisë votimin në një qendër votimi apo vendvotim, nëse konsideron se ka ndikim në rezultatet finale; dhe
  - 1.3. të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000 €) Euro.
2. Dështimi për të paguar dënimin apo për t'ju bindur një urdhërese të PZAP-së brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-ja.

3. Në rast se ka ndodhur një shkelje e këtij ligji ose rregullave zgjedhore, e cila e minon integritetin e zgjedhjeve, PZAP-ja mund të:

3.1. largojë një kandidat nga lista e kandidatëve, kur të dëshmohet se kandidati ishte përgjegjës për këtë shkelje;

3.2. largojë një apo disa kandidatë nga lista e kandidatëve të një subjekti politik dhe të mos e lejoj subjektin politik t'i zëvendësojë kandidatët e larguar, nëse PZAP-ja përcakton se subjekti ishte përgjegjës për këtë shkelje;

3.3. decertifikojë një subjekt politik nga pjesëmarrja në zgjedhje; dhe

3.4. ndalojë një individ të marr pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, për një periudhë kohore që nuk i kalon gjashtë (6) vite.

4. Mjetet e mbledhura nga gjobat e shqiptuara të PZAP-së, derdhen në buxhetin e Kosovës.

5. Çdo vendosje e një gjobe ose ndonjë sanksionimi tjetër nga PZAP-ja është pa paragjykim ndaj ndonjë sanksionimi penal që mund të pasojë.

## **Neni 121**

### **Sekretariati i PZAP-së**

1. PZAP-ja, në ushtrimin e përgjegjësive dhe funksioneve të tij, mbështetet nga Sekretariati i cili punon në pajtim me këtë ligj dhe i nënshtrohet rregullave të përgjegjësisë së zyrtarëve publikë të administratës së institucioneve të drejtësisë.

2. Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me akt të veçantë miraton strukturën organizative dhe klasifikimin e pozitave të Sekretariatit të PZAP-së, duke përfshirë edhe rregullimin e aspekteve të marrëdhënies së punës së zyrtarëve. Zyrtarët e Sekretariatit të PZAP-së e kanë statusin e zyrtarit publik të punësuar në institucionet e drejtësisë.

3. Sekretariati i PZAP-së:

3.1. pranon ankesa;

3.2. arkivon, përkthen dhe heton rastet;

3.3. mirëmban adresë zyrtare dhe qasje në informatat në çdo kohë rreth vendimeve të PZAP-së në të gjitha gjuhët zyrtare sipas Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve;

3.4. kryen hulumtime dhe analiza ligjore, lidhur me kontestet zgjedhore.

**Neni 122**  
**Zgjedhja, mandati dhe përgjegjësitë e drejtorit të Sekretariatit**

1. Sekretariati udhëhiqet nga drejtori i saj, i cili i përgjigjet PZAP dhe ka mandat të zyrarit të nivelit të lartë drejtues dhe emërohet në bazë të procedurave të përcaktuara në ligjin në fuqi për zyrtarët publikë dhe është përgjegjës për:

- 1.1. Të gjitha çështjet administrative të ndërlidhura me funksionimin e PZAP-së;
- 1.2. përgatitjen e paneleve të PZAP-së duke siguruar se i tërë materiali i nevojshëm është në dispozicion;
- 1.3. udhëheqjen e Sekretariatit dhe nxjerrjen e procedurave administrative për çfarëdo çështje që ka të bëjë me funksionet e PZAP;
- 1.4. udhëheqjen dhe organizimin e punës së Sekretariatit;
- 1.5. mbikëqyrjen e punës së zyrtarëve të Sekretariatit;
- 1.6. menaxhimin e buxhetit të Sekretariatit dhe është përgjegjës për mënyrën e shpenzimit të tij, në pajtim me legjislacionin përkatës;
- 1.7. nxjerrjen e vendimeve konform mandatit dhe kompetencave të Drejtorit të Sekretariatit;
- 1.8. hartimin dhe miratimin e planit vjetor të punës brenda mandatit të Sekretariatit;
- 1.9. kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të tjera të përcaktuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës lidhur me PZAP-në.

**Neni 123**  
**Procedura e zgjedhjes së Drejtorit të Sekretariatit**

1. Procedura për përzgjedhjen e Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-së, zhvillohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, i cili e emëron komisionin përzgjedhës në përbërje të pesë (5) anëtarëve si vijon:

- 1.1. Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, kryesues;
- 1.2. Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, anëtar;
- 1.3. Një profesor fakulteti me përvojë së paku dhjetë (10) vjeçare në fushën e të drejtave të njeriut ose në të drejtën zgjedhore, anëtar;
- 1.4. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës, anëtar;

- 1.5. Një përfaqësues nga radha e organizatave të shoqërisë civile, me përvojë së paku pesë (5) vjeçare në fushën e të drejtave të njeriut ose në të drejtën zgjedhore.
2. Procedura për zgjedhjen e Drejtorit të Sekretariatit bazohet në parimet e konkurrencës, mosdiskriminimit, transparencës, integritetit dhe objektivitetit.
  3. Procedura për zgjedhjen e Drejtorit të Sekretariatit fillon gjashtë (6) muaj para skadimit të mandatit të rregullt të Drejtorit.
  4. Përjashtimisht nga paragrafi 3 i këtij neni, kur mandati përfundon para kohës, siç përcaktohet me ligjin në fuqi për zyrtarët publik të nivelit të lartë drejtues, procedura për emërimin e Drejtorit të Sekretariatit fillon brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e lirimit të pozitës.
  5. Këshilli Gjyqësor i Kosovës shpall konkursin për zgjedhjen e Drejtorit të Sekretariatit, në media të shkruara dhe elektronike, në gjuhët zyrtare. Afati i kohëzgjatjes së konkursit nuk mund të jetë më i shkurtër se pesëmbëdhjetë (15) ditë, e as më i gjatë se njëzet (20) ditë.
  6. Pas skadimit të afatit të paraparë në paragrafin 5 të këtij neni, Komisioni, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, vlerëson nëse kandidatët i plotësojnë kushtet për emërim.
  7. Komisioni zhvillon intervistë me secilin kandidat i cili i plotëson kushtet për t'u zgjedhur Drejtor i Sekretariatit.
  8. Procedura është e vlefshme vetëm nëse marrin pjesë shumica e anëtarëve të Komisionit. Anëtarët e Komisionit që fillojnë me intervistimin e kandidatëve, nuk mund të ndryshohen gjatë procesit. Këshilli Gjyqësor i Kosovës miraton akt të veçantë për kualifikimet e kandidatëve dhe komponentët e vlerësimit të tyre, përfshirë të gjitha aspektet e procedurës dhe administrimit të saj.
  9. Kandidatët që kalojnë pragun prej së paku pesëdhjetë për qind (50%) të pikëve nga secila fushë që vlerësohet, vendosen në listën e ngushtë si propozim për PZAP-së.
  10. Lista e ngushtë nga paragrafi 9 i këtij neni, nuk mund të përmbajë më pak se dy (2) e jo më shumë se pesë (5) kandidatë, me ç'rast kandidatët që rangohen me pikë më të larta vendosen në listë.
  11. Propozimi i Komisionit përmban arsyetim përse Komisioni ju ka dhënë përparësi disa kandidatëve në krahasim me kandidatët tjerë.
  12. PZAP-ja, me votim të hapur, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij, zgjedh Drejtorin e Sekretariatit.

#### **Neni 124** **Kriteret për zgjedhjen e Drejtorit të Sekretariatit**

1. Kandidatët për Drejtor të Sekretariatit duhet të plotësojnë kriteret minimale si më poshtë:

- 1.1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- 1.2. të ketë diplomë universitare në fushën e drejtësisë;
- 1.3. të ketë reputacion të lartë profesional dhe integritet personal, dhe të mos ketë pasur masë disiplinore të shqiptuar në pesë (5) vitet e fundit;
- 1.4. të ketë së paku tetë (8) vite përvojë pune profesionale, nga të cilat pesë (5) vite përvojë menaxheriale;
- 1.5. të mos jetë shpallur fajtor për vepër penale;
- 1.6. në gjashtë (6) vitet e fundit të mos ketë ushtruar funksion në subjekte politike apo të mos ketë qenë kandidat, i zgjedhur apo i emëruar në organe legjislative apo ekzekutive të nivelit qendror dhe lokal.

#### **Neni 125 Buxheti i PZAP-së**

Sekretariati i PZAP-së ka buxhetin vjetor të ndarë nga Kuvendi i Kosovës për të mbuluar shpenzimet për funksionimin e tij, duke u bazuar në propozim buxhetin e dorëzuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

### **KAPITULLI XXI DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 126 Stafi i PZAP-së**

1. Anëtarët e PZAP-së, të emëruar para miratimit të këtij ligji, vazhdojnë mandatin e tyre të rregullt deri në përfundimin e tij të ligjshëm.
2. Udhëheqësi aktual i Sekretariatit të PZAP-së, me automatizëm emërohet ushtrues i detyrës së Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-së deri në rekrutimin e kësaj pozite, e cila fillon pas një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

#### **Neni 127 Aktet nënligjore**

1. Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj nxirren brenda afatit prej gjashtë (6) muajsh nga hyrja e tij në fuqi.

2. KQZ-ja obligohet që brenda gjashtë (6) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji të bëjë harmonizimin dhe sistematizimin e stafit të administratës (sekretariatit të KQZ-së), në përputhje me këtë ligj dhe ligjin në fuqi për Zyrtarët Publikë.

### **Neni 128 Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligji Nr. 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës si dhe neni 3 i Ligjit Nr. 08/L-122 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058 dhe Ligjin Nr. 08/L-122 si dhe Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhje të përgjithshme në Republikën e Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-256.

### **Neni 129 Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 08/L-228  
8 qershor 2023**

**Glauk Konjufca**

---

**Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës**